



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tropojë**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**Auditimi Financiar për vitin 2023**

**Tiranë, mars 2025**

<b>PËRMBAJTJA</b>		<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	3-7
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-6
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-7
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	7-12
1	Objektivat dhe qëllimi	7-8
2	Identifikimi i çështjes	8-8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
4	Përgjegjësitë e audituesve	8-9
5	Kriteret e Vlerësimit	9-10
6	Standartet e auditimit	10-10
7	Metodat e auditimit	10-11
8	Dokumentimi i auditimit	11-12
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>	12-83
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	12-13
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	12-83
2.1	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik	12-17
2.1.1	Auditim mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm	17-18
2.2	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit për vitin 2023	18-45
2.3	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	45-57
2.4	Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM	58-65
2.5	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	65-81
2.6	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	81-83
<b>IV.</b>	<b>REKOMANDIME</b>	83-105

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Tropojë është njësi vendore institucion i pavarur, ku pas ndarjes territoriale është një bashkim mes qytetit dhe shatë ish-komunave në afërsi të tij, pra në total ka 8 njësi administrative si vijon: njësia administrative Bajram Curri (qyteti), Fierzë, Lekbibaj, Margegaj, Llugaj, Bujan, Bytyç dhe Tropojë.

**Misioni** i Bashkisë Tropojë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

**Synimi kryesor** është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

**Buxheti i Bashkisë** Tropojë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. *Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm.* 2. *Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë*”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Tropojë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të githa problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga Bashkia Tropojë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.*
- *Auditim mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.*
- *Auditim mbi burimin e krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre.*
- *Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në pasqyrat financiare.*
- *Auditim mbi administrimin e pronës publike.*
- *Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga grupet e mëparshme*

### d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. **Nga shqyrtimi i evidencave**, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 23 gjetje dhe ka dhënë 27 rekomandime, nga ku masa organizative me 21 gjetje dhe 25 rekomandime, 1 gjetje dhe 1 rekomandim në vlerën 16,973,027 mijë lekë masa për eliminimin e efekteve negative, 1 gjetje dhe 1 rekomandim në vlerën 11,021,770 mijë lekë në fushën për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve nga kontratat e qirave.

f. **Paraqitja e gjetjeve kryesore.** Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ **Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave**

- Të ardhura të pa arkëtuara në vlerën 28,045,326 lekë për 268 subjekte debitore të kategorisë biznes dhe vlera prej 725,440 lekë për 4 institucione, pra në total **28,770,766 lekë të cilat janë të kontabilizuara.**

-Të ardhura të pa arkëtuara në vlerën **2,600,000 lekë** për 3 subjekte debitore që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve.

-Të ardhura të pa arkëtuara në vlerën **773,644 lekë** për 21 subjekte debitor nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.

-Të ardhura të pa arkëtuara në vlerë **973,000 lekë** nga tarifa e kantierit për 14 subjekte që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Tropojë, të cilat janë të kontabilizuara.

-Të ardhura të munguara në vlerë **360,320 lekë** nga taksa e fjetjes në hotele për 13 subjekte, të cilat janë të pa kontabilizuara.

-Të ardhura të munguara në vlerën **1,600,000 lekë** për 7 subjekte nga gjobat e vendosura nga IMTV, të cilat janë të pa kontabilizuara.

- Të ardhura të munguara në vlerën **20,000 lekë** për 2 subjekte nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake, të cilat janë të pa kontabilizuara.

- Të ardhura të munguara në vlerën **11,021,770 lekë** nga kontratat e qirave për 14 subjekte, të cilat janë të pa kontabilizuara.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se vlera e detyrimeve mbi vendimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2023 nuk është pasqyruar e saktë në Raportin e vetëvlerësimit financiar dërguar në MF. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se detyrimet mbi vendimet gjyqësore të raportuara në MF janë në vlerën **1,384,443 lekë**. Nga përlllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2023, që duhej të raportohet në MF duhet të ishte në vlerën **33,090,778 lekë**.

- Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2023, rezulton se është realizuar në masën 94.5%, ku nga vlera e parashikuar me gjithë shtesa prej 912,151 mijë lekë është realizuar vlera 862,316 mijë lekë. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një vitit më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet.

Investimet është zëri që ka përqindjen më të ulët, ku nga vlera e parashikuar prej 183,468 mijë lekë është realizuar në masën 148,075 mijë lekë ose 80.7 %. Kjo tregon se nga Bashkia Tropojë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, pa u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk ndryshohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Faturat e palikujduara në fund të vitit 2023, konstatohet se janë në vlerën 48,703 mijë lekë, vlerë e cila në raport me totalin e shpenzimeve të vitit prej 862,315 mijë lekë, zë 5.6 %, gjë që tregon se kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare.

-Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Tropojë për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 6,748,542 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën:

- vlera prej 4,768,222 mijë lekë nga kontratat e qirave për 12 subjekte;
  - vlera prej 1,600,000 lekë për 7 subjekte nga gjobat e vendosura nga IMTV;
  - vlera prej 360,320 lekë nga taksa e fjetjes në hotele për 13 subjekte;
  - vlera prej 20,000 lekë për 2 subjekte nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake.
- Gjithashtu konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.
- Nga auditimi i llogarisë 215 “*Mjete transporti*”, u konstatua se kjo llogari, është në vlerën 3,452,393 lekë, si rrjedhojë e mospërputhjes midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare dhe vlerës së inventarizimit. Konkretisht, “Mjete transporti”, në pasqyrën F7 për vitin 2023 është në vlerën 67,084,391 lekë (kosto historike), ndërkohë sipas inventarit fizik rezulton vlera 63,631,998 lekë, ose 3,452,393 lekë më pak.
  - Nga auditimi i llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete në ruajtje*”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 22,449,624 lekë, për garanci të cilave i ka kaluar afati dhe duhet t’u kthehen subjekteve përkatëse.
  - Nga auditimi i llogarive nr. 210 “*Toka, Troje, Terrene*” 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*” të pasqyrave financiare, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:
    - 1). Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj;
    - 2). Vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Tropojë dhe ish Komunave, aktualisht Njësi Administrative.
    - 3). Vlera prej 34,332,096 lekë të trojeve që janë pajisur me certifikatë pronësie.
  - Nga auditimi i llogarisë nr. 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak, për vlerën 5,021,709 lekë, për fatura të mbërritura, të palikujduara në fund të vitit 2023 dhe të pa regjistruara në pasqyrat financiare.
  - Në Bashkinë Tropojë rezultoi se sipas inventarizimit të pronave publike të kostatuara në vitin 2015 nga punonjësit e urbanistikës, rezultojnë troje të zëna në kundërshtim me ligjin dhe nuk është marrë as një masë, nuk ka as një veprim për të administruar dhe manaxhuar këto asete të bashkisë, si dhe nuk ka dokument argumentues ligjor të paraqitura pranë institucioneve përkatëse për ndjekjen procedurave ligjore me institucionet përkatëse për asetet e pronave të zaptuara nga qytetarët konkretisht: Këndi i lojrave për femijë zona kadastrale 1347, emërtimi-trruall, me sipërfaqe 5,883 m<sup>2</sup>, Çerdhe e fëmijëve Dardania emërtimi – trruall + objekt, sipërfaqja 464 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 400 m<sup>2</sup>, dhomë zhveshje e sportit zona kadastrale 1347, sipërfaqja 116 m<sup>2</sup>, fusha futbollit zona kadastrale 1347, sipërfaqja 8,793 m<sup>2</sup>, Terrene sportive sipërfaqe 8,793 m<sup>2</sup> zona kadastrale 1347, Klubi Sportiv Valbona 41.5 m<sup>2</sup> ndërtesë 41 m<sup>2</sup> zona kadastrale 1347, Fushë futbollit, 8,753 m<sup>2</sup> zona kadastrale 1347, nr. pasurie 5/17, zënë nga privati, Zyrrat e klubit Valbona 20 m<sup>2</sup> zona kadastrale 1347, nr. pasurie 5/15 prona sipas VKM-së nr. 397 datë 01.06.2011, i kanë kaluar në administrim të Bashkisë Tropojë
  - Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 33,090,778 lekë ose rreth 68 % e totalit të detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2023 ka kryer likuidime në vlerën **16,973,027** lekë, të detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme.
  - Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Tropojë për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën 4,373,027 lekë, për 9 raste, *të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet*, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Tropojë. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara

të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.

Konstatohet se vlera e detyrimeve mbi vendimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2023 nuk është pasqyruar e saktë në Raportin e vetëvlerësimit financiar dërguar në MF. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se detyrimet mbi vendimet gjyqësore të raportuara në MF janë në vlerën **1,384,443 lekë**. Nga përlllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2023, që duhej të raportohet në MF duhet të ishte në vlerën **33,090,778 lekë**.

**h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:** Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tropojë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **33,117,410 lekë**.

-Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga sektori i burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

-Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrin masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2023, rezultojnë 9,684,375 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-Kryetari i Bashkisë Tropojë në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, Drejtorinë Juridike dhe Kryeinspektorin e IMTV të ndjekin me përpikmëri të gjitha rrugët administrative dhe ligjore kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për arkëtimin e vlerës **1,600,000 lekë**, si rrjedhojë e gjobave të vendosura si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitore.

-IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

-Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me sektorin e Bujqësisë dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore **11,021,770 lekë**, të cilat janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë nga 14 qiramarrësit e tokës bujqësore, pasqyruar në Kapitullin Anekse, si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitore.

-Sektori i Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të ndryshohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

- Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrin masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2023, rezultojnë 9,684,375 lekë të

ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

- Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Tatim Taksave, të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore nga abonentët familjarë, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK Sh.A Tropojë me qëllim që taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë “Familjar” të mbliidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm.

### **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit**

#### **Opinion mbi pasqyrat financiare**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Tropojë, për periudhën ushtrimore 01.01.2023-31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

“Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Tropojë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit “**të modifikuar me rezervë**”, e shprehur kjo në bazën për opinion.

#### **Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik dhe Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit”, pjesë e Raportit Përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000-Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura.

Ne besojmë se, evidencat e auditimit që kemi siguruar, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë (ISA 700-ISSAI 1700). Gjithashtu, dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 13,970 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2023, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Llogaria nr.467 “Kreditor të tjerë” është pasqyruar më pak për vlerën 32,666,178 lekë;
- Llogaria nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është pasqyruar më shumë për vlerën 33,117,410 lekë;
- Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 22,449,624 lekë;
- Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, është pasqyruar më pak për vlerën 6,748,542 lekë;
- Llogaria nr. 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to” është pasqyruar më pak për vlerën 5,021,709 lekë;
- Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 4,960,000 lekë;
- Llogaria nr. 215 “Mjete transporti” është pasqyruar më tepër për vlerën 3,452,393 lekë;

-Llogaria nr. 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” është pasqyruar më pak për vlerën 1,522,723 lekë;  
-Llogaria nr. 327 “Inventar i imët” është pasqyruar më pak për vlerën 307,460 lekë.  
- Bashkia Tropojë ka kryer likujdime nga vendimet gjyqësore në vlerën 16,973,027 lekë, detyrime të mbartura nga vitet e mëparshme, vlerë me efekte negative në buxhetin e bashkisë.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot., 1087/1, datë 11.09.2024, i ndryshuar miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 11.09.2024 deri në datë 18.10.2024, në subjektin Bashkia Tropojë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A. G., përgjegjës grupi;
2. M. M., auditues;
3. H. M., auditues.

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

### 1. Objekti dhe qëllimi i auditimit

Auditimi Financiar në Bashkinë Tropojë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>3</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Objekti i auditimit financiar në Bashkinë Tropojë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2023, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

### Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Tropojë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
2. Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;



3. Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4. Raportimi financiar;
5. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Niveli drejtues i Bashkisë Tropojë (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe të Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keqraportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Tropojë, Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Tropojë kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

### **Përgjegjësitë e audituesve.**

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

**Kriteret e vlerësimit.** Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;

Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; Ligji nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2023”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësisve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

- **Standardet e auditimit.** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899

“Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesis të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**Metodat e auditimit.** Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periodhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit*<sup>1</sup>. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

<sup>1</sup> *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
  - *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
  - *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
  - *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
  - *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

### **Dokumentimi i auditimit.**

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Me shkresën nr. 1087/5, datë 05.12.2024, nga grupi i auditimit të KLSH është nisur Projektraporti i Auditimit në të cilën u evidentuan mangësitë e konstatuara gjatë procesit të auditimit, mangësi të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjor gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

## **III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

Bashkia Tropojë është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Auditimi në subjektin “Bashkia Tropojë”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, *u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi që në gjykimin profesional të pavarur janë materiale por jo të përhapura, etj.*

Nga audituesit u shqyrtua dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektiv, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

### **III.2.1. Përshkrimi i Auditimit, Sipas drejtimeve të auditimit.**

#### **2.1.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditi i Brendshëm.**

-Për trajtimin e nënpikës 2.1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetëtori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Tropojë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit për vitin 2023, rezultoi se:

#### **I. Komponenti “Mjedisi i Kontrollit”:**

**Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”.**

-Bashkia Tropojë përgjatë periudhës nën auditim, viti 2023, ka ushtruar funksionet e veta me Rregulloren e brendshme “Për organizimin, funksionimin e administratës së Bashkisë Tropojë”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9. Për sa i përket hartimit dhe funksionimit të Kodit të Etikës, Bashkia Tropojë për periudhën nën auditim nuk ka një Kod Etike të miratuar në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3.1

-Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në sportelet e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun), duke iu adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të

cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën.

-Rregullorja e Bashkisë Tropojë nuk është përditësuar, duke mos caktuar detyrat dhe përgjegjësitë për një pjesë sektorëve.

**Në lidhje me parimin nr 2** “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”.

-Për vitin 2023, Bashkia Tropojë ka hartuar dhe miratuar plan-veprimin për kontrollin e brendshëm, i cili përfshin aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit.

-Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

**Në lidhje me parimin 3** “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

-Nga auditimi rezulton se lidhur me strukturën organizative, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Tropojë ka miratuar strukturën organizative për vitin 2023 me VKB nr. 125, datë 29.12.2022

-Bashkia Tropojë ka gjithsej 412 punonjës, ndër të cilët: 392 janë punonjës të përhershëm, 20 janë punonjës të përkohshëm.

-Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme.

-Me shkresën me nr 109/1 prot., datë 06.01.2023, është miratuar Plani Vjetor i Punës për vitin 2023.

-Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

-Me krijimin e Drejtorisë së Pyjeve dhe inkorporimit të saj në Strukturën e vitit 2023, nuk është përditësuar Rregullorja e Bashkisë Tropojë, duke mos përfshirë në të objektivat, detyrat dhe kompetencat e kësaj Drejtorie në funksionimin e aparatit administrativ të Bashkisë Tropojë.

**Në lidhje me parimin 4** “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”.

-Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve të detyrueshëm ofruar nga ASPA pjesë e procedurës për përfundimin e statusit të nëpunësit civil. Nga auditimi rezultoi se nga Bashkia Tropojë, konkretisht struktura përgjegjëse e saj, Sektori i Burimeve Njerëzore, nuk ka hartuar plane vjetore trajnimesh të brendshme, të detyrueshme për punonjësit e saj. Mos hartimi i planeve vjetore të trajnimeve nuk mundëson një trajnim efektiv të personelit në përputhje me pozicionin në strukturë. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit. Për sa më sipër, përgjegjësia i takon znj. K A me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Manualin për MFK, paragrafi 3.1.

-Për Bashkinë Tropojë Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

-Për vitin 2023, detyra e nëpunësit zbatues është mbuluar nga Përgjegjësi i Financave, znj. E D. Znj. D ka pasur arsimimin e duhur për ushtrimin e kësaj detyre në përputhje me përcaktimet e ligjit.

-Me Urdhërin nr. 21/1 datë 17.01.2023, titullari ka emëruar në rolin e Koordinatorit të Riskut, z. A. K. me detyrë nënkryetar bashkie.

-*Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*

Bashkia Tropojë me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 132/5 datë 05.02.2023. Nga ana tjetër nuk u konstatua mbajtja e procesverbaleve ku të jenë dokumentuar takimet e GMS realizuar gjatë vitit 2023; Në Ligjin nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe

“Manualin për MFK” citohet se “Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mbliidhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe nëpërputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, 12 dhe 27; “Manuali MFK” Kreu II kap. 2.2.6;

## **II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”**

**Në lidhje me parimin 6:** Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.

-Nga Bashkia Tropojë përcaktohen objektiva sasior. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk janë miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, në kundërshtim me kërkesat ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 32, neni 8, pika 8 të Ligjit nr. 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

**Në lidhje me parimin 7:** “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

-Nuk janë krijuar në mënyrë të plotë mekanizmat për vlerësimin e riskut.

-Nga Bashkia Tropojë nuk është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, si dhe Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016. Përgjegjësia për sa më sipër i takon z. A K, nënkryetar i Bashkisë Tropojë, i cili mban edhe detyrën e Koordinatorit të Riskut sipas përcaktimeve të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike”, pika 3.2.2

-Për vitin 2023, me shkresën me nr. 109/2 prot., datë 06.01.2023 është miratuar regjistri i riskut.

-Në Bashkinë Tropojë Sektori i Financës dhe Buxhetit për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin Excel dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

-Nga auditimi rezulton se, gjurmët standarde të auditimit nuk janë hartuar dhe miratuar nga titullari i njësisë, si një dokument i unifikuar për të gjitha proceset e Bashkisë Tropojë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 dhe 122. Për sa më sipër mban përgjegjësi titullari i Bashkisë Tropojë, z.R B.

**Në lidhje me parimin 8:** “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

-Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

**Në lidhje me parimin 9:** “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Tropojë ka hartuar Planin për Kontrollin e Brendshëm dhe Regjistrin e Riskut për vitin 2023.

## **III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”**

**Në lidhje me parimin 10:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

-Megjithëse është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk janë miratuar plane zhvillimi strategjikë me afat jo më pak se sa 5 vjet, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32. Nuk ka plan-veprime vjetore operationale të miratuar, për arritjen e qëllimeve të politikave afatmesme.

-Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut.

-Me shkresën nr. 109, prot., datë 06.01.2023 titullari ka miratuar hartën e procesve të punës.

-Me Urdhrin nr. 97/1 datë 01.06.2020, Bashkia Tropojë ka ngritur Njësinë e Sinjalizuesit. Me shkresën nr. 764/3 prot., datë 28.12.2021, titullari i Bashkisë Tropojë ka miratuar Rregulloren për Hetimin Administrativ të Kërkesës së Sinjalizuesit “Për Mbrojtjen nga Hakmarrja në Bashkinë Tropojë”.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj.

-Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.

-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Tropojë.

-Bashkia Tropojë në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për çdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponibiliteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.

**Në lidhje me parimin 11:** “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

-Mungon sistemi i IT dhe nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up). Nuk ka rregulla të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit IT. Nuk ka procedura të veçanta të shkruara, mbi sistemet IT, të cilat përdoren në Bashkinë Tropojë, të cilat i janë bërë me dije stafit. Aktualisht nuk ka një manual të shkruar për sigurinë e IT. Mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të IT të miratuar nga Kryetari.

**Në lidhje me parimin 12:** “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Financës.

#### **IV. Komponenti: “Informimi dhe Komunikimi”**

**Në lidhje me parimin 13:** “Njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

-Bashkia Tropojë ka faqen e saj zyrtare në ëeb me adresë <https://www.bashkiatropojë.gov.al/> Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprohet me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**Në lidhje me parimin 14:** Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor.

-Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion të pamjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit. Ky konstatim edhe si rrjedhojë e mungesës së trajnimeve të brendshme për punonjësit e niveleve të ndryshme të këtij institucioni.

**Në lidhje me parimin 15:** Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.



-Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë shkresore/verbale/email.

#### **V. Komponenti: “Monitorimi dhe Raportimi”**

**Në lidhje me parimin 16:** “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

-Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit.

-Bashkia Tropojë lidhur me pyetëtorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MF për vlerësimin e sistemeve për vitin 2023 me shkresën nr. prot., 1245/3 datë 28.02.2024. Raporti i Cilësisë së Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm paraqet problematikat në 5 komponentët e MFK. Të pesta elementet e MFK janë trajtuar në Raport, së bashku me çfarë është menduar të zgjidhet dhe organet përgjegjëse për problematikat e caktuara.

**Në lidhje me parimin 17:** “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

-Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3., Kreu II paragrafi. 2.2.6; kap 5, Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, 12 dhe 27, neni 21, pika 2, nen 16, pika 2, Udhëzimi nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e 122, Udhëzimi i MFE nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike”, pika 3.2.2

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi: z. R. B, Kryetar i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e nëpunësit autorizues, z. A. K, nënkryetar i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Koordinatorit të Riskut, znj. K. A, Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe është vijuar më tej me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### **III.2.1.2. Auditim mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.**

-Nga auditimi i kryer, u konstatua se Bashkia Tropojë nuk ka ngritur strukturën e Njësisë së Auditit të Brendshëm sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 10, si dhe pikës 1 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

-Nga procesi i auditimit u konstatua se me shkresën nr. 2027 prot., datë 15.05.2020 me lëndë “Informacion për sektorin e Auditimit të Brendshëm”, është vënë në dijeni Ministria e

Financave dhe Ekonomisë për shkrimin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, për shkak se nga Titullari i Bashkisë Tropojë është konstatuar performancë e dobët në punë dhe është arsyetuar se nëse lind nevoja do të paraqitet projekt-vendim në Këshillin Bashkiak, sipas rasteve për të marrë audit të specializuar nga jashtë. Bashkia Tropojë nuk ka lidhur kontratë me institucione të tjera vendore për realizimin e këtij shërbimi.

Mosfunksionimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Tropojë vjen në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenin 10 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” si dhe pikën 1 të VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të brendshëm në sektorin publik”, ku përcaktohet se në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore krijohet njësi e auditimit të brendshëm.

Për sa më sipër mban përgjegjësi z. R. B, me detyrë Kryetar i Bashkisë Tropojë.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe është vijuar më tej me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **III.2.2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit**

#### **2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se për vitin 2023 për përgatitjen e PBA 2023-2025 dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.125, datë 22.12.2022, si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën nr. 3/2 prot., datë 10.01.2023. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, reabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Tropojë.

Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

- a. Përmirësimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit;
- b. Përmirësimi i rrjetit rrugor rural;
- c. Menaxhimi i mbetjeve urbane;
- d. Ndriçimi i rrugëve;
- e. Përmirësimi i kushteve për turizmin;
- f. Ofrimi i shërbimeve publike;

PBA janë hartuar pjesërisht sipas Udhëzimit të MFE nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Programi i të ardhurave për vitin 2023 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr. 102, datë 01.12.2022.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Tropojë për vitin 2023 është 862,315 mijë lekë.

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2023, realizohen nga dy burime:

**Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

**Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.1, PBA për periudhën 2023-2025 sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Tropojë

Nr.	Kodi	Programi	PBA Plan viti 2023	Buxheti vjetor 2023 Plani i Rishikuar	Realizimi i periudhës progresiv	Diferenca 4 = (3-2)
			1	2	3	4
1	1110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	75,348,000	129,528,297	116,893,315	12,634,982
2	3280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	17,452,000	18,226,825	17,197,964	1,028,861
3	4130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	0	140,273	140,273	0
4	4240	Menaxhimi i Infrastruktues së Ujitjes dhe Kullimit	3,484,000	8,309,404	7,209,698	1,099,706
5	4520	Rrjeti Rrugor Rural	133,653,000	131,912,666	110,013,748	21,898,918
6	4260	Administrimi I pyjeve	15,578,000	16,826,000	16,101,291	724,709
7	4970	Emergjencat Civile		7,340,370	6,788,200	552,170
8	4980	Keshilltaret		8,000,000	7,769,668	230,332
9	6190			4,064,718	3,537,299	527,419
10	6260	Shërbimet Publike Vendore	53,397,000	85,499,436	84,141,419	1,358,017
11	6370	Furnizim me Uje		4,713,000	4,712,960	40
12	8130	Sport dhe Argëtim	5,053,000	5,957,338	5,957,338	0
13	8220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	3,796,000	3,731,025	3,720,631	10,394
14	9120	Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin	59,738,000	89,206,347	89,065,351	140,996
15	9230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	5,238,000	4,931,000	4,807,620	123,380
16	10140	Cerdhja ditore		5,886,416	4,889,962	996,454
17	10430	Përkujdesi Social	4,446,000	352,183,000	349,251,310	2,931,690
18	10910	Emergjencat Civile		25,850,845	20,297,801	5,553,044
19	10661	Strehimi social	500,000			
20	1170	Gjendja civile		7,985,208	7,962,350	22,858
21	1620	Zgjedhjet e pergjithshme lokale		1,858,100	1,857,000	1,100
<b>Totali i shpenzimeve të njësisë</b>			<b>377,683,000</b>	<b>912,150,268</b>	<b>862,315,198</b>	<b>49,835,070</b>

*Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2023-2025, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 49,835 mijë lekë. Diferencë e konsiderueshme rezulton në programin ekonomik për “Rrjeti Rrugor Rural”, “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, “Emergjencat Civile”, “Përkujdesi Social” dhe “Shërbimet Publike Vendore”.

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për periudhën 2023-2025 Bashkia Tropojë ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2, Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Planifikimi 2023
Te ardhura tatimore	35,080
Te ardhura jotatimore	21,920
<b>TOTAL</b>	<b>57,000</b>

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

### **Në vecanti nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2023-2025, u konstatua se:**

-Për PBA 2023-2025 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Tropojë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Për PBA 2023-2025, nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit, sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-Për PBA 2023-2025 nuk kanë gjetur zbatim kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore”, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore të Bashkisë Tropojë, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Tropojë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (nuk është bërë analize e detajuar);

- Tavanet Përgatitore dhe tavanet Përfundimtare të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve;

- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga EMP dhe GMS-ja;

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 7, datë 26.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025”.

-Në buxhetin vjetor të vitit 2023, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020.

### **2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të celura.**

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj. të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit parardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Tropojë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MF. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Tropojë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit Tropojë, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Kukës.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr. 3, Planifikimi i buxhetit për vitin 2023, Bashkia Tropojë

000/lekë

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2023	
		Të ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës	28,949	
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	27,195	
3	Trashëguar nga transfera specifike		
4	Të trashëguara nga FZHR		
5	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	57,000	
6	Granti ( Transfera e pakushtëzuar )	244,679	
7	Transferta specifike	109,451	
8	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)		235,156
9	Shpenzime operative (602)		58,861
10	Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar		164,207
11	Fondet emergjencë dhe fondet rezervë		9,050
12	Investime (230+231) nga buxheti i shtetit		0
13	Shpenzime (603+604+606)		0
<b>Totali i buxhetit</b>		<b>467,274</b>	<b>467,274</b>

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashki + Njësitë e Varësisë) për vitin 2023 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **467,274 mijë lekë**.

Përgjatë vitit 2023, kanë ndodhur 7 ndryshime buxhetore me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, veprime që tregojnë për planifikime jo optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv.

Tabela nr.4, Ndryshimet buxhetore për vitin 2023

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr. datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli			
					Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma
Viti 2023	125/22.12.2022	411,131	VKM nr 260 dt 27.04.2023	20,719	231	20,719		

Periudha Buxhetore	Buxheti fillestar		Ndryshime gjatë viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr. datë	Vlera	Nr. Datë	Vlera	Pakësuar artikulli / shtuar artikulli			
					Shtesa. Art.	Shuma	Pakësim. Art.	Shuma
			Shkresa nr 1278/20 prot dt 13.09.2023	2,162	231	2,162		
			Shkresa nr 12674 prot dt 10.07.2023	7,898	600	6,026		
			Shkresa nr 8321 prot dt 08.05.2023	4,377	601	1,873		
			Shkresa nr 10045/2 dt 22.11.2022	3,000	600	3,827		
			Shkresa nr 4457/18 dt 28.12.2023	4,775	601	550		
			Shkresa nr 5873/1 dt 29.12.2023	29,657	606	3,000		
			Shkresa nr 4457/18 dt 28.12.2023	4,775	606	4,775		
			Shkresa nr 5873/1 dt 29.12.2023	29,657	602	29,657		
			Shkresa nr 6109 dt 26.06.2023	1,632	600	1,632		
<b>Totali Viti 2023</b>								

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.5, Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik

Nr.	Kodi	Programi	Plani progresiv	Fakti	%
1	1110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	129,528,297	116,893,315	90
2	3280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	18,226,825	17,197,964	94
3	4130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	140,273	140,273	100
4	4240	Menaxhimi i Infrastruktues së Ujitjes dhe Kullimit	8,309,404	7,209,698	87
5	4520	Rrjeti Rrugor Rural	131,912,666	110,013,748	83
6	4260	Administrimi I pyjeve	16,826,000	16,101,291	96
7	4970	Emergjencia Civile	7,340,370	6,788,200	92
8	4980	Keshilltaret	8,000,000	7,769,668	97
9	6190		4,064,718	3,537,299	87
10	6260	Shërbimet Publike Vendore	85,499,436	84,141,419	98
11	6370	Furnizim me Uje	4,713,000	4,712,960	100
12	8130	Sport dhe Argëtim	5,957,338	5,957,338	100
13	8220	Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	3,731,025	3,720,631	100
14	9120	Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin	89,206,347	89,065,351	100
15	9230	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	4,931,000	4,807,620	97
16	10140	Cerdhja ditore	5,886,416	4,889,962	83
17	10430	Përkujdesi Social	352,183,000	349,251,310	99
18	10910	Emergjencia Civile	25,850,845	20,297,801	79
19	10661	Strehimi social			
20	1170	Gjendja civile	7,985,208	7,962,350	100
21	1620	Zgjedhjet e pergjithshme lokale	1,858,100	1,857,000	100
<b>Totali i shpenzimeve të njësisë</b>			<b>912,150,268</b>	<b>862,315,198</b>	<b>94.5</b>

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:

**Për vitin 2023** realizimi i buxhetit është në nivelin 94.5 %, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është “Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin”, “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik”, “Sport dhe Argëtim, dhe “Furnizim me Ujë; Programi me realizimin më të ulët e ka “Rrjeti Rrugor Rural”;

### **2.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.**

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Tropojë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar

proçedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Tropojë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2023-2025, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.6, Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2023

Art.	Emertimi	Plani progresiv	Fakti	%
600	Paga	232,226	232,178	99.9%
601	Sigurime Shoqërore	38,230	38,139	99.7%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	90,012	79,724	88.5%
604	Transferta Korente të Brendshme	7,262	7,028	96.7%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	360,953	357,172	98.9%
230	Kapitale të Trupëzuara			
231	Kapitale të Trupëzuara	183,468	148,075	80.7%
	<b>TOTAL</b>	<b>912,151</b>	<b>862,316</b>	<b>94.5%</b>

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2023 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 94.5%, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 600 dhe 601 “Paga dhe sigurime shoqërore” duke vijuar me shpenzime për “Transferta për Buxhet Familjar dhe Individ”, shpenzime për transferta korente të brendshme si dhe realizimin më të ulët e kanë kapitale të trupëzuara. Vihet re se për vitin 2023 art. (231) investime paraqitet 80.7 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

### **Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.**

Tabela nr.7, Buxheti sipas burimeve të financimit 2023

Nr	Emërtimi	Viti 2023						
		Plani fillim Viti Sipas VKB	Çelja në Thesar sipas akt rakordimit	Fakti sipas aktrakordi mit	Të ardhurat e veta	Transf. Pakushtez Spec.	Transf. Kusht. Funk Deleg	Transf. Kushtëz për Investime
1	Paga (600)	200,136	232,226	232,178	10,238	212,893	9,047	
2	Sigurime (601)	35,020	38,230	38,138	3,929	33,155	1,055	
3	Shpenzime (602)	58,860	90,012	79,724	13,214	66,195	315	
4	Shpenzime (604)	0	0	0	0	0	0	
5	F. Rezervë (604)	9,050	7,262	7,028	0	2,970	4,058	
6	Fondi Veçantë	0	0	0	0	0	0	
7	Investim (230+231)	164,207	183,468	148,075	34,918	65,553	0	47,603
8	Transferta 606	0	360,953	357,172	0	3,818	353,354	
	<b>Totali</b>	<b>467,273</b>	<b>912,151</b>	<b>862,315</b>	<b>62,299</b>	<b>384,584</b>	<b>367,829</b>	<b>47,603</b>

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferta e pa kushtëzuar dhe specifike, në vlerën 384,584 mijë lekë ose 44.6 % të fondeve të shpenzuara për vitin 2023, për të vijuar me transfertën e kushtëzuar për funksione të deleguara në vlerën 367,829 mijë lekë ose 42.6 % të fondeve sipas burimit të financimit, të ardhurat e veta në vlerën 62,299 mijë lekë ose 7% të fondeve sipas burimit të financimit dhe transferta e kushtëzuar për investime në vlerën 47,603 mijë lekë.

### **Transferta e pa kushtëzuar specifike.**

-Buxheti nga transferta e pa kushtëzuar dhe specifike për vitin 2023 është realizuar në vlerën 384,584 mijë lekë, ose 44.6 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda transfertës pa kushtëzuar dhe specifike, e zënë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

### **Transferta e kushtëzuar për funksione të deleguara.**

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për funksione të deleguara për vitin 2023 është realizuar në vlerën 367,829 mijë lekë, ose 42.6 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën

kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara Transferta për familje dhe individ dhe për paga.

#### **Të ardhurat e veta.**

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2023 është realizuar në vlerën 62,299 mijë lekë, ose 7 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime, shpenzime operative dhe paga.

#### **Transferta e kushtëzuar për investime**

-Buxheti nga transferata e kushtëzuar për investime për vitin 2023 është realizuar në vlerën 47,603 mijë lekë, ose 5.5 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2023, ku peshën kryesore e zënë fondet e shpenzuara për investime.

#### **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.**

Me miratimin e buxhetit për vitin 2023 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin 2023 është planifikuar në masën 7,340 mijë lekë me burim nga transferata e pakushtëzuar. Sipas të dhënave nga Bashkia Tropojë nga fondi rezerve/dhe kontigjencës janë shpenzuar 6,788 mijë lekë, për përballimin e shpenzimeve për ndihmë financiare për arsye shëndetësore dhe persona të cilët janë në vështirësi ekonomike, pagesë për dhënie qiraje për banesa për strehim, dëmtime banese etj. Në fund të vitit 2023, nga fondi rezervë/dhe i kontigjencës ka mbetur pa u shpenzuar në vlerën 552 mijë lekë nga ky fond.

-Totali i fondit rezervë dhe kontigjencës është brenda limitit 3%, përjashtuar transfertën e kushtëzuar.

#### **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.**

Nga Bashkia Tropojë është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2023 është planifikuar në vlerën 4,061 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 4,058 mijë lekë, për mbulimin e shpenzimeve për ndihmë financiare për djegie banese.

#### **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Tropojë.**

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Tropojë përgjatë periudhës 2023 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

#### **Realizimi i Investimeve.**

Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele jo të mira në vitin 2023, konkretisht në masën 80.7 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Tropojë në fillim të vitit buxhetor planifikon procedurë të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Neni 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### **Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 - mujor në Këshillin Bashkiak.**

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në



*Njësitë e Qeverisjes Vendore*”, si dhe nenin 44<sup>2</sup>, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konstatohet se për vitin 2023 nuk administrohet raporti i monitorimit të buxhetit për 4 - mujorin e parë dhe 4 - mujorin e dytë të vitit dhe me shkresën nr. 2198 prot., datë 13.05.2024 ka përcjellë në Ministrinë e Financave raportin vjetor të monitorimit të buxhetit. Pra për 4 - mujorin e parë dhe 4 - mujorin e dytë të vitit nuk e ka përcjellë në Ministrinë e Financave raportin e monitorimit të buxhetit. Konstatohet se për 4 - mujorin e tretë të vitit raporti i monitorimit nuk është përcjellë në Këshillin Bashkiak një kopje e raportit të monitorimit të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 48 të ligjit nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si dhe është dërguar jashtë afateve të përcaktuara në pikën 45 dhe pikën 270 në Udhëzimin nr. 9 datë 20.03.20218 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

**2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.)**

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Tropojë, rezulton se, është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2023 janë raportuar në MF, pra jo raportim periodik të tyre dhe nuk janë përcjellë në Këshillin Bashkiak.

Me fondet buxhetore të vitit 2023, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023 ka ardhur duke u ulur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2023.

Tabela nr.8, Detyrimet e prapambetura për periudhën 2023

Detyrime	Detyrimi në fund të vitit 31.12.2022	Detyrimi i krijuar 01.01.2023-31.12.2023	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2023	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023
Investime	63,850		63,850	23,104	40,746
Investime nga FZSH					
Mallra dhe shërbime	3,395	4,090	7,485	912	6,574
Vendime gjyqësore	3,755		3,755	2,371	1,384
Të tjera					
<b>Totali</b>	<b>71,000</b>	<b>4,090</b>	<b>75,090</b>	<b>26,387</b>	<b>48,704</b>

*Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Tropojë ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2023, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Tropojë ndaj palëve të treta raportuar në MF është në vlerën **48,703,865 mijë lekë**, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale dhe vendime gjyqësore pasqyruar në tabelën më poshtë:

<sup>2</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

Tabela nr.9, Situata Financiare për vitin 2023

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	0		
a	Hua sftatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	<b>Hua afatshkurtër</b>	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>	<b>48,703,865</b>		
a	<b>Shpenzime korrente</b>			
a,1	Mallra dhe shërbime	1,278,783		
a,2	Paga dhe sigurime			9.78 %
a,3	Të tjera	1,299,766		
b	<b>Shenzime kapitale</b>			
b,1	Institucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
c	<b>Vendime gjyqësore</b>	<b>1,384,443</b>		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime	3,995,000		
c,3	Investime	<b>40,745,873</b>		
c,4	Të tjera			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>48,703,865</b>	<b>498,014,754</b>	<b>9.78 %</b>

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, çfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:

“Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta”, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrat, faturë ose sipas ligjit”. “Detyrimet e prapambetura rregjistrohen në llogarinë ekonomike nr. 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”<sup>3</sup>.

“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2023, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr. 486 në debi të llogarisë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2023”<sup>4</sup>.

-Pra sa më sipër vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është në masën 8 % ndaj totalit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2023.

Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 15% të shpenzimeve vjetore të miratuara, ç’ka do të thotë se Bashkia Tropojë në fund të vitit 2023 rezulton në një situatë normale.

### **Detyrimet nga vendimet gjyqësore**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 33,090,778 lekë ose rreth 68 % e totalit të detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2023 ka kryer likuidime në vlerën **16,973,027 lekë**, të detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme. Në fund të vitit 2023 Bashkia Tropojë ka pasur fonde në dispozicion në vlerën 106,217,052 lekë, të cilat mund t’i përdorte për likuidimin e plotë të vendimeve gjyqësore si dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj

<sup>3</sup> Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

<sup>4</sup> Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar”.

personit/personave që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Tropojë.

Konstatohet se vlera e detyrimeve mbi vendimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2023 nuk është pasqyruar e saktë në Raportin e vetëvlerësimit financiar dërguar në MF. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se detyrimet mbi vendimet gjyqësore të raportuara janë në vlerën **1,384,443 lekë**. Nga përlllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2023, që duhej të raportohet në MF duhet të ishte në vlerën **33,090,778 lekë**.

Nga kryqëzimi i të dhënave mbi detyrimet e Bashkisë Tropojë ndaj palëve të treta, kryesisht të detyrimeve të krijuara si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, konstatohet se:

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 587, datë 06.07.2015 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Tropojë është krijuar detyrimi për shpërblim page për largim nga puna dhe kthimin në vendin e punës në favor të subjektit “M. Gj”, në vlerën 849,200 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2023 është kryer likuidim pjesor në vlerën 424,600 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 424,600 lekë.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 141, datë 27.10.2020 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Tropojë është krijuar detyrimi për shpërblim page për largim nga puna në favor të subjektit “A. Z”, në vlerën 1,406,021 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2023 është kryer likuidim pjesor në vlerën 803,011 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 603,010 lekë.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 469, datë 13.12.2021 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Tropojë është krijuar detyrimi për shpërblim page për largim nga puna në favor të subjektit “A. D”, në vlerën 1,000,994 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2023 është kryer likuidim pjesor në vlerën 575,497 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 425,497 lekë.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 1, datë 24.05.2022 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Tropojë është krijuar detyrimi për shpërblim page për largim nga puna në favor të subjektit “Xh. Ç”, në vlerën 720,384 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2023 është kryer likuidim pjesor në vlerën 460,192 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 260,192 lekë.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 282, datë 13.09.2021 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Tropojë është krijuar detyrimi për shpërblim page për largim nga puna në favor të subjektit “S. S”, në vlerën 1,024,800 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2023 është kryer likuidim pjesor në vlerën 762,400 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 262,400 lekë.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 35, datë 05.02.2020 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Tropojë është krijuar detyrimi për shpërblim page për largim nga puna në favor të subjektit “F. H”, në vlerën 1,026,462 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2023 është kryer likuidim pjesor në vlerën 513,231 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 513,231 lekë.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 7, datë 27.01.2022 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Tropojë është krijuar detyrimi për shpërblim page për largim nga puna në favor të subjektit “J.P”, në vlerën 599,092 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2023 është kryer likuidim pjesor në vlerën 299,546 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 299,546 lekë.

-Si rrjedhojë e Vendimit nr. 1, datë 23.07.2020 të Gjykatës së Apelit, ndaj Bashkisë Tropojë është krijuar detyrimi për shpërblim page për largim nga puna në favor të subjektit “D. M”, në vlerën 469,100 lekë. Ndaj këtij subjekti, deri në 31.12.2023 është kryer likuidim pjesor në vlerën 234,550 lekë dhe mbetet për likuidim vlera 234,550 lekë.

Si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore nga vitet e mëparshme për personat e larguar nga puna përgjatë vitit 2023 janë likuiduar në vlerën **4,373,027 lekë** dhe në fund të vitit 2023 janë në vlerën **3,023,026 lekë**, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona.

-Gjithashtu konstatohet se për likuidimin e subjekteve të mësipërme është nxjerrë urdhëri përkatës nga titullari i institucionit, por në urdhrin e likuidimit nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit/personave që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Tropojë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”.

### **Shpronësimet për interes publik.**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Financës dhe Buxhetit rezultoi se ndaj Bashkisë Tropojë është krijuar detyrimi për shpronësimin e 5 subjekteve në vlerën 5,776,966 lekë. Ky detyrim është likuajduar përgjatë vitit 2023 nga Bashkia Tropojë sipas VKM nr. 696, datë 18.11.2021 për “Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga projekti “Ndërtimi i Unazës së Qytetit Bajram Curri Faza II” Tropojë. Më poshtë pasqyrohet në formë tabelare vlera e shpronësimit për çdo subjekt:

Nr.	Pronari	Vlera e shpronësimit	% e pjesëmarrjes në financim Bashkia	Likuajdimet nga Bashkia	Vlera e mbetur e palikuajduar deri në 31.12.2023
1	U. H	1,017,487		1,017,487	0
2	Sh. Gj	1,453,918		1,453,918	0
3	B. K	1,161,153		1,161,153	0
4	K. O	1,595,615		1,595,615	0
5	B. N	548,793		548,793	0
		<b>5,776,966</b>		<b>5,776,966</b>	

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

### **Faturat e palikuajduara brenda afatit 30 ditor.**

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Tropojë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2023, ky afat nuk është respektuar në 22 raste për vlerën 48,703,865 lekë, pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë, në Kapitullin “Anekse”.

Tabela nr.10, Përmbledhëse e faturave deri me 31.12.2023

Artikulli	Sasia	Viti 2023/lekë
230-231	4	39,075,250
602	18	9,628,615
<b>Totali</b>	<b>22</b>	<b>48,703,865</b>

Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën deri në fund të vitit 2023 janë 22 fatura të palikuajduara për shpenzime për investime, shpenzime për vendime gjyqësore, shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 48,703,865<sup>5</sup> lekë.

-Likuidim me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

### **2.5. Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.**

Nga auditimi i evidencave të marra nga Sektori i Financës dhe Buxhetit për vitin 2023, në lidhje me investimet publike, rezultoi se, nuk ka financim projektsh nga FSHZH/FZHR. Nga Ministritë e Linjës për vitin 2023, rezulton se janë financuar 2 projekte investimi me vlerë kontrate 64,349,980 lekë, pasqyruar në tabelat si më poshtë vijon:

<sup>5</sup> Analitikisht pasqyruar në Anekse.

Tabela nr.10, Fonde të deleguara për vitin 2023 nga Ministria e linjës për investime të cilat kanë filluar në vitin 2021 kanë vazhduar në vitin 2022 dhe sipas kontratave përfundojnë në vitin 2023 ose janë në proces gjatë vitit 2023 si dhe likujtimi i tyre

Viti 2023 – Për investime të cilat kanë filluar para vitit 2023 dhe sipas kontratës përfundojnë në vitin 2023, si dhe për investime të cilat kanë nisur brenda vitit 2023									
Nr.	Objekti i investimit	Burimi Financimit	Op. Fitues	Dt.Lidhjes kontrates	Vl. Kont. me t.v.sh	Marrë në dorëzim	Situacionuar 31.12.2023	Likujduar 31.12.2023	Mbetje 31.12.2023
1	Rikonstruksion i Kanaleve vaditese	B1	OE "V"	26.04.2023	2,287,165	31.08.2023	situacion nr 1 dt 12305.2023	2,280,366	6,799
2	Asfaltim i rrugeve Mbushje gropash	B1+B5	BOE V & G	26.04.2023	6,696,918				6,696,918
3	Ndërtim e rikonstruksion urash	Min 17 /B1	Rr G	4.12.2023	19,183,238		situacion nr 1	15,217,473	3,965,766
4	Sistemim Asfaltim Rruga Bukove Luzhe	B1	Sh	4.5.2023	27,919,401				27,919,401
5	Rikonstruksion i rruges Bylbyl Breçan	B5	BOE V & G	4.5.2023	50,910,205		situacion nr 1	9,376,365	41,533,840
6	Rikonstruksion i salles se muzeut	B1	HTSH	8.8.2023	1,522,723	29.09.2023			1,522,723
7	Rikonstruksion i rruges se fshatit Kasaj	B5	N	4.5.2023	69,023,526		situacion nr 1	20,261,160	48,762,366
8	Rikonstruksion rruga Blini i Grise- Lekurtaj	B5	V	17.05.2022	12,095,860	28.03.2023	situacion perfundimtar	6,000,000	6,095,860
9	Mirembajtje kanalet vaditese	B1	V	26.05.2022	5,113,934			5,113,934	
10	Sistemim asfaltim i lagjes dardania	B1	"Z" sh.p.k.	24.02.2023	32,423,421			6,594,130	25,829,291
11	Rikualifikimi urban i lagjes Partizani Blloku 1&2.	B1	BOE N & R. C	24.02.2022	64,460,799		situacion nr 1	13,001,057	51,459,742
12	Rikonstruksion segmenteve rrugore	B1	"4 A" & " F & V sh.p.k.	18.12.2020	408,506,281	06.03.2023	situacion perfundimtar	247,364,390	161,141,891
13	Rikonstruksion Thertore Shudenic + Ndërtim i tregut te Bagetive	B1	BOE O & T	08.07.2022	15,213,720		situacion nr 1	7,466,704	7,466,704
14	Rrehi dekorativ i stadiumit te lojrave me dore	B1	HTSH	26.04.2023	3,985,544	18.10.2023	situacion nr 1/situacion nr 2	3,274,658	710,886
15	Instalim Sistemi Semaforik Kryqzimi i Dragobise.	B5	I.D.K K		3,690,201			3,690,201	0
16	Sistemim i Tregut Industrial Lagja Dardani	B1	HTSH	06.12.2022	2,393,296	17.04.2023	situacion nr 1/situacion nr 2	2,392,849	447
17	Rikonstruksion i shkolles Oso Dauti Njesia Administrative Llugaj	Min 11/ B1	Sh -AL	23.12.2022	45,166,742	05.12.2023	situacion nr 2	45,274,714	-107,972
<b>Total</b>					<b>770,592,975</b>			<b>387,308,001</b>	<b>383,284,973</b>

*Burimi: Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

-Për vitin 2023, Bashkia Tropojë ka lidhur kontratë për investim me objekt “Ndërtim rikonstruksion urash” me burim financimi Ministria e Mbrojtjes. Vlera e investimit është 19,183,238 lekë, deri në 31.12.2023 për këtë objekt është likujduar nga fondet e përcjella nga Ministria e Mbrojtjes në vlerën 15,217,473 lekë.

-Për vitin 2022, Bashkia Tropojë ka lidhur kontratë për investim në punë publike me objekt “Rikonstruksion i shkollës Oso Dauti Njësia Administrative Llugaj” me burim financimi nga Ministria e Arsimit. Vlera e investimit është 45,166,742 lekë, deri në 31.12.2023, për këtë objekt janë likujduar fondet e përcjella nga Ministria e Arsimit në vlerën 45,274,714 lekë.

-Kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara, por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga ministritë e linjës.

-Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Tropojë dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe është vijuar më tej me hartimin e Reportit Përfundimtar të Auditimit.

**2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Ligjshmëria e lidhjes së kontratës për dhënie me qira të aseteve dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.**

Në zbatim të pikës III.2.2.6 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023
- Vendim i Këshillit Bashkiak për miratimin e buxhetit për vitin 2023.
- Rregjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.
- Rakordimet me agjentët tatimor.
- Evidenca e planifikimit të të ardhurave.
- Aktet e rakordimit me degën e thesarit për të ardhurat.
- Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave, në lidhje me çështjen e të ardhurave.

**Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.**

*-Dokumentacioni i shqyrtuar për auditimin e të ardhurave.*

Në auditimin e kryer mbi burimin e krijimit të ardhurave dhe përdorimi i tyre u audituan dokumentacioni i paraqitur nga Sektori i Tatim Taksave si: Evidencat analitike të llogarive debitorë për taksat dhe tarifave vendore, akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga tatim taksat vendore, evidencat mbi gjendjen e debitorëve për taksat dhe tarifave vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare, regjistrat e bizneseve, administrimi i aseteve, procedura e lëshimit të licencave dhe autorizimeve, si dhe dokumente mbi procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, Vendimet e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale dhe për strukturën organike.

*-Struktura e Sektorit të Tatim Taksave, Bashkia Tropojë.*

Për vitin 2023 me Vendim të Këshillit Bashkiak VKB nr. 125, datë 22.12.2022, nr. 5547/ prot., datë 29.12.2022, është miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Kukës me shkresën nr.3/2, datë 10.01.2023. ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe sektori i tatim - taksave.

Sektori i taksave në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave bashkëpunon edhe me sektor të tjerë pranë Bashkisë, si ai i pronave, pyjeve, urbanistikës, infrastrukturës, si dhe me inspektorët e taksave, për çdo Njësi Administrative, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, si dhe roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim, dokument i cili i shërben subjektit për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

-Sektori i tatim - taksave ka në përbërjen e saj, 1 përgjegjës sektori dhe 5 specialistë.

Tabela nr.12, Struktura e Sektorit të taksave dhe tarifave Bashkia Tropojë, si dhe lëvizjet e punonjësve përgjatë vitit 2023 pasqyrohet si më poshtë:

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Lartë ose i mesëm	Urdhri i emërimit Nr. datë	Urdhri largimit Nr. datë	Pozicioni i punës
a	b	1	2	3	4	5	6
1	K. S	Përgjegjës	Ekonomik	Lartë	15.11.2022	01.03.2024	Përgjegjës i Sektorit Tatim-Taksa
2	F. D	Specialiste	Ekonomik	Lartë	21.02.2020	20.03.2024	Specialiste e tregut kontratave
3	H. S	Specialist	Ekonomik	Lartë	27.08.2015		Specialist
4	B. B	Specialist	Shkenca Sociale	Lartë	18.05.2022		Specialist i taksave për kadastrën, kontroll i subjekt në terren
5	K. B	Specialist	Ekonomik	Lartë	15.04.2020	01.03.2024	Specialist I menaxhimit te borxhit

6	R. V	Specialist	Analizë dhe Politik Sociale	Larte	01.01.2022	Specialist i menaxhit te taksave familjae
---	------	------------	-----------------------------	-------	------------	---

Burimi: DAV Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitin 2023, pranë Bashkisë Tropojë ka funksionuar Sektori i Tatim Taksave, struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Tropojë nga taksat dhe tarifat. Ky sektor në aktivitetin e saj për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave duhet të bashkëpunojë edhe me drejtori/sector të tjerë pranë bashkisë, si ai i pronave, urbanistikës, infrastrukturës, shërbimeve ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit/faturës për arkëtim/sipas rastit ndjekja e arkëtimin, si dhe roli i Sektorit të Tatim Taksave është kryesisht në hartimin dhe përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore, ndjekjen e arkëtimin/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

-Taksat dhe Tarifat e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Tropojë.

Për vitin 2023, paketa fiskale e Bashkisë Tropojë është miratuar me VKB nr. 102 datë 01.12.2022, me nr. 5204 prot., datë 06.12.2022, "Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2023", si dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me nr. 2/39 prot., datë 16.12.2022. Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme Bashkia Tropojë krijon të ardhura nga këto burime: Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore, taksa mbi truallin, taksa për tabelat dhe reklamat, taksa e biznesit privat taksa të tjera, tarifa për shërbime administrative, tarifa për zënien e hapësirës publike dhe të fasadave, tarifa të shërbimeve publike vendore (mbetje, gjelbërim etj.).

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023 sipas planit ka qenë 57,000 mijë lekë.

**Për vitin 2023**, ka pasur realizim të planit të përgjithshëm të ardhurave në masën 120% ose 68,424 mijë lekë si dhe tejkalim në masën 20% ose në vlerën 11,424 mijë lekë, të rakorduara me thesarin. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2023, referuar akt-rakordimve me degën e Thesarit Tropojë paraqitet në tabelën e mëposhtme.

-Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave sipas llojeve të taksave, tarifave dhe të ardhurave të tjera.

Tabela nr.13, Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave – viti 2023

000/lekë

Emërtimi			Viti 2023		
			Plan	Fakt	%
	A	<b>TE ARDHURAT NGA BURIMET E VETA/ GJITHSEJ</b>	<b>57,000</b>	<b>68,424</b>	<b>120.0</b>
<b>I</b>	<b>I</b>	<b>TE ARDHURAT NGA TAKSA VENDORE</b>	<b>35,080</b>	<b>34,989</b>	<b>99.7</b>
	I.0	Nga tatim mbi te ardhurat personale (2%)	6,000	7,903	131.7
1	I.1	Nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për BV	50	119	238.0
2	I.2	Nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	3,400	3,268	96.1
2.1	I.2.1	Nga taksa mbi ndërtesat	2,600	2,679	103.0
2.2.1	I.2.2.1	Ndërtesa banimi	400	193	48.3
2.2.2	I.2.2.2	Ndërtesa të tjera	2,200	2,486	113.0
2.2	<b>I.2.2</b>	Nga Taksa mbi tokën bujqësore	300	56	18.7
2.3	<b>I.2.3</b>	Nga taksa mbi truallin	500	533	106.6
3	<b>I.3</b>	Nga taksa e fjetjes ne hotel	1,000	1,552	155.2
4	<b>I.4</b>	Nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	12,000	8,626	71.9
5	<b>I.5</b>	Nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	50	-	0.0
6	<b>I.6</b>	Nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	11,000	12,142	110.4
7	<b>I.7</b>	Nga taksa e rentës minerare	50	-	0.0
8	<b>I.8</b>	Nga taksa e tabelës dhe reklames	1,480	1,379	93.2
9	<b>I.9</b>	Takse te tjera	50	-	0.0
<b>II</b>	<b>II</b>	<b>TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE</b>	<b>19,220</b>	<b>21,868</b>	<b>113.8</b>
<b>1</b>	<b>II.1</b>	Nga tarifa e shërbimeve publike (pastrim dhe largimit te mbetjeve, tarifa e ndricimit, gjelberimit dhe kanalizimeve	13,900	14,503	104.3
1.1	<b>II.1.1</b>	Nga familjet	1,800	1,285	71.4
1.2	<b>II.1.2</b>	Nga institucione	1,100	1,020	92.7
1.3	<b>II.1.3</b>	Nga biznesi	11,000	12,198	110.9
<b>4</b>	<b>II.4</b>	<b>Tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë Tropojë</b>	<b>2,800</b>	<b>3,254</b>	<b>116.2</b>
4.1	<b>II.4.1</b>	Nga vertetime, autorizime, dokumenta te tjera	150	160	106.7

4.2	II.4.2	Nga tarifa për vulosje veterinerë të bagëtive të therura	50	-	0.0
4.3	II.4.3	Nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit, autorizime	1,500	2,047	136.5
4.4	II.4.4	Nga Tarifat parkimi për mjetet e licënuara, dhe tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë:	500	710	142.0
4.5	II.4.5	Të ardhura nga tarifët në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	600	337	56.2
4.6	II.4.6	Nga tarifa për shërbimin në institucione të arsimit, kultures, sportit, shërbimit social etj	2,520	4,111	163.1
4.6.1	II.4.6.1	Pallati i Kultures	50	-	0.0
4.6.2	II.4.6.2	Pallati I Sportit	50	-	0.0
4.6.3	II.4.6.3	Kopshitet	950	1,086	114.3
4.6.4	II.4.6.4	Cerdhet	170	194	114.1
4.7	II.4.7	Të ardhura nga tarifa për zënien e hapësirave publike	300	283	94.3
4.9	II.4.9	Te ardhura te tjera	1,000	2,548	254.8
III	III	<b>Gobat</b>	<b>700</b>	<b>397</b>	<b>56.7</b>
IV	IV	<b>Të ardhura jo tatimore</b>	<b>2,000</b>	<b>11,170</b>	<b>558.5</b>
1	IV.1	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë	2,000	11,170	558.5
<b>TOTAL (I+II+III+IV)</b>			<b>57,000</b>	<b>68,424</b>	<b>120.0</b>

Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitin 2023 të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën **57,000 mijë lekë** dhe janë realizuar në vlerën **68,424 mijë lekë**, ose 120% rreth 11,424 mijë lekë më shumë nga plani.

Në krahasim me vitin 2022 kemi ulje të të ardhurave të arkëtuara me 894 mijë lekë më pak, ose 1.3% më pak.

Me tejkalim paraqiten zërat, si:

- 1- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin në masën 238%, kjo pasi nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë është planifikuar një vlerë simbolike prej 50 mijë lekë, ndërsa arkëtimet janë në shumën 119 mijë lekë, pra Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë nuk ka bërë planifikim të saktë, **duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2022 e cila është në shumën 203 mijë lekë;**
- 2- Taksa e fjetjes në hotel, paraqitet me realizim në masën 155%, ku nga vlera e planifikuar prej 1,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 1,552 mijë lekë. Nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë nuk është bërë planifikimi i saktë, nisur kjo dhe nga fakti i vitit të kaluar ku megjithëse fakti është në vlerën 1,081 mijë lekë planifikimi është bërë afërsisht sa një vit më parë;
- 3- Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë nga 2,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 11,170 mijë lekë ose 558 %.
- 4- Tarifa e shërbimit administrative të Bashkisë Tropojë nga 2,800 mijë lekë është arkëtuar vlera 3,254 mijë lekë ose 116 %.
- 5- Taksa e mjeteve të përdorura, paraqitet me realizim në masën 110%, ku nga vlera e planifikuar prej 11,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 12,142 mijë lekë.

Në tërësinë e taksave dhe tarifave të mësipërme që janë realizuar më pak, përmendim disa prej tyre, të cilat janë më të rëndësishmet, pasi përbëjnë burimin kryesor dhe të qëndrueshëm të të ardhurave të Bashkisë Tropojë, si përshëmbull:

-Taksën e ndikimit në infrastrukturë, realizuar në masën 72% (8,626 mijë lekë);

-Taksën e tokës bujqësore, realizuar në masën 19% (56 mijë lekë);

-Tarifën e pastrimit nga familjet, realizuar në masën 71% (1,285 mijë lekë). Ky rezultat tregon punë të pamjaftueshme të Bashkisë Tropojë në mbledhjen e tarifës së pastrimit për familjet në qytet dhe në NJA.

-Për vitin 2023 peshën kryesore të të ardhurave e zënë të ardhurat nga taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura me 12,142 mijë lekë, ose 18% ndaj totalit të të ardhurave të realizuara, duke vijuar me të ardhurat nga qiraja e aseteve në pronësi të bashkisë në vlerën 11,170 mijë lekë, ose 16% ndaj totalit, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 8,626 mijë lekë, ose 12.6% ndaj totalit, tarifa e pastrimit për biznesin në vlerën 12,198 mijë lekë, ose 18% etj.,



Nga analiza e trajtuar më sipër për sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimeve e cila kryesisht vjen për shkak të mos njohjes së situatës, moskryerjes së rregullt të procedurave apo përfshirja e arkëtimeve si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme gjë e cila ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore duke mos pasqyruar sakt burimin e të ardhurave.

Nga Sektori i Taksave nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave për arsye se nuk janë përfshirë, parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve nga vitet e mëparshme.

Gjithashtu në evidencat dhe raportimet mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga ky Sektor nuk është kryer një ndarje konkrete nga arkëtimet e realizuar nga taksat dhe tarifave vendore për secilin vit dhe detyrimeve të prapambetura të arkëtuara përgjatë vitit 2023 me qëllim pasqyrimin real të të ardhurave.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Tropojë që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet apo tejkalimet e mëparshme në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të kryhet mbi baza sa më reale për të mos shkaktuar defiqite në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve etj. në dëm të interesave të publikut. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjat “a” dhe “e” të nenit 5 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

Përsa i përket përdorimit të ardhurave, janë përdorur sipas planifikimit buxhetor, ndërsa pjesa e papërdorur është mbartur në buxhetin e vitit pasardhës.

#### -Evidentimi dhe mbajtja e regjistrit të tatimpaguesve

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për qytetin dhe çdo njësi administrative është krijuar në mënyrë elektronike regjistri për taksat dhe tarifave vendore për subjektet private dhe familjarët, njësitë administrative (Bajram Curri, Fierzë, Lekbibaj, Margegaj, Llugaj, Bujan, Bytyç, Tropojë si dhe për Bashkinë Tropojë, si më poshtë:

Për subjektet private në qytet dhe në Njësitë Administrative, administrohen nga Sektori i Tatim Taksave në format excel. Nuk ka një program të vecantë lidhur me mbajtjen e tyre.

Për bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë dhe në Njësitë Administrative funksionon sistemi i taksave sipas llojit (Biznes i madh dhe Biznes i vogël) ndërtesa me qira, ambulante).

Për familjarët në 8 Njësitë Administrative përdoret regjistri i kodifikuar i tatimpaguesve në format excel. Është marrë informacioni zyrtarisht nga gjendja civile për Bashkinë Tropojë dhe Njësitë Administrative, ku bazuar këtij regjistri janë parashikuar dhe tarifave e familjeve sipas paketës fiskale. Regjistri Elektronik për familjarët në qytet dhe në 7 Njësitë Administrative mbahet në formatin Excel (ndërtesë, truall, tokë bujqësore, etj), në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

#### **Detyrimet e palëve të treta ndaj Bashkisë Tropojë sipas kategorive të tyre.**

Në tabelën e mëposhtme është pasqyruar në mënyrë të përmbledhur ecuria e debitorëve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, si dhe trashëguar nga vitet e mëparshme.

Nr .	Pershkrimi	Gjendja e debitorve me 31.12.2022	Arktuar ne 12-mujorin 2023	Shtuar ne vitin 2023	Gjendja e debitorve me 31.12.2023
		Vlere	Vlere		Vlere
1	Debitor taksa/tarifa vendore te periudhes 2012-2019	10,686,101	330,322		10,355,779
2	Kamat vonesa per debitorët 2012-2019 llogarit ne v. 2021	2,351,899	19,573		2,332,326
3	Debitor taksa/tarifa vendore te vitit 2020	3,025,271	261,470		2,763,801
4	Debitor taksa/tarifa vendore te vitit 2021	4,402,182	710,323		3,691,859
5	Debitor taksa/tarifa vendore te vitit 2022	5,275,474	1,364,838		3,910,636

6	Debitor taksa/tarifa vendore te vitit 2023			4,990,925	4,990,925
7	Debitor tarif sherbime Operator Ekonomik 2023			769,000	769,000
8	Debitore Institucione per taksa/tarifa te vitit 2019-2021	468,960			468,960
9	Debitore Institucione per taksa/tarifa te vitit 2023			256,480	256,480
10	Debitor takse infrastrukture te vitit 2018	773,644			773,644
11	Debitor tarif sherbime subjekte zbuluar KLSH 2021	204,000			204,000
12	Debitor tarif licensimi 5 vjecar karburantet, zbuluar KLSH 2021	2,600,000			2,600,000
13	Debitor tarif licensimi 5 vjecar karburantet, zbuluar KLSH 2022	2,000,000	2,000,000		0
	<b>Totali:</b>	<b>31,787,531</b>	<b>4,686,526</b>	<b>6,016,405</b>	<b>33,117,410</b>

*Burimi: Sektori i taksave dhe tarifave Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Nga tabela e mësipërme rezulton se:

-Vlera e detyrimeve në fund të vitit 2023 është **33,117,410 lekë** për taksat dhe tarifave vendore, qiratë, gjobat, kamatëvonesa etj. nga të cilat detyrime janë 30,785,084 lekë dhe kamat-vonesa janë 2,332,326 lekë. Në krahasim me fundin e vitit 2022, në fund të vitit 2023 kemi rritje të vlerës debitore me 1,329,879 lekë ose 4% e totalit.

Situata e mësipërme tregon për një punë të pamjaftueshme të Bashkisë Tropojë në arkëtimin e të drejtave të saj ndaj palëve të treta.

#### Masat shtrënguese për arkëtimin e borxhit

**Për vitin 2023** ka ecuri lidhur me masat shtrënguese por gjithsesi në nivele të ulëta vendosje apo ekzekutimi. Masat shtrënguese nuk janë ezauruar të plota sipas përcaktimeve ligjore. Nuk është kryer një analizë e detajuar për secilin nga këta debitor tatimpagues për nxjerrë shkaku e mos mbledhjeve të detyrimeve. Analiza dhe planet operacionale janë një hap i cili duhet dhe duhet të jetë në të ardhmen në fokus si indikator orientues për vijimin e marrjes së masave me qëllim arkëtimin e detyrimeve për secilin debitor, biznes i madh i vogël apo cdo lloj debitori. Trendi i rritjes së detyrimeve të pa paguara mbetet akoma i lartë dhe për pasojë ka sjellë të ardhura të munguara, të cilat kanë ndikuar negativisht në buxhetin e Bashkisë Tropojë, të ardhura këto që mund të përdoren nga Bashkia për investime në infrastrukturë dhe rritjen e përmirësimit të shërbimeve e në tërësi përmirësimin e kushteve të qytetarëve të kësaj bashkie.

**Konkluzion:** Nga auditimi i dokumentacionit dhe praktikave të ndjekura për mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e arkëtimin e borxhit u konstatua se administrimi i procesit për mbledhjen e detyrimeve tatimore ka mangësi në lidhje me ndjekjen e veprimeve proceduriale nga ana e Sektorit të Tatim Taksave, duke mos ezauruar në kohë dhe me efikasitet të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në ligjislacionin tatimor për të siguruar mbledhjen e këtyre detyrimeve.

Në lidhje me këtë situatë struktura e Tatim Taksave të Bashkisë Tropojë për asnjë nga subjektet si biznes i vogël dhe i madh, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, janë njoftuar për pagesën e detyrimeve, janë mjaftuar vetëm më dërgimin e njoftim detyrimeve për subjektet debitorë si dhe urdhër bllokimet e llogarive të bankave të nivelit të dytë për 93 subjekte debitore. Nuk kanë vazhduar më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) apo për vendosjen e barrës së pasurisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Gjithashtu nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese për debitorët si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve si dhe deri në kallëzim penal sipas kërkesave të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat

*tatimore në R.SH*” ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar” nenet 89-91.

### **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj. në Bashkinë Tropojë kryhet në programin Excel. Sektori i Taksave nuk kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Tropojë i administrojnë në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Taksave.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Sektorit të Taksave për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të Sektorit të Taksave.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2023, paraqiten si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të periudhës 2023
1	Biznes i vogel	2023	280	51	42	289
2	Biznes i madh	2023	103	12	9	106
<b>TOTAL</b>			<b>383</b>	<b>63</b>	<b>51</b>	<b>395</b>

*Burimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

### III.1. Kategoria “Biznes” dhe Institucione.

Debitorët “Biznes” të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Sektori i Taksave, rezultojnë se deri në 31.12.2022 kanë qenë debitor 233 subjekte të kategorisë “Biznes”, në vlerën **25,740,927 lekë** dhe 2 institucione në vlerën 468,960 lekë.

Për vitin 2023 janë krijuar 128 subjekte debitore në vlerën 4,990,925 lekë dhe 2 institucione në vlerën 256,480 lekë.

-Në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive rezultojnë debitor 268 subjekte të kategorisë “Biznes” në vlerën **28,045,326 lekë** dhe 4 institucione në vlerën **725,440 lekë**, pra total vlera debitore është **28,045,326 lekë**, të cilat përbëjnë të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-Në fund të vitit 2023 në krahasim me fillimin e vitit 2023, numri dhe vlera e subjekteve debitor të kategorisë “Biznes” dhe institucione ka ardhur në rritje.

-Për debitorët e mësipërm (theksojmë vetëm për kategorinë biznes) nga sektori i tatim taksave Bashkia Tropojë, sipas dokumentacionit të administruar dhe vendosur në dispozicion, nuk janë bërë përpjekje duke aplikuar masa shtrënguese për të gjithë subjektet (deri në vendosjen e barrës siguroese për pasuritë e luajtshme, si mjete transporti), nuk është vazhduar me masa

shtrënguese në mënyrë shteruese, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, bllokim i shitjes së aktiveve në QKB, konfiskimi i jo më pak se 50% të qarkullimit deri në kallëzim penal.

**Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.**

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë në lidhje me realizimin e të ardhurave të bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga Drejtoria Vendore e ASHK Kukës, u auditua dokumentacioni për periudhën e vitit 2023, i paraqitur nga Sektori i Urbanistikës Bashkia Tropojë. Nga DVASHK Kukës, janë dërguar dokumentet për çdo person që është pajisur me leje legalizimi për ndërtimet informale, me qëllim përlllogaritjen e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI).

Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Sektori i Urbanistikës nuk është zbatuar pika 5 në paketën fiskale të Bashkisë Tropojë për vitin 2023, pasi për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nga subjektet e pajisur me leje legalizimi përgjatë vitit 2023, nuk janë marrë masa për njoftimin e tyre me qëllim kryerjen e pagesës përkatëse. Veç sa më sipër ku nuk janë marrë masa në mënyrë shteruese për arkëtimin e TNI, konstatohet edhe për sa i përket arkëtimin të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë për debitorët e rezultuar deri në datë 31.12.2023, për të cilët administrohet vetëm njoftimi për arkëtim. Gjithashtu ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Sektorit të Urbanistikës dhe Sektorit të Taksave Bashkia Tropojë, me qëllim që subjektet të cilët rezultojnë debitorë si rrjedhojë e mospagesës së TNI, të ndjekin procedurat ligjore (njoftim, bllokim të llogarive bankare, etj) për arkëtimin e TNI nga legalizimi i objekteve informale.

Në vijim paraqitet në mënyrë të përmbledhur pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, si dhe vlera debitorë progresive dhe e ndarë sipas viteve.

Tabela analitike për TNI për legalizimin e objekteve informale deri me 31.12.2023

Nr	Adresa	Emri, Mbiemri, Atesia	Nr. i Lejes	Data lejes	Siperf. Ndërtimi ne m <sup>2</sup>	Kosto mesata /Sip. Ndërtimi lekë/m <sup>2</sup> Sipas EKB	Vlera e gjetur ne leke	Detyrimi gjendje 31.12.2022	Arktime gjate vitit 2023	Detyrimi gjendje 31.12.2023
1	Koçanaj	A I D	55370	17.01.2017	166.32	32899	5,471,762	27,359		27,359
2	B.Curri	M R H	55833	19.04.2017	140.5	32899	4,622,310	23,112		23,112
3	B.Curri	B. R P. A H. H	56256	30.06.2017	19.74	32899	649,426	3,247		3,247
4	Rrogam	Ç. J A. A Ç. A	56276	28.07.2017	379.86	32899	12,497,014	62,485		62,485
5	Jaho Salih, Nj.A. Llugaj	F. S. B	55307	08.11.2017	274.83	32899	9,041,632	45,208		45,208
6	Sopot - Tropoje	D. S. Q	56410	29.12.2017	369.76	32899	12,164,734	60,824		60,824
7	Lagje "28 Gushti" B.Curri	U. S. I	56413	29.12.2017	228.72	32899	7,524,659	37,623		37,623
8	Fierze Tropoje	R. F. Sh	56426	15.01.2018	239.61	32899	7,882,929	39,415		39,415
9	Margegaj Tropoje	H. R. A	56429	15.01.2018	290.92	32899	9,570,977	47,855		47,855
10	Sopot - Tropoje	H. Z. M. E. H. M	56432	15.01.2018	284.69	32899	9,366,016	46,830		46,830
11	Sopot - Tropoje	I. S. B	56317	13.02.2018	670.39	32899	22,055,161	55,138		55,138
12	Bujan Tropoje	Sh. T B	38962	18.02.2018	180	32899	5,921,820	29,609		29,609
13	Bajram Curri	H I. M+2 banor	90298	28.03.2018	59.76	32899	1,966,044	9,830		9,830
14	Nimaj B. Curri	A. A. H	90265	24.05.2018	116.13	32899	3,820,561	19,103		19,103
15	Nimaj B. Curri	S. A. H	90266	24.05.2018	25.8	32899	849,781	4,249		4,249
16	Bujan Tropoje	A. B. M	94733	24.05.2018	743.71	32899	24,467,315	122,337		122,337
17	Bajram Curri	N. Sh. A	37327	25.07.2018	29.55	32899	972,165	4,861		4,861
18	Bajram Curri	D.N. K	90297	25.07.2018	303.42	32899	9,982,215	49,911		49,911
19	Bajram Curri	I. R. B	90259	25.07.2018	254.86	32899	8,384,639	41,923		41,923
20	Bajram Curri	P. I. S	57573	26.07.2018	14	32899	460,586	2,303		2,303
21	Viçidol Tropoje	I A. S	57588	30.08.2018	245.7	32899	8,084,600	40,423		40,423
	<b>TOTALI</b>							<b>773,644</b>	<b>-</b>	<b>773,644</b>

*Burimi: Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Bazuar në të dhënat e marra u konstatua se, nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi konkretisht:

Vlera debitore progresive për periudhën deri në fund të vitit 2023 (nga viti 2017) – vlera debitore është **773,644 lekë**, e cila përfaqëson të ardhura të pa arkëtuara për buxhetin e Bashkisë Tropojë. Në numër personash të cilët posedojnë lejen e legalizimit dhe që nuk kanë shlyer detyrimin e taksës vendore të ndikimit në infrastrukturë është 21 posedues.

Për arkëtimin e vlerës debitore krijuar si rrjedhojë e mos likuidimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale, nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, si dhe ka munguar bashkëpunimi ndërmjet Sektorit të Urbanistikës dhe Sektorit të Taksave Bashkia Tropojë, për shkëmbimin e informacionit si dhe ndjekjen e procedurave ligjore, për arkëtimin e TNI.

### **Agjentët tatimorë**

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj, janë regjistruar në evidencat përkatëse, pavarësisht se nuk janë protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Të ardhurat nga ASHK derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Tropojë brenda datës 5 të çdo muaji. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Tropojë janë paraqitur si më poshtë.

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Tropojë, për vitin 2023

000/lekë

<b>Agjenti Tatimor</b>	<b>Lloji i Taksës</b>	<b>2023</b>
Drejtoria Rajonale e Tatimeve	Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin	119
D.R.SH.T Rrugor	Taksa Vjetore e Mjeteve të Përdorura	12,142
Z.V.R.P.P (ASHK)	Taksa e Kalimit të Pronësisë	0
DPT & DPD	Renta Minerare	0
Ujësjiellës-Kanalizime	Taksë Ndërtese	0
	Tarifë Shërbimi	0
<b>TOTALI</b>		<b>12,261</b>

*Burimi: Sektori i Tatim Taksave*

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë realizimi.

Bashkia Tropojë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm.

### **Mbi tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Tropojë.**

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Tropojë mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Ligj Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017;

-VKM nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”

-VKB për miratimin e paketës fiskale;

-Dosjet e licencimit të subjekteve, me përmbajtje: Licenca e dhënë për ushtrim aktiviteti, Ekstrakti i regjistrimit në QKB (në të cilin pasqyrohet lloji aktivitetit dhe vendet e ushtrimit

të aktivitetit nga subjekti në Bashkinë Tropojë dhe NJA, që korrespondon me periudhën 01.01.2023-31.12.2023), Akti teknik i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial; Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti, Raporti teknik i lëshuar nga shërbimi i zjarrëfikses, Projekti teknik i vendit ku do të ushtrohet aktiviteti, vendosja e depozitave, Autorizimet për pagesë, Faturat e arkëtimit dhe pagesa e kryer nga subjekti;

-Paketa Fiskale e vitit 2023 dhe Rregullore e brendshme e Bashkisë Tropojë.

-Referuar të dhënave nga databasat e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, (institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve).

Nga Sektori i Tatim Taksave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Tropojë dhe në Njësitë Administrative, na u vendosën në dispozicion 10 dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Subjektet për të cilat administrohet dosje fizike dhe që kanë ushtruar aktivitet në vitin 2023 në Bashkinë Tropojë, tarifimi, pagesat dhe detyrimi

Nr	Subjekti	Adresa	Nipti	Pajisur me Licenc		Licenc		Tarifa aplikuar nga Bashkia	Pagesa e kryer	Sistemim (Paksime) Urdhri nr. 202, dt.12.5.2023	Detyrimi I mbetur 31.12.2023
				Po	Jo	Fillon	Mbaron				
1	G. C GKG	Lagje Dardania B.Curri	K6.....1T	×		16.03.2022	15.03.2025	600,000	600,000		
2	P sh.p.k	Fshati Vicidol, Rr. e Qafe-Morines	L2.....1K	×		21.09.2020	20.09.2021	1,000,000	200,000		800,000
3	A. A sh.p.k	Qyteti Bajram Curri	K9.....2K	×		28.10.2018	27.10.2023	1,000,000	1,000,000		
4	K sh.p.k	Lagje Dardania B.Curri	J6.....9P	×		02.02.2022	01.02.2027	1,000,000	1,000,000		
5	H 1 sh.p.k	Lagje Dardania B.Curri	K1.....3F	×		09.08.2019	08.08.2024	1,000,000	100,000		900,000
6	SH sh.p.k	Lagje Fierzë,Dushaj	L5.....1F	×		19.09.2023	18.09.2028	1,000,000	1,000,000		
7	S sh.p.k	Lagje Dardania B.Curri	J8.....0J	×		19.03.2022	18.03.2023	200,000	200,000		
8	S sh.p.k	Fshati Sopot	J8.....0J	×		16.05.2021	15.05.2026	1,000,000	278,904	721,096	
9	E. O sh.p.k	Lagje Dardania B.Curri	L3.....1C	×		11.01.2019	10.01.2024	1,000,000	100,000		900,000
10	D-O sh.p.k	Lagje Dardania B.Curri	L5.....0G	×		12.03.2021	11.03.2026	1,000,000	400,000	600,000	
<b>Totali:</b>								<b>8,800,000</b>	<b>4,878,904</b>	<b>1,321,096</b>	<b>2,600,000</b>

*Burimi: Sektori i Tatim Taksave, Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

Nga shqyrtimi i dosjeve të mësipërme, konstatohet se:

-Në 1 rast, për licenca të dhëna deri në 31.12.2023, licenca është dhënë me afat vlefshmërie nga 1-3 vite, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 2 në nenin 20 të ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, me VKM nr. 346 datë 19.04.2017, i ndryshuar, ku është përcaktuar se afati i vlefshmërisë së licencës është 5 vite nga momenti i lëshimit, për të cilin aplikohet edhe tarifa prej 1,000,000 lekë.

-3 subjekte të cilët kanë ushtruar aktivitet për tregtimin e karburanteve përgjatë periudhës objekt auditimi, nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit, konkretisht:

Nr	Emri	Adresa	NIPT
1	P sh.p.k	Fshati Vicidol, Rr. e Qafe-Morines	L2.....1K
2	A A sh.p.k	Qyteti Bajram Curri	K9.....2K
3	S sh.p.k	Lagje Dardania B.Curri	L3.....1C

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, sa i përket masave të marra për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit, rezulton se Drejtoria e Turizmit e Shërbimeve Publike dhe Transportit, pranë Bashkisë Tropojë, përgjatë vitit 2023 nuk i është drejtuar me shkresë

subjekteve për pajisjen me licencën për ushtrimin e aktivitetit. Gjithashtu gjatë vitit 2023, nuk ka patur korrespondencë shkresore ndërmjet Drejtorisë së Turizmit e Shërbimeve Publike dhe Sektorit të Tatim Taksave, Policisë Bashkiake, për penalizimin e subjekteve që nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në tregtimin e karburanteve.

- Pra sa më sipër konstatohet se gjatë vitit 2023, nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 15.1 dhe 15.2 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017.

- Në mënyrë të përmbledhur si rrjedhojë e mosmarrjes e masave shtrënguese deri në kallëzimin penal (në vitin 2023) në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit, konstatohet se 3 subjekte për 3 stacione shitje të karburantit nuk kanë kryer pagesën e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të pa arkëtuara në buxhetin e Bashkisë Tropojë në fund të periudhës 31.12.2023 vlera debitore është 2,600,000 lekë, të cilat janë të kontabilizuara. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 2 të nenit 4 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar.

Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 “...nuk i paguan ato në buxhet” të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017.

- Sa më sipër mban përgjegjësi z. K.S, Përgjegjës i sektorit të Tatim Taksave dhe znj. F. D specialiste e Tatim Taksave.

### III.2.Familjet.

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Tropojë dhe NJA, për vitin 2023 janë taksuar 1.421 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “familjar”. Të dhënat për numrin e familjeve që taksohen për çdo NJA, pasqyrohen si më poshtë:

NJA	Familje të taksuara	Familje sipas Gj.Civile
Bajram Curri	426	2727
Bujan	201	928
Margegaj	149	1083
Tropoje	326	1872
Llugaj	177	782
Fierze	74	825
Lekbibaj	68	558
Bytyc		675
<b>Total</b>	<b>1421</b>	<b>9450</b>

*Burimi: Sektori i tatim taksave Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

-Me qëllim vlerësimin nëse nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë me informacionin e administruar nga Gjendja Civile.

-Sipas gjendjes civile në Bashkinë Tropojë dhe NJA janë 9450 familje, pra ndërkohë në vitin 2023 janë taksuar/tarifuar 1421 familje.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Tropojë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përlllogaritjet vetëm për tarifën e Shërbimit (pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit) për qytetin Tropojë për numrin e familjeve të pataksuara,

do të kishim mesatarisht 1,875 lekë \* 2301 familje taksuar më pak = **4,314,375 lekë** planifikuar më pak, dhe në Njësitë Administrative për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 937,5 lekë \* 5728 familje taksuar më pak = **5,370,000 lekë** planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018<sup>6</sup>, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”. Në këtë drejtim kërkohet më tepër përkushtim nga Bashkia Tropojë duke ngritur grup pune, për evidentimin e saktë dhe të plotë të familjeve që jetojnë në Bashkinë Tropojë dhe NJA.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezulton se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Tropojë dhe Njësitë Administrative, taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Bashkia Tropojë nuk ka një akt marrëveshje me Ujësjiellës Sh.A. Tropojë, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të rolit të agentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore të përfshira në faturën e ujit të pijshëm.

Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Kapitulli II Pika II.1 Tabela 11 në Paketën Fiskale të Bashkisë Tropojë.

### **Taksa e tokës bujqësore**

Nga të dhënat e pasqyrës, kjo taksë është realizuar në masën 18.7% ose nga vlera e planifikuar prej 500 mijë lekë është arkëtuar vlera 56 mijë lekë.

Sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Sektori i Taksave, Bashkia Tropojë rezulton se numri i familjeve të trajtuara me tokë është 69 fermerë me një sipërfaqe të përgjithshme prej 4789 Ha, sipërfaqe e ndarë me AMTP. Kjo sipërfaqe duhet të shërbejë për Bashkinë Tropojë për planifikimin e taksës së tokës bujqësore. Ndarja e tokës bujqësore me AMTP, sipas Njësitë Administrative të Bashkisë Tropojë, pasqyrohet si me poshtë:

Njesite Administrative	Nr. i fshatrave për çdo njësi	Sipërfaqja e tokës së ndarë në (Ha)	Nr. i familjevetë trajtuara me tokë sipas ligjit 7501
Bajram Curri	1	125.0	61
Bujan	9	765.6	1162
Margegaj	10	487.3	1502
Tropoje	15	1257.0	2159
Llugaj	6	703.5	942
Fierze	4	372.0	654
Lekbibaj	12	359.5	1199
Bytyc	12	719.0	823
<b>SHUMA</b>	<b>69</b>	<b>4789</b>	<b>8902</b>

*Burimi: Sektori i tatim taksave Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së*

-Planifikimi i taksës së tokës është bërë në bazë të dhënash për bazën e taksueshme të sipërfaqes së tokave bujqësore në disponim të familjeve fermere, informacion i cili i dërgohet nga NJA Sektorit të Taksave në fazën e përgatitjes së buxhetit. Këto të dhëna nuk janë të sakta, edhe për faktin se ka mosrakordim të dhënash në mes të dhënave të NJA dhe të dhënave që disponon Sektori i Tatim Taksave. Planifikimi i të ardhurave sipas Bashkisë Tropojë për vitin 2023 i taksës së tokës bujqësore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

### **Planifikimi i taksës së tokës bujqësore në Bashkinë Tropojë**

<sup>6</sup> Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.



Kategoria e tokës	Sip/HA Qendër	Sip/HA Nj.A. Bujan	Sip/HA Nj.A. Margegaj	Sip/HA Nj.A. Tropoje	Sip/HA Nj.A. Llugaj	Sip/HA Nj.A. Fierze	Sip/HA Nj.A. Lekbibaj	Sip/HA Nj.A. Bytyc	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria II										
Kategoria III										
Kategoria IV		266.0			570			406		
Kategoria V	138.5		402.0	1265	661	534.0	85	161		
Kategoria VI		541.6	219.5	477		114.5	235	412		
Kategoria VII		284.0	68.0	156			245			
Kategoria VIII						74.0	71			
<b>e. Totali sip. ha sipas planifikimit</b>	<b>138.5</b>	<b>1091.6</b>	<b>689.5</b>	<b>1898</b>	<b>1231</b>	<b>722.5</b>	<b>636</b>	<b>979</b>		
<b>Sipas korrespondencës zyrtare drejtuar Këshillit Qarkut Tropojë me shkresën nr.</b>										
1. Fondi gjithsej i tokës	138.5	1091.6	689.5	1898	1231	722.5	636	979		
a. Toke në pronësi shtetërore										
b. Toke pronësi private	125	765.6	487.3	1257	703.5	372	339.5	719		
c. Tokë e ish-ndërmarrjeve bujqësore dhënë në përdorim familjeve bujqësore					Ish NB Cernice. 280					

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në lidhje me planifikimin dhe realizimin e taksës së tokës rezulton se: Nga Njësitë Administrative disponohen regjistrat e tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe cilësisë së tokave (kategorizimi), si dhe marrëdhëniet juridike më të, pra statusi i pronësisë për të gjitha familjet fermere. Mbi bazën e këtyre regjistrave të hartuar në vitet e mëparshme nga të dhënat e marra nga sektori i Bujqësisë nga specialistët e taksave ngarkoheshin familjet fermerë me taksën e tokës sipas kategorisë dhe nivelin e taksës përkatëse të përcaktuar në paketën fiskale. Në Njësitë Administrative Bajram Curri, Bujan, Markgegaj, Tropojë Llugaj, Fierzë Lekbibaj dhe Bytyç, vjelja e detyrimeve për taksën e tokës bëhet atëherë kurë subjekti/individ i paraqitet pranë njësisë/ve për marrjen e shërbimit dhe kryen pagesën përkatëse. Duhet theksuar se nuk kishte një përditësim të këtyre regjistrave në 10 vitet e fundit, gjë që është e domosdoshme për të patur të dhëna të sakta për bazën e taksueshme. Situata e mësipërme tregon gjithashtu se regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi.

Për vitin 2023 taksa e **fjetjes në hotel** paraqitet me realizim në vlerën 1,552 lekë, ose 155.2% e planifikimit. Nga Sektori i Tatim Taksave nuk është bërë planifikimi dhe realizimi i saktë i taksës së fjetjes në hotele.

Nga auditimi u konstatua se, aplikimi i tarifës është llogaritur në bazë të strukturave dhe kapaciteteve akomoduese në territorin e Bashkisë Tropojë, strukturat akomoduese taksohen në bazë vjetore, veprime të cilat janë në kundërshtim me Kreun I.3, tabela 6 në paketën fiskale të vitit 2023.

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të kësaj takse rezulton se Sektori i Tatim Taksave ka të regjistruar 36 hotele dhe njësi akomoduese, si dhe për vitin 2023 janë arkëtuar 1,546,065 lekë dhe në fund të periudhës progresive deri në 31.12.2023 vlera debitore është **360,320 lekë**, të cilat janë të pa kontabilizuara dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Përgjatë vitit 2024 janë kryer likujdime për taksën e fjetjes në hotele në vlerën 179,865 lekë nga detyrimi i mbetur deri në 31.12.2023, pasqyruar në Kapitullin Anekse, tabela nr.6; Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun I.3, tabela nr.6 në Paketën Fiskale të Bashkisë Tropojë për vitin 2023.

-Për situatën e mësipërme (hotelet për të cilat administrohet informacion dhe kanë rezultuar me problematikë në arkëtimin e tyre si dhe hotele për të cilat nuk administrohet informacion), mbajnë përgjegjësi z. K. S, Përgjegjës i Tatim Taksave, z. K. B, specialist i menaxhimit të borxhit, z. B. B, specialist i ngarkuar për të kryer verifikime dhe inspektime në terren për bizneset që ushtrojnë aktivitetet në Bashkinë Tropojë dhe NJA.

### **Debitor nga gjoba të vendosura nga Inspektorati i Mjedisit dhe Kontrollit të Territorit.**

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive nga gjobat e vendosura nga Inspektorati i Mjedisit dhe Kontrollit të Territorit, të

cilat janë në formë të prerë dhe që nuk pengohet ekzekutimi i tyre, janë gjithsej 7 subjekte të gjobitura për vlerën 1,600,000 lekë, të cilat janë të pa kontabilizuara dhe përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Tropojë, nga të cilat 1 gjobë në vlerën 100,000 lekë është deri në 31.12.2022 dhe 6 subjekte të gjobitura për vlerën 1,500,000 lekë janë krijuar përgjatë vitit 2023. Pasqyruar në tabelën përmbledhëse si më poshtë dhe në kapitullin Anekse, analitike.

Tabela nr.21, Gjobat e Inspektorati i Mjedisit dhe Kontrollit të Territorit Bashkia Tropojë

Debitor IMTV deri në 31.12.2023	Subjekte	Principal	Paguar	Kamatvonesë	Gjithsej
Nga të cilat deri 31.12.2022	1	100,000			100,000
Nga të cilat krijuar në 2023	6	1,500,000			1,500,000
<b>Nga të cilat progresive deri në 31.12.2023</b>	<b>7</b>	<b>1,600,000</b>			<b>1,600,000</b>

Burimi: Inspektorati i Mjedisit dhe Kontrollit të Territorit Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konstatohet se gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nga Kryeinspektori i Inspektoratit Mjedisit dhe Kontrollit të Territorit nuk është nxjerrë Urdhri e Ekzekutimit për të gjithë gjobat e vendosura, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSH”, neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSH”, neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

-Sa më sipër mbajnë përgjegjësi znj. N. R, Kryeinspektor për mjedisin dhe kontrollin e territorit Bashkia Tropojë dhe z. A. N, inspektor për mjedisin dhe kontrollin e territorit.

### **Debitor nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake.**

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton në fund të vitit 2023 në mënyrë progresive nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake Tropojë, është në vlerën 20,000 lekë, nga të cilat në vitin 2023 është 1 gjobë në vlerën 1,000 lekë e cila është likuaduar.

#### Gjobat e Policisë Bashkiake Tropojë

Debitor deri në 2023	Subjekte	Vlerë
<b>Gjithësej</b>	<b>2</b>	<b>20,000</b>
Nga të cilat në 2023		0
Nga të cilat deri në 2022	2	20,000

Burimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2023 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të paarkëtuara për buxhetin e Bashkisë Tropojë në vlerën 20,000 lekë, nga të cilat në vitin 2023 është vendosur 1 gjobë në vlerën 1,000 lekë e cila është likuaduar;

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse<sup>7</sup>. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar.

Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

-Për sa më sipër mbanë përgjegjësi, z. A. M, Kryeinspektor i Policisë Bashkiake.

<sup>7</sup> Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, “Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmuor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative"; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

**Për realizimin e të ardhurave nga tarifatat vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Tropojë.**

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Tropojë, mbi arkëtimin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në Bashkinë Tropojë, si dhe për subjekte të cilat kanë kryer punime ndërtimi si rrjedhojë e lejeve të ndërtimit të dhëna për subjekte të ndryshme, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

- Paketa fiskale e vitit 2023;
- Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2023 - 31.12.2023;
- Leje ndërtimi, njoftim i fillimit të punimeve dhe certifikatë përdorimi;
- Faturimi i detyrimit dhe pagesa, sipas regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2023.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***

**1. Përshkrimi i situatës.**

Bashkia Tropojë në paketën fiskale të vitit 2023, ka përcaktuar tarifën e përkohshme të kantierit të ndërtimit sipas investimit dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit, duke bërë dy kategorizime, si më poshtë vijon:

- a. Për kohëzgjatjen deri në 4 muaj tarifa është 68,000 lekë.
- b. Për kohëzgjatjen mbi 4 muaj tarifa është 75,000 lekë.

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura, u auditua dokumentacioni për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Tropojë) ku rezultoi se përgjatë vitit 2023 (përfshirë edhe subjekte të cilat kanë nisur punimet në vitin 2022, por kanë përfunduar në vitin 2023) kanë kryer punime ndërtimi gjithsej 14 subjekte, të cilët janë taksuar për tarifën e kantierit (pastrimi, ndriçimit dhe shërbimit), pasqyruar si më poshtë vijon:

**Subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Tropojë**

Nr	Subjekti	NIPT	Kontratat			Niveli i Tarifës		Detyrimi gjendje 31.12.2022	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2023;	Detyrimi i mbetur 31.12.2023
			Nr	Data	Afati ne muaj	Nën 4/muaj	Mbi 4/muaj			
1	H-1 sh.p.k	K1.....3F	4	26.03.2019	2	68,000		68,000		68,000
2	H-1 sh.p.k	K1.....3F	12	27.06.2019	3	68,000		68,000		68,000
3	H-1 sh.p.k	K1.....3F	11	19.06.2019	1	68,000		68,000		68,000
4	Z sh.p.k	J8.....1K	1	24.2.2023	6		75,000		75,000	75,000
5	HTSH sh.p.k	L9.....1A	4	26.4.2023	3	68,000			68,000	68,000
6	HTSH sh.p.k	L9.....1A	17	6.12.2022	2	68,000			68,000	68,000
7	HTSH sh.p.k	L9.....1A	14	8.8.2023	1	68,000			68,000	68,000
8	V sh.p.k	J7.....1O	7	26.5.2022	2	68,000			68,000	68,000
9	V sh.p.k	J7.....1O	9	17.5.2022	3	68,000			68,000	68,000
10	V sh.p.k	J7.....1O	9	4.5.2023	9		75,000		75,000	75,000
11	V sh.p.k	J7.....1O	6	26.4.2023	1	68,000			68,000	68,000
12	V sh.p.k	J7.....1O	5	26.4.2023	40 dit	68,000			68,000	68,000
13	I.D.K-K sh.p.k	K5.....6J	14	18.8.2022	1	68,000			68,000	68,000
14	N sh.p.k	J7.....7U	13	4.5.2023	12		75,000		75,000	75,000
<b>T o t a l i</b>						<b>748,000</b>	<b>225,000</b>	<b>204,000</b>	<b>769,000</b>	<b>973,000</b>

*Burimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Sektori i Prokurimeve, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së.*

***-Arkëtimi i tarifës së shërbimit dhe pastrimit.***

-Në auditimin e kryer për ndjekjen e procedurave në krijimin e të ardhurave nga tarifatat vendore për pastrimin dhe shërbimin ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi, u konstatua se nga Sektori i Tatim Taksave, Bashkia Tropojë, nuk është arkëtuar tarifa e kantierit (pastrimit, ndriçimit dhe shërbimit), për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë. Nga përlllogaritjet e kryera rezultoi se deri në 31.12.2023 në 14 raste, subjektet e ndërtimit janë debitorë në vlerën **973,000 lekë** gjithsej, nga të cilat përgjatë vitit

2023 janë krijuar debitorë 11 subjekte në vlerën 769,000 lekë, vlerë e cila është e kontabilizuar dhe përfaqëson të ardhura të pa arkëtuara në buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-Situata e mësipërme është krijuar si rrjedhojë e mosraportimit pranë Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, të lejeve të ndërtimit të dhëna për subjektet e mësipërme, por edhe nga puna e pamjaftueshme Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë në verifikimin në terren të subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Tropojë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Kapitulli II.1, tabela 13, pika 2 “Subjekte ndërtimi sipas investimit dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit” në Paketën Fiskale të Bashkisë Tropojë.

-VKB nr.102, datë 01.12.2022 për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023, Kapitulli II.1, tabela 13, pika 2:

### **Konkluzion:**

Nga auditimi konstatohet se deri në datën 31.12.2023 gjendja e debitorëve progresive për taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën **39,865,952 lekë**, e cila përbëhet nga:

- vlera prej 28,045,326 lekë për 268 subjekte debitorë të kategorisë biznes dhe vlera prej 725,440 lekë për 4 institucione, pra në total **28,770,766 lekë të cilat janë të kontabilizuara**.

- vlera prej **2,600,000 lekë** për 3 subjekte debitorë që ushtrojnë aktivitetet në fushën e hidrokarbureve.

- vlera prej **773,644 lekë** për 21 subjekte debitor nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.

- vlera prej **973,000 lekë** nga tarifa e kantierit për 14 subjekte që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Tropojë, të cilat janë të kontabilizuara.

- vlera prej **360,320 lekë** nga taksa e fjetjes në hotele për 13 subjekte, të cilat janë të pa kontabilizuara.

- vlera prej **1,600,000 lekë** për 7 subjekte nga gjobat e vendosura nga IMTV, të cilat janë të pa kontabilizuara.

- vlera prej **20,000 lekë** për 2 subjekte nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake, të cilat janë të pa kontabilizuara.

- vlera prej **11,021,770 lekë** nga kontratat e qirave për 14 subjekte, të cilat janë të pa kontabilizuara.

Për vitin 2023 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara nga taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën **5,402,890 lekë ose 13.5 %** e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga: -detyrimi prej **304,399 lekë** nga 127 subjekte debitor të kategorisë biznes dhe **256,480 lekë** për 2 institucione, -detyrimi prej **769,000 lekë** nga tarifa e kantierit për 11 subjekte të cilat kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Tropojë. -detyrimi prej **2,573,011 lekë** nga kontratat e qirasë për 12 subjekte. -detyrimi prej **1,500,000 lekë** nga gjobat e IMTV.

### **Përdorimi i të ardhurave.**

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2023 është realizuar përkatësisht në vlerën 62,299 mijë lekë, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime.

#### Përdorimi i të ardhurave – viti 2023

(000/lekë)

Art.	Emertimi	Te ardhurat e veta
600	Paga	10,238
601	Sigurime Shoqërore	3,929
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	13,214
604	Trans. Institucioneve	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	
231	Kapitale të Trupëzuara	34,918
	<b>Total</b>	<b>62,299</b>

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, z. K. S, ish Përgjegjësi i Sektorit të Tatim Taksave, znj. F. D, z. K. B, z. B. B, z. H. S dhe znj. R. V, specialiste në sektorin e Tatim Taksave.

### **III.2.3.1. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2023, konkretisht:

#### **Pasqyrat Financiare të vitit 2023.**

- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2023 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
  - Pasqyrat financiare të vitit 2023;
  - Ditari i Bankës;
  - Ditari i Arkës;
  - Ditari i Magazinës;
  - Ditari i Veprimeve të ndryshme;
  - Aktrakordimet me Degën e Thesarit Tropojë;
  - Inventarët etj.

- Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligji nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme, Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 31, datë 13.12.2023, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 9, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

#### **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.**

- **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2023 janë:**
  - Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
  - Pasyra e performancës financiare (F2);
  - Pasqyra e flukseve monetare (F3);
  - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
  - Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasyrat financiare (F5);

*Pasqyrat statistikore:*

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);

- Gjithashtu është dhënë informacion mbi:
  - Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Tropojë me NIPT K4.....6C;
  - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2023-31.12.2023;
  - Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Përgatitur nga znj. E. D;
  - Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Tropojë me shkresën nr.1997, datë 25.04.2024, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Tropojë z. R. B.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Tropojë të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Tropojë, si dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Tropojë.

-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

### Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

*Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.*

b. Kontrollë të llogarive dhe dokumenteve.

Gjendja e llogarive të Pasqyrave Financiare të Bashkisë Tropojë paraqitet si më poshtë:

### Aktivi i Bilancit Kontabël 2022

Llogari	E M E R T I M I	2023	2022
	<b>A K T I V E T</b>	<b>3,510,493,689</b>	<b>3,449,266,232</b>
	<b>I.Aktivet Afat shkurtra</b>	<b>248,383,967</b>	<b>242,051,505</b>
	<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>106,217,052</b>	<b>82,325,373</b>
520	Disponibilitete ne Thesar	106,217,052	82,325,373
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>16,117,654</b>	<b>16,135,344</b>
31	Materiale	2,284,067	1,862
32	Inventar I imet	13,833,587	16,133,482
	<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>126,049,261</b>	<b>143,590,788</b>
423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	48,934	48,934
468	Debitore te ndryshem	46,040,560	44,710,681
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	79,959,767	98,831,173
	<b>II.Aktivet Afat gjata</b>	<b>3,262,109,722</b>	<b>3,207,214,728</b>
<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>15,188,978</b>	<b>13,701,620</b>
202	Studime dhe kerkime	15,188,978	13,701,620
<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>2,857,028,224</b>	<b>2,844,903,066</b>
210	Toka, Troje, Terene	22,460,270	22,460,270
211	Pyje, Plantacione	10,017,959	10,017,959
212	Ndertesa e Konstruksione	1,079,846,799	1,057,967,697
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,674,708,410	1,676,415,929
214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	13,873,236	15,364,209
215	Mjete Transporti	16,851,150	20,200,183
218	Inventar ekonomik	27,499,018	30,705,437
24	Aktive afatgjata te demtuara	11,771,382	11,771,382
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>4.Investime</b>	<b>389,892,520</b>	<b>348,610,042</b>
231	Per Aktive Afatgjata materiale	389,892,520	348,610,042

### 1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

**Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 10,003,446,836 lekë.**

- Aktivet 3,510,493,689 lekë
- Pasivet 161,995,947 lekë

- Aktivet neto 3,348,497,742 lekë

## **Aktivi i Bilancit**

### **Aktivitet afatshkurtra**

Aktivitet afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **248,383,967 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujivalentet e tyre” në shumën 106,217,052 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 16,117,654 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 126,049,261 lekë dhe
- “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 89,831,039 lekë.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet në pasqyrat financiare në shumën 106,217,052 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e fondeve në thesar më 31.12.2023 në shumën 70,270,366 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" e cila paraqitet në shumën 35,946,686 lekë.

- Mjetet në ruajtje përbëhen nga ndalesat e 5 % te garancisë së punimeve.

-Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Tropojë në 31.12.2023 paraqiten në vlerën 16,117,654 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 2,284,067 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 13,833,587 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (17,690) lekë, përbën efektin në shpenzime e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” (*pasqyra F2 – performanca financiare*).

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Tropojë ka nxjerrë Urdhrin nr. 409, datë 11.12.2023.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

**Llogaritë e arkëtueshme** janë në vlerën 126,049,261 lekë të përbëra nga :

- Llogaria 411–Kliente e llogari të ngjashme në vlerën prej 1,872 lekë;
- Llogaria 423-429–Personeli, deficite, gjoba, paradhënie në vlerën prej 48,934 lekë, që përbëhet detyrime të punonjësve;
- Llogaria 468–Debitor të ndryshem në vlerën prej 46,040,560 lekë, për taksa dhe tarifa vendore, si dhe detyrime nga të ndryshme.
- Llogaria 4342-Operacione me shtetin të drejta (fonde që priten të alokohen në vitin në vijim nga buxheti i shtetit), debituar në vlerën prej 79,959,767 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës së 4 të pasivit (si furnitorët, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatim në burim) të pasqyrës financiare të pozicionit financiar.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Mbetja në fund të vitit 2023</b>
Furnitore dhe llogari të lidhura me to	57,002,144
Detyrime ndaj personelit për pagat dhjetor	16,481,893
Detyrime ndaj shteti për tatim page	815,771
Detyrime ndaj sigurimeve shoqërore për dhjetor	4,807,122
Detyrime për sig shende.	659,367
Kreditore, Parapagime	193,470
<b>Totali</b>	<b>79,959,767</b>

**Aktivitet afatgjata** janë në vlerën neto prej 3,262,109,722 lekë, nga të cilat :

**Aktivitet afatgjata jomateriale** në vlerën neto prej 15,188,978 lekë ;

-Gjendja e llogarisë 202 “Studime e projekte” në çelje të vitit 2023 gjendet në vlerën 13,701,620 lekë (Kosto historike – amortizim i akumuluar), ndërsa në fund të vitit 2023 rezulton në vlerën 15,188,978 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2023 + shtesa gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2022 + amortizimin e vitit 2023)].

**Aktivet afatgjata materiale** në vlerën neto prej 2,857,028,224 lekë ;

-Gjendja e llogarisë 210 “Toka, troje dhe terrene”, në çelje të vitit 2023 ka qenë në shumën 22,460,270 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2023.

-Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”, në çelje të vitit 2023 ka qenë në shumën 10,017,959 lekë, e pandryshuar dhe në fund të vitit 2023.

-Gjendja e llogarisë nr.212 “Ndërtime e konstruksione” në çelje të vitit 2023 ka qenë në shumën 1,057,967,697 lekë (kosto historike, duke zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 1,079,846,799 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2023 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2022 + amortizimin e vitit 2023)].

-Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” në çelje të vitit 2023, ka qenë në shumën 1,676,415,929 lekë (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 1,674,708,410 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2023 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2022 + amortizimin e vitit 2023)].

### **Pasivi i Bilancit**

<b>Logaria</b>	<b>EMERTIMI</b>	<b>2023</b>	<b>2022</b>
	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>161,995,947</b>	<b>173,247,030</b>
	<b>I.Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>161,995,947</b>	<b>173,247,030</b>
	<b>1. Llogari te Pagushme</b>	<b>161,802,477</b>	<b>173,053,560</b>
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	57,002,144	71,000,782
42	Detyrime ndaj personelit	16,481,893	14,071,445
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	815,771	552,447.00
435	Sigurime Shoqerore	4,807,122	4,144,183
436	Sigurime Shendetstore	659,367	570,567
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	35,946,686	29,656,242
467	Kreditore te ndryshem		8,298,279
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	46,089,494	44,759,615
	<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>193,470</b>	<b>193,470</b>
419	Kreditore, Parapagime	193,470	193,470

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Tropoj më 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave të investimeve.

**Pasivet (Detyrimet)** janë në vlerën prej 161,995,947 lekë të ndara përkatësisht, si më poshtë vijon :

-Llogaria 401-408 Furnitor dhe llogari të lidhura me to, është në vlerën prej 57,002,144 lekë të cilat janë detyrime ndaj të tretëve për faturat e mbërritura pranë financës, por të palikujduara brenda vitit për mungesë të fondeve.

-Llogaria 42-Detyrime ndaj personelit, është në vlerën prej 16,481,893 lekë ku përfshihen pagat e punonjësve për muajin Dhjetor 2023, të cilat paguhen në muajin Janar të vitit 2024.

-Llogaria 431-Detyrime ndaj shtetit për tatim mbi të ardhurat nga paga në masën 15% sipas klasifikimit të pagave, është në vlerën prej 815,771 lekë, që përfshin tatimin e pagave dhe tatimin në burim të muajit Dhjetor 2020, që paguhet në vitin pasardhës buxhetor.



-Llogaria 435-Sigurimet shoqërore 9.5% punëmarrësi dhe 15% punëdhënësi, si dhe sigurimet suplementare, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe janë në vlerën prej 4,807,122 lekë.

-Llogaria 436-Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarrësi dhe 1.7% punëdhënësi, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe janë në vlerën prej 659,367 lekë.

-Llogaria 466-Kreditor për mjete në ruajtje, është në vlerën prej 35,946,686 lekë në të cilën përfshihen 5% garanci difektsh për objektet e investimeve të cilave nuk u ka mbaruar afati garancisë së punimeve të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, por edhe garanci për të cilat nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për likuidimin e tyre. Llogaria 466 është debituar gjatë vitit 2023 në vlerën 1,224,757 lekë, që përfaqëson vlerën e garancive të kthyera ndaj palëve të të treta në kredi të bankës, si dhe është kredituar për vlerën 7,515,158 lekë, që përfaqëson garancitë e mbajtura nga Bashkia Tropojë kundrejt palëve të treta, në deb itë bankës.

-Llogaria 4341-Operacione me shtetin detyrime është në vlerën prej 46,089,494 lekë. Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Sipas informacionit analitik në këtë llogari janë kontabilizuar të drejta të Bashkisë Tropojë për arkëtim të detyrime të pa paguara të taksave dhe tarifave vendore nga bizneset, si dhe për detyrime të tjera individë, punonjës.

-Llogaria 419-Kreditorë, parapagime në vlerën 193,470 lekë e pa ndryshuar në krahasim me vitin e mëparshëm dhe përbëhet nga detyrimi që njësi vendore ka ndaj tre subjekteve person fizik të NJA Margegaj, për të cilat drejtoria ekonomike nuk administron dokumentacion për kohën e lindjes së këtij detyrimi dhe arsyen e detyrimit.

### Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën **3,348,497,742 lekë**. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

Llogaria	E M E R T I M I	2023	2022
	<b>FONDI I KONSOLIDUAR:</b>	<b>3,348,497,742</b>	<b>3,276,019,202</b>
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,888,334,856	2,874,740,029
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	70,270,366	52,669,131
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	389,892,520	348,610,042.00

-Llogaria 101-Teprica (Fondi Akumuluar), është në vlerën prej 2,888,334,856 lekë, e përberë nga aktivet materiale dhe jomateriale, si dhe gjendja e aktiveve qarkulluese (materiale dhe objekte inventari).

-Llogaria 85-Rezultati veprimtarisë ushtrimore, është në vlerën prej 70,270,366 lekë (Të ardhurat – Shpenzimet), e përbërë nga fondet buxhetore të papërdorura (në debi të llogarisë 520), që trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor.

-Llogaria 105-Grante kapitale të brendshme, është në vlerën prej 389,892,520 lekë, e cila në fillim të vitit është çelur në kredi për vlerën 348,610,042 lekë, kredituar gjatë vitit në vlerën 148,074,986 lekë, për fonde të përdorura për shpenzime kapitale dhe debituar për vlerën 106,792,508 lekë, vlera e aktiveve të marra në dorëzim gjatë vitit 2023. Teprica kreditore në fund të vitit përfaqëson vlerën e investimeve në proces, llogaria 231.

### Pasqyra e Performancës Financiare

000/lekë

	Viti 2023	2022
<b>TE ARDHURAT</b>	<b>792,024,389</b>	<b>730,767,672</b>
<b>L.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>15,562,549</b>	<b>38,577,042</b>
<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>118,753</b>	<b>6,373,995</b>
Tatim mbi te ardhurat personale		6,171,380
Tatim mbi Biznesin e vogel	118,753	202,615

<b>2.Tatimi mbi Pasurine</b>	<b>3,267,375</b>	<b>3,414,105</b>
Tatim mbi Pasurine e paluajtshme	3,267,375	3,414,105
<b>3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit</b>	<b>12,176,421</b>	<b>28,788,942</b>
Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		11,553,183
Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	12,176,421	17,235,759
<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>52,861,134</b>	<b>30,741,142</b>
<b>1.Nga ndermarrjet dhe pronesia</b>	<b>11,169,058</b>	<b>4,859,549</b>
Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	11,169,058	4,859,549
<b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>21,646,661</b>	<b>25,881,593</b>
Tarifa administrative dhe rregullatore	17,260,745	18,736,847
Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	3,988,707	6,457,484
Gjoha, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime	397209	687,262
<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>723,600,706</b>	<b>630,708,347</b>
<b>1.Grant korent I Brendshem</b>	<b>723,600,706</b>	<b>630,708,347</b>
Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	415,291,800	386,136,001
Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	308,308,906	244,572,346
<b>SHPENZIMET</b>	<b>721,754,023</b>	<b>678,098,541</b>
<b>I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>235,118,339</b>	<b>193,328,605</b>
Paga, personel I perhershëm	235,118,339	193,328,605
<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>38,623,164</b>	<b>30,237,162</b>
Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	34,566,099	30,237,162
Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	4,057,065	
<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>83,794,653</b>	<b>61,404,665</b>
Mallra dhe shërbime te tjera		61,404,665
Materiale zyre e te pergjitheshme	349950	
Materiale dhe shërbime speciale	1906566	
Sherbime nga te trete	21062312	
Shpenzime transporti	13283737	
Shpenzime udhëtimi	1764200	
Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	4992845	
Shpenzime per qeramarrje	242000	
Shpenzime per detyrime per kompesime legale	5121405	
<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>364,200,177</b>	<b>391,208,872</b>
<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>7,028,368</b>	<b>4,983,954</b>
Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	7,028,368	4,983,954
<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>357,171,809</b>	<b>386,224,918</b>
Transferita Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	357,171,809	386,224,918
<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>17,690</b>	<b>1,919,237</b>

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:

### **Të ardhurat tatimore**

Llogaria 70 në vlerën prej 792,024,389 lekë, nga të cilat:

Llogaria 700-Tatimi mbi të ardhurat, në vlerën prej 118,753 lekë.

Llogaria 702-Të ardhura nga pasuria e paluajtshme, në vlerën prej 3,267,375 lekë ku përfshihen të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore, ndertesës, truallit.

Llogaria 703-Tatim mbi mallra dhe shërbime brenda vendit, në vlerën prej 12,176,421 lekë.

### **Të ardhurat jo tatimore**

Llogaria 71 në vlerën prej 52,861,134 lekë e përbërë nga:

Llogaria 710-Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia (qirat), në vlerën prej 11,169,058 lekë.

Llogaria 711-Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare (tarifa administrative për lëshim dokumentesh, gjoha, shërbimi i zjarrëfikses), në vlerën prej 21,646,661 lekë.

### **Grante**

Llogaria 72-Grant Korent i brendshëm, në vlerën prej 723,600,706 lekë në të cilin përfshihen grante nga qeveria për shpenzime, financim i pritshëm, taksat e ndara, si dhe sponsorizime nga të tretë.

### **Shpenzimet**

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket shpenzimeve:

Emërtimi	Sipas Situacionit
600	235,118,339
601	38,623,164
602	83,794,653
604 + 606	7,028,368

63	17,690
<b>Totali</b>	<b>721,754,023</b>

**Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi se:**

1. Pasqyrat financiare të Bashkisë Tropojë për vitin 2023 janë përcjellë në Degën e Thesarit Tropojë më datë 25.04.2023, pra jashtë afatit ligjor.

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, pika 118.

Ndikim negativ në vendimmarrjen e nivelit drejtues të Bashkisë Tropojë për kryerjen e përmirësimeve në veprimet kontabël gjatë vitit ushtrimor 2023.

2. Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Tropojë, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 35,946,686 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Tropojë.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2023, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, paraqiten si më poshtë:

Nr	Objekti	Vlera
1	Rikonstruksion ura dragobi	199,125
2	Ndërtim ekonomi shtimit te troftes	108,783
3	Ndërtim ujesjellsi dragobi	212,858
4	Rikonstruksion i urave dragobi	99,952
5	Rik rrjeti brendshem ujësjellsit cernic	99,917
6	Ura viçidol (struktura mbrojtëse)	12,339
7	Rikostuksion kanali fushë lumë	1,229,683
8	Rik. rruga bushat-qendër	71,238
9	Ndërtim shkolle brice	110,329
10	Rrugë të brendshme rurale	218,566
11	Ndërtim çatie qendrës sportive zona b	42,366
12	Ndërtim shpatulle dhe sistemim shtrati lumi Tropojë	18,000
13	Ndërtim shpatulle dhe sistemim shtrati lumi Tropojë	32,979
14	Mirëmbajtja e rrugëve të bjeshkëve	174,805
15	Përforcim këmbë ura dezdar	32,760
16	Mirëmbajtja e rrugëve të bjeshkëve	66,807
17	Rikonstruksion fusha futbollit	150,487
18	Sistemim në lagjet e qytetit	60,578
19	Sistemimi i ujrave te larta margegaj	210,689
20	Rikonstruksion urë këmbësore curraj eper	83,309
21	Rikonstruksion i shkollës "tinka kurti' Lekbibaj	148,355
22	Rikonstruksion i shkollës "tinka kurti' Lekbibaj	148,355
23	Rikonstruksion i shkollës "tinka kurti' Lekbibaj	183,390
24	Rikonstruksion i shkollës "Tinka Kurti' Lekbibaj	183,390
25	Pyllzim me gështenja	336,826
26	Rruga qendër-shkollë	45
27	Zyrat e komunës Bujan	455,203
28	Sistemim asfaltim i rrugëve të qytetit B. Curri Bulevadi i qytetit faza i	913,419
29	Rrugët e qytetit lagja partizani	1,950,591
30	Ndërtimi i ujësjellsit B. Curri	27
31	Alsfatim sheshi Azem Hajdari	479,281
32	Rikonstruksion rrugës rosuj selimaj faza e i-rë	189,282
33	Sistemim - asfaltim Sheshi Azem Hajdari	98,535
34	Sistemim - asfaltim rruga lagja 28.gushti B. Curri	184,900
35	Riparim ura fshati aste	47,389
36	Rikualifikim fasadat të objektve në qytetin B. Curri	91
37	Rikualifikim i fushës së futbollit (garanci punimesh) B. Curri	235,673
38	Rikonstruksion i shkollës "Asim Vokshi "	338,230
39	Rikonstruksion i shkollës "Asim Vokshi-palestra dhe terrenet sportive"	1,130,200
40	Rikonstruksion kanli vaditës ura vakës-cernice	924,716

41	Ndertim ure, lug tropoj, shunic zogaj	26,042
42	Rikonstruksion bank shk a vokshi	1,593,908
43	Ujësjiellësi i Dragobisë	693,095
44	Rikonstruksion shkolla Tinka Kurti, Lekbibaj	154,981
45	Rikonstruksion shkolla Tinka Kurti, Lekbibaj	154,981
47	Kanali vaditës Ahmataj- sopot	109,151
49	Rikonstruksion varrezat b. curri 5%	129,828
50	Rikonstruksion 5 segmentet 5%	4,000,000
51	Rikonstruksion 5 segmentet 5%	1,500,000
52	Ujësjiellësi i fshatit dragobi	1,000,000
55	Rikonstruksion i pesë segmenteve rrugore diferencë faturash	1,904,170
	Total	22,449,624

-Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 22,449,624 lekë për vitin 2021.

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

Ndikim negativ në vendimmarrjen e nivelit drejtues të Bashkisë Tropojë për kryerjen e përmirësimeve në veprimet kontabël gjatë vitit ushtrimor 2023.

3. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 rezulton se llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” është në vlerën prej 0 lekë e cila nuk është e saktë pasi nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” e cila është në vlerën 79,959,767 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”. Efekti: Llogaria nr. 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2023.

4. Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Klubi i Futbollit Valbona” me NIPT M09230601A, u konstatua se Bashkia Tropojë zotëron 100% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 350 aksione me vlerë nominale 10,000 lekë secili, në **total 3,500,000 lekë**.

Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Kukës Sh.A” me NIPT M28322201I, u konstatua se Bashkia Tropojë zotëron 16.6% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 14600 aksione me vlerë nominale 100 lekë secili, në **total 1,460,000 lekë**.

-Pra sa më sipër llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar me 4,960,000 lekë.

-Gjithashtu konstatohet se Bashkia Tropojë ende vazhdon të zotërojë aksione në klubin sportiv “Valbona”, megjithëse sipas nenit 8 në Ligjin nr. 105/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”, përcaktohet shprehimisht:

#### Neni 8

Neni 22, “Kapitali shtetëror”, ndryshohet si më poshtë:

1. Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, *brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji<sup>8</sup> i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.*

2. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.

<sup>8</sup> Hyrë në fuqi në muajin Shtator 2021

3. Nëse në përfundim të periudhës njëvjeçare, aksionet e zotëruara nga institucionet publike në shoqëritë tregtare sportive nuk shiten, këto të fundit marrin formën sipas përcaktimeve të nenit 21 të këtij ligji.

-Pra sa më sipër Bashkia Tropojë duhet të kishte nxjerrë në shitje aksionet e saj.

Këto veprime janë në kundërshtim me Urdhrin i Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar.

Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2023.

5. Gjendja e llogarisë nr.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën kontabël 46,089,494 lekë. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Nga analiza e llogarisë analitike, rezulton se në llogarinë 4341, ndër të tjera janë kontabilizuar edhe debitorët (llogaria 468) ndaj Bashkisë Tropojë, për taksa dhe tarifa vendore etj.

-Sa më sipër konstatohet se në llogarinë 4341 është bërë kontabilizim i gabuar i vlerës së debitorëve për taksa dhe tarifa vendore, gjoha etj. Nga analizimi i përbërjes së debitorëve, ilustruar për disa zëra, Bashkia Tropojë nuk ka detyrimin që t’i arkëtojë ato për llogari të buxhetit të shtetit, pasi nuk janë taksa të ndara apo Bashkia Tropojë të veprojë si agjent tatimor. Në këtë rast kemi të bëjmë me taksa dhe tarifa vendore, si dhe gjoha, të cilat kalojnë direkt në buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-Sa më sipër llogaria nr.4341 është mbivlerësuar me vlerën 33,117,410 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, klasa 4 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve”. Llogaria nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2023.

6. Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2023 është në vlerën 44,710,681 lekë dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 46,040,560 lekë, pra me një rritje në vlerën 1,329,879 lekë.

Levizja e llogarisë 468 Sintetike				Viti 2022		
Viti	Bashkia Tropojë dhe NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2022	Debi	Kredi	Mbetja
2023		Debitorë të ndryshëm	44,710,681	6,016,405	4,686,526	46,040,560

Nga verifikimi i listës analitike të debitorëve në fund të vitit 2023, konstatohet se nuk janë kontabilizuar të drejtat për arkëtim në vlerën **13,002,090 lekë**, si më poshtë vijon:

- vlera prej **11,021,770 lekë** nga kontratat e qirave për 12 subjekte, pasqyruar në aneks të Raportit Përfundimtar;

- vlera prej **1,600,000 lekë** për 7 subjekte nga gjohat e vendosura nga IMTV, pasqyruar në aneks të Raportit Përfundimtar;

- vlera prej **360,320 lekë** nga taksa e fjetjes në hotele për 13 subjekte, pasqyruar në aneks të Raportit Përfundimtar;

- vlera prej **20,000 lekë** për 2 subjekte nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake, pasqyruar në aneks të Raportit Përfundimtar.

-Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12;

Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”.

Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk paraqet situatën e drejtë të përbërjes së debitorëve të Bashkisë Tropojë në fund të vitit 2023.

7. Llogaria 401-408 në fund të vitit 2023 paraqitet me vlerën 57,002,144 lekë. Nga shqyrtimi i llogarisë analitike për fatura të mbërritura por të palikujduara, konstatohet se nuk janë kontabilizuar faturat për vlerën 5,021,709 lekë, si më poshtë vijon:

Nr	Objekti	Vlera
1	Pastrim kanalesh Letaj -Zogaj detyr prapambetur	988,135
2	Dif.Fature Dru zjarri	2,916,326
3	Blerje beton per riforcimin ekembeve te ures Kojel shumice	1,117,248
	<b>Total</b>	<b>5,021,709</b>

Këto veprime janë në kundërshtim me Funkcionimin kontabël të llogarive të klasës 4, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Llogaria nr. 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2023.

8. Llogaria 467 në fund të vitit 2023 paraqitet me vlerën 0 lekë. Nga auditimi i llogarisë analitike, konstatohet se në 3 raste detyrimet, të cilat janë krijuar si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore, janë keq klasifikuar në llogarinë 401-408, ku një prej tyre është mbivleësuar me 424,600 lekë. Këto raste duhet të kontabilizoheshin në llogarinë nr. 467. Gjithashtu konstatohet se në llogarinë nr. 467 nuk janë kontabilizuar të gjitha detyrimet e krijuara në vlerën 32,666,178 lekë, si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore. Të gjitha sa më sipër janë pasqyruar në tabelat më poshtë.

#### Keqklasifikim në llogaritë kontabël

Objekti/Subjekti	Llog. në të cilën është kontabilizuar	Vlera e kontabilizuar	Llog. ku duhej të kontabilizohej	Vlera që duhet të kontabilizohet	Diferenca
Zyra Permbarimit A K	401-404	300,000	467	300,000	
M Gj	401-404	849,200	467	424,600	+424,600
Demshperblim per punjosit e larguar	401-404	1,141,350	467	1,141,350	
<b>Total</b>				<b>1,865,950</b>	

#### Mungesë e kontabilizimit

Objekti/Subjekti	Vlera që duhet të kontabilizohet
A Z	603,010
A D	425,497
H sh.p.k	29,781,538
Xh C	260,192
SS	262,400
F H	513,231
J P	299,546
D M	234,550
H D S	286,214
<b>Total</b>	<b>32,666,178</b>

Këto veprime janë në kundërshtim me Funkcionimin kontabël i llogarive të klasës 4, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. Llogaria nr. 467 “Kreditor të tjerë”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2023.

9. Llogaria nr. 312 në fund të vitit 2023 vlerën 2,284,067 lekë. Llogaria nr.312, është llogari, rezultati i së cilës në fund të vitit del nga rezultatet e inventarizimit vjetor të magazinës ku ndodhen këto aktive, por nga auditimi konstatohet se në procesin e inventarizimit të vitit 2023 nuk është kryer inventarizimi i kësaj llogarie nga komisionet e ngritura për këtë qëllim, e si rrjedhim vlera e pasqyruar në pasqyrat financiare, nuk jep siguri se është një vlerë e saktë. Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun 3, pika 3.1, paragrafi 30 në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar; Pikat 73 dhe 74, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve të njësisë së sektorit publik”, i ndryshuar. Mos kryerja e inventarizimit ndikon në mos raportimin real të vlerës së llogarisë nr. 312.

10. Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 327 “Inventar i imët”.

Për vitin 2023, për llogarinë nr. 327, ka mospërputhje midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare dhe vlerës së komisionit të inventarizimit.

Llogaria nr.32 “Inventar i imët”, në bilancin e vitit 2023 ka vlerën 13,833,587 lekë, ndërkohë sipas inventarit fizik rezulton vlera 13,526,127 lekë, ose 307,460 lekë më pak, ç’ka tregon humbje të aktiveve.

Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun 3, pika 3.1, paragrafi 30 në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Llogaria 327 “Inventar i imët”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2023.

11. Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.215 “Mjete transporti”.

Për vitin 2023, për llogarinë nr. 215, ka mospërputhje midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare dhe vlerës së komisionit të inventarizimit.

Llogaria nr.215 “Mjete transporti”, në pasqyrën F7 për vitin 2023 ka vlerën 67,084,391 lekë (kosto historike), ndërkohë sipas inventarit fizik rezulton vlera 63,631,998 lekë, ose 3,452,393 lekë më pak.

Gjithashtu konstatohet se nuk është bërë kontabilizimi i vlerës 7,632,000 lekë, për kamionin e blerë gjatë vitit 2023.

Këto veprime janë në kundërshtim me Kreun 3, pika 3.1, paragrafi 30 në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Llogaria 215 “Mjete transporti”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2023.

12. Mbi kontabilizimin e llogarive nr. 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.

Gjendja e llogarisë nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione” në çelje të vitit 2023 ka qenë në shumën 1,057,967,697 lekë (kosto historike, duke zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2023 është në vlerën 1,079,846,799 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2023 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2022 + amortizimin e vitit 2023)].

Nga shyqrtimi i llogarisë, konstatohet se në AQT nuk është kontabilizuar objekti “Rikonstruksion i sallës së muzeut” për vlerën 1,522,723 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Klasa 2 “Aktivet afatgjata”<sup>9</sup> në Udhëzimin nr. 8 datë

---

<sup>9</sup> Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivët afatgjata, para se

09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Llogaria nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2023.

13. Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.210 “Toka, troje, terrene” dhe llogarisë nr.211 “Pyje Plantacione”.

Gjendja e llogarisë **210 “Toka, Troje, Terrene”** në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën 22,460,270 lekë, e pa ndryshuar është dhe në fund të vitit 2023.

Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme sipas aneksit në vijim:

**Analiza e llogaria 210-Toka, troje e terrene – viti 2020-2021**

Nr	Emërtimi i aktivitetit	Vlera
1	Truall i Shkolla e re 9-vjecare "A.Podrimja"	17,855,270
2	Varrezat e qytetit muri rrethues	4,605,000
	Total	22,460,270

Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se:**

Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, nuk janë kontabilizuar:

a) vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë nr.212 “Ndërtime e konstruksione”;

b) vlerat e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të ish Komunës Fierzë, aktualisht NJA Fierzë Bashkia Tropjë, përkatësisht me VKM nr.565, datë 22.08.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Fierzë të Qarkut të Kukësit”;

c) vlerat e trojeve që janë pajisur me certifikatë pronësie, si më poshtë vijon:

Pasuri me certifikatë pronësie				Vlera e truallit sipas VKM Nr. 89, datë 3.2.2016 <sup>10</sup>	
Nr. Rend.	Emërtimi	Sip. në m2	NJA	Lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e truallit
1	Truall	1169	Margegaj	160	187,040
2	Truall	1886	Margegaj	160	301,760
3	Truall	1125	Margegaj	160	180,000
4	Truall	935	Bajram Curri	1873	1,751,255
5	Truall	55	Bajram Curri	1873	103,015
6	Truall	464	Bajram Curri	1873	869,072
7	Truall	250	Bajram Curri	1873	468,250
8	Truall	5300	Fierzë	160	848,000
9	Truall	451	Fierzë	160	72,160
10	Truall	629	Fierzë	160	100,640
11	Terren Sportiv	8899	Bajram Curri	1873	16,667,827
12	Terren Sportiv	2828	Bajram Curri	1873	5,296,844
13	Truall	2169	Bajram Curri	1873	4,062,537
14	Truall	1365	Bajram Curri	1873	2,556,645
15	Truall	2000	Fierzë	160	320,000
16	Shesh	1230	Fierzë	160	196,800
17	Truall	93	Bajram Curri	1873	174,189
18	Truall	36	Bajram Curri	1873	67,428
19	Truall	58	Bajram Curri	1873	108,634
<b>TOTAL</b>					<b>34,332,096</b>

-Gjendja e llogarisë nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 10,017,959 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2023.

Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera për pyllëzime në zona të ndryshme, pasqyruar në tabelën më poshtë:

të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

<sup>10</sup> Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë.



Nr	Përshkimi i aktivitet	Vlera
1	Pyllzime me geshtenja Dushaj	6,736,526
2	Pyllzime me lajthia Breg Lumi	1,981,336
3	Permiresime pyjore	128,870
4	Permiresime pyjore	211,646
5	Fidana Blini dhe Bredhi	256,480
6	Mbjellje pemesh ne lulishte	703,100
	<b>Total</b>	<b>10,017,958</b>

Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se:**

Në llogarinë nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk janë kontabilizuar:

a) vlerat e pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM të veçanta kanë kaluar në pronësi të ish Komunave, aktualisht NJA Fierzë Bashkia Tropojë, konkretisht:

VKM nr. 610, datë 14.5.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Llugaj të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 649, datë 21.5.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Bujan të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 521, datë 23.4.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Bytyç, të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 199, datë 21.2.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Fierzë të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 555, datë 7.5.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Lekbibaj të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, e ndryshuar, pika 43, shtojca me nr. 41, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Tropojë, me numër rendor nga 1 (një) deri 2792 (dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy).

b) vlerat e pasurive që janë pajisur me certifikatë pronësie, si më poshtë vijon:

Nr. Rend.	Emërtimi	Sip. në m <sup>2</sup>	NJA
1	Vresht	3000	Bajram Curri
2	Vresht	12000	Bajram Curri
3	Arë	1482	Bajram Curri
4	Arë	2463	Bajram Curri
5	Arë	1500	Bajram Curri

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap III, pika 30, i ndryshuar.

Llogaritë nr. 210 “Toka, troje, terrene” dhe nr. 211 “Pyje Plantacione”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2023.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:*

Z. R. B, me detyrë Kryetar i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e nëpunësit autorizues.

Znj. E. D, me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues.

### **III.2.4.1. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.**

Në trajtim të kësaj pike të programit të auditimit janë administruar evidencat si mëposhtë:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Tropojë
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastrë
- Inventari i fondit pyjor
- Kontratat e lidhura për dhënien me qira të fondit pyjor

#### **-Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe rregjistrimit e tyre në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës.**

Në zbatim të ligjit nr. 8744, datë 22.01.2011, “Pë transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”; VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”; VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”; pika 66 dhe UMF nr. 30 datë **27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III**, pika 30,35/a; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu III, pika 1 dhe UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, kreu V, pika 4 dhe ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 për qeverisjen vendore dhe ligjit 9936, date 26.06.2008, për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” në Bashkinë Tropojë rezulton si më poshtë:

Nga të dhënat rezulton se në Bashkinë Tropojë sipas VKM me nr. 649, datë 21.05.2008 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Njësia Administrative Bujan, të Qarkut Kukës sasia prej 132 prona në 3 fletë.

Sipas VKM me nr. 378, datë 08.04.2009 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Njësia Administrative Bujan, të Qarkut Kukës sasia prej 200 prona në 40 fletë.

-VKM me nr. 521, datë 23.04.2008 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Njësia Administrative Bytyç, të Qarkut Kukës sasia prej 214 pronash në 7 fletë.

-VKM me nr. 1209, datë 11.12.2009 është miratuar lista përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Njësia Administrative Bytyç, të Qarkut Kukës sasia prej 863 prona në 115 fletë.

-VKM me nr. 322, datë 19.03.2006 është miratuar lista përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Njësia Administrative Markgegaj, të Qarkut Kukës sasia prej 623 prona në 51 fletë.

-VKM me nr. 327, datë 19.03.2006 është miratuar lista përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Njësia Administrative Markgegaj, të Qarkut Kukës sasia prej 113 prona në 4 fletë.

-VKM me nr. 610 datë 14.05.2008 është miratuar lista përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Njësia Administrative Llugaj, të Qarkut Kukës sasia prej 86 prona në 3 fletë.

-VKM me nr. 7 datë 07.01.2009 është miratuar lista përfundimtare e pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Njësia Administrative Tropojë, të Qarkut Kukës sasia prej 370 prona në 56 fletë.

-VKM me nr. 473, datë 16.04.2008 është miratuar lista përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë se qeverisjes vendore Njësia Administrative Tropojë Fshat, të Qarkut Kukës sasia prej 238 prona në 7 fletë.

-VKM me nr. 555, datë 05.05.2008 është miratuar lista përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë se qeverisjes vendore Njësia Administrative Lekbibaj, të Qarkut Kukës sasia prej 236 prona në 7 fletë.

-VKM me nr. 928, datë 02.07.2008 është miratuar lista përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë se qeverisjes vendore Njësia Administrative Lekbibaj, të Qarkut Kukës sasia prej 842 prona në 115 fletë.

-VKM me nr. 430, date 15.05.2013 është miratuar lista përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë se qeverisjes vendore Njësia Administrative Fierzë, të Qarkut Kukës sasia prej 636 prona në 97 fletë.

-VKM me nr. 397, datë 01.06.2011 është miratuar lista përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave që do të transferohen në pronësi të njësisë se qeverisjes vendore Bashkisë Tropojë, të Qarkut Kukës sasia prej 173 prona në 37 fletë.

-VKM me nr. 134, datë 03.03.2021 është miratuar lista përfundimtare të pronave, pyjeve dhe kullotave si dhe ndryshimet për pronat që transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore Bashkia Tropojë, në Qarkun e Kukësit sasia prej 2873 prona në 38 fletë.

Pra sipas VKM-ve të paraqitura rezulton se janë gjithsej **4726 prona** të cilat i kanë kaluar në përdorim Bashkisë Tropojë (shih pasqyrën si më poshtë).

Nr.	Emertimi i Njësive Administrative	Nr. i aseteve	Nr .VKM-DATA e data
1	NJV- Bujan NJV- Bujan	132 200	649. data 21.05.2008 379. data 08.04.2009
2	NJV- Bytyç NJV- Bytyç	214 863	521 data 23.04.2008 1209 data 11.12.2009
3	NJV- Margegaj NJV- Margrgaj	623 113	322 data 19.03.2006 327 data 19.03.2006
4	NJV- Lugaj	86	610 data 14.05.2008
5	NJV -Tropoje Fshat NJV- Tropoje Fshat	370 238	7 data 09.01.2009 473 data 16.04.2009
6	NJV-Lekbibaj NJV-Lekbibaj	236 842	555 data 05.05.2008 928 data 15.05.2008
7	NJV-Fierz NJV-Bajran Curri	636 173	430 data 15.05.2013 397 data 01.06.2011
	<b>Totali</b>	<b>4726</b>	

Nga sa më sipër rezulton se nuk ka regjistër me të gjitha të dhënat dhe modalitetet për secilën pronë, nuk kanë manaxhuar dhe vlerësuar secilin aset që janë në administrim të Bashkisë Tropojë Qarku Kukës, por janë mjaftuar vetëm nga listat e printuara të dala me VKM përkatëse nga viti 2008.

Gjatë vitit 2023, sipas VKB nr. 125 datë 29.12.2022 është miratuar struktura përkatëse në të cilën përfshihet edhe sektori i pronave dhe hartografisë e cila funksionon me tre punonjës dhe sipas rregullores me Vendim nr. 41 datë 06.03.2018 dhe me nr. 1143 prot., datë 06.03.2011 në “Neni 59 “Përgjegjësi i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë, (pika 2) shprehimisht thuhet:

“Përgjegjësi i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë përgjigjet tek Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e objektivave, planeve dhe politikave në lidhje me identifikimin, inventarizimin, verifikimin e të gjithë pronave të paluajtshme të administruara nga Bashkia Tropojë”.

*Pra konstatojmë se nuk ka pasur bashkëpunim midis sektorit të pronave dhe Drejtorisë së Planifikimit të Territorit “Bashkia Tropojë” ku rezulton se gjatë vitit 2023 nuk kanë bashkëpunuar me Agjensinë Kombëtare të Kadastrës të Qarkut Kukës (ASHK-Kukës) dhe nuk na u paraqitën shkresa, komunikime e bashkëpunime, në vitin 2023 nuk ka funksionuar dhe nuk ka urdhër nga titullari për ngritjen e një grupi pune për ndjekjen dhe çertifikimin e pronave të Bashkisë, që ka në përdorim si pyjet, kullota, tokat buqësore, ambjente të ndryshme etj.*

Nga Sektori i pronave nuk ka të dhëna mbi siperfaqet e aseteve, nuk janë kryer shërbimet Giz dhe topografike si kufizimet dhe nuk kanë vlerësuar secilin aset dhe nuk ka të dhëna mbi

ndjekjen e procedurave të secilit aset, me te gjitha modalitetet të përshkuara në VKM dhe nuk janë të pasqyruara në bilancin vjetor të vitit 2023 me vlerat perkatëse të secilit aset, hartat, genplanet, planimetritë, sipërfaqet e secilës pronë etj.

Për ndjekjen e procedurave për regjistrimin dhe paisjen me certifikatë pronësie nga Agjensia Kombëtare e Kadastrës - Kukës në vitin 2023 nuk është pajisur me certifikatë regjistrimi asnjë aset dhe pronë e dhënë në përdorim Bashkisë Tropojë, por janë mjaftuar dhe paraqiten asete të kryera vite më parë, pra janë pajisur nga viti 2017 deri në vitin 2020 gjithsej vetëm **43 prona para vitit 2023** (Shih tabelën si më poshtë).

**LISTA E ÇERTIFIKATAVE TË PRONËSISË BASHKIA TROPOJË**

Nr.Rend	Emërtimi	Sip. në m2	Data e lëshimit	Numri i pasurisë	Zona Kadastrale	Njësia Administrative
1	Truall	1169	08. 11. 2017	100/33/2	3703	Margegaj
2	Truall	1886	08. 11. 2017	100/33/1	3703	Margegaj
3	Truall	1125	08. 11. 2017	100/33/3	3703	Margegaj
4	Truall	935	07. 05. 2014	10/79	1347	Bajram Curri
5	Godinë	480	19. 04. 2017	4/90	1347	Bajram Curri
6	Godinë	130	19. 04. 2017	4/101	1347	Bajram Curri
7	Truall	55	06. 05. 2019	7/218	1347	Bajram Curri
8	Truall	464	03. 10. 2018	7/152	1347	Bajram Curri
9	Truall	250	05. 03. 2019	10/83	1347	Bajram Curri
10	Truall	5300	07. 05. 2018	2/52	1617	Fierzë
11	Truall	451	07. 05. 2018	2/149	1617	Fierzë
12	Truall	629	07. 05. 2018	2/124	1617	Fierzë
13	Terren Sportiv	8899	11. 04. 2018	5/17	1347	Bajram Curri
14	Njësi	49.6	20. 03. 2018	6/59-N1	1347	Bajram Curri
15	Terren Sportiv	2828	11. 04. 2018	11/291	1347	Bajram Curri
16	Truall	2169	27. 06. 2017	11/51	1347	Bajram Curri
17	Truall	1365	27. 06. 2017	12/34	1347	Bajram Curri
18	Godinë	418	19. 04. 2017	4/118	1347	Bajram Curri
19	Godinë	298	19. 04. 2017	4/122	1347	Bajram Curri
20	Zyra (kati perdhe)	96	16. 02. 2017	6/60 Z1	1347	Bajram Curri
21	Zyra (kati perdhe)	33.35	05. 01. 2016	6/60/3	1347	Bajram Curri
22	Truall	2000	19. 11. 2014	3/138	1617	Fierzë
23	Shesh	1230	27. 12. 2002	1/45	1617	Fierzë
24	Godine	256	18. 12. 2002	1/169	1617	Fierzë
25	Truall	93	14. 02. 2020	11/232	1347	Bajram Curri
26	Truall	36	14. 02. 2020	11/230	1347	Bajram Curri
27	Truall	58	14. 02. 2020	11/228	1347	Bajram Curri
28	Truall dhe ndertese	2499	25. 11. 2014	4/142	1347	Bajram Curri
29	Ndertese	335	28. 07. 2017	4/114-ND	1347	Bajram Curri
30	Truall dhe ndertese	5186	11. 06. 2014	10/60-N	1347	Bajram Curri
31	Vresht	3000	14. 09. 2009	1/16/1	1347	Bajram Curri
32	Vresht	12000	14. 09. 2009	1/18/1	1347	Bajram Curri
33	Objekt (P. i sportit)	4464	25. 11. 2014	5/9	1347	Bajram Curri
34	Ndertese	930	26. 05. 2014	7/32/1	1347	Bajram Curri
35	Ndertese	6120	25. 11. 2014	7/20/1	1347	Bajram Curri
36	Ndertese	3640	11. 06. 2014	10/58	1347	Bajram Curri
37	Objekt (Garazhd)	55	09. 07. 2013	6/55	1347	Bajram Curri
38	Truall dhe godinë	4629	14. 10. 2013	10/43	1347	Bajram Curri
39	Godinë	720	14. 10. 2013	6/55	1347	Bajram Curri
40	Arë	1482	17. 12. 2008	38/1/19	1347	Bajram Curri
41	Arë	2463	17. 12. 2008	38/1/18	1347	Bajram Curri
42	Arë	1500	20. 01. 2010	42/3-C	1347	Bajram Curri
43	Ndertese	1333	26. 05. 2014	4/35/1	1347	Bajram Curri
	<b>Shuma:</b>	<b>83058.95</b>				

Nga të dhënat rezulton se 4726 asete të Bashkisë Tropojë janë në total dhe nga këto janë paisur me certifikatë pronësie nga ASHK-Kukës 43 asete ose 0.9 % e aseteve, pra 4683 janë pa u pasur me certifikata pronësie dhe nga vitet 2021 deri në fund të vitit 2023 nuk kanë pajisur asnjë aset të dhënë në përdorim me certifikatë pronësie nga Bashkia Tropojë si shkolla, troje, sheshe, pentore, arra, spitale, zyra, rruge, kanale, lulishte, varreza, pyje, moçalishte, kodrina, pyje, kullota, magazina, reparte ushtarake etj.

Nuk disponohen të dhëna dhe regjistra me gjithë të dhënat me modalitetet e duhura mbi pronat e zaptuara nga qytetarët, nuk ka dokumentacion dhe për ato prona të cilat janë legalizuar dhe nuk kanë dokumenta të bashkangjitur mbi pronën e Bashkisë të dalë me VKM nr. 397 datë 01.06.2011 dhe konkretisht disa prej rasteve:

Inventarizimi i pronave të kostatuara në vitin 2015 nga punonjësit e urbanistikës që rezultojnë të zëna në kundërshtim me ligjin dhe nuk është marrë asnjë masë paraprake si dhe nuk ka asnjë vendim të marrë për këto asete të bashkisë, si dhe dokument argumentues ligjor të paraqitura pranë instucioneve përkatse nëse këto asete janë në procedure ligjore.

1- Zona kadastrale 1347, nr. pasurie “nuk ciklohet”, emërtimi-truall, këndi i lojrave për fëmijë 5,883 m<sup>2</sup> e zënë nga privati, pronë e Bashkisë Tropojë “Nuk ka asnjë dokument argumentues ligjor mbi zënien e këtij trualli në kundërshtim me ligjin”.

2- Zona kadastrale 1347, emërtimi -truall + objekt, Cerdhe e fëmijve Dardania, 464 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 400 m<sup>2</sup> e zënë nga privati, pronë e Bashkisë Tropojë “Nuk ka asnjë dokument argumentues ligjor mbi zënien e ketij trualli në kundërshtim me ligjin”.

3- Zona kadastrale 1347, emërtimi dhomë zhveshje e sportit, 116 m<sup>2</sup> e zënë nga privati, pronë e Bashkisë Tropojë “Nuk ka asnjë dokument argumentues ligjor mbi zënien e këtij trualli në kundërshtim me ligjin”.

4- Zona kadastrale 1347, emërtimi fusha futbollit, 8,793 m<sup>2</sup> e zënë nga privati, pronë e Bashkisë Tropojë “Nuk ka asnjë dokument argumentues ligjor mbi zënien e këtij trualli në kundërshtim me ligjin”

5- Zona kadastrale 1347, emërtimi Terren sportive 8,793 m<sup>2</sup> e zënë nga privati, pronë e Bashkisë Tropojë “Nuk ka asnjë dokument argumentues ligjor mbi zënien e këtij trualli në kundërshtim me ligjin”

6- Zona kadastrale 1347, emërtimi K S V 41.5 m<sup>2</sup> ndërtesë 41 m<sup>2</sup> e zënë nga privati, pronë e Bashkisë Tropojë “Nuk ka asnjë dokument argumentues ligjor mbi zënien e këtij trualli e ndërtesë në kundërshtim me ligjin”

7- Zona kadastrale 1347, nr. pasurie 5/17, emërtimi Fushë futbollit, 8,753 m<sup>2</sup> e zënë nga privati, pronë e Bashkisë Tropojë “Nuk ka asnjë dokument argumentues ligjor mbi zënien e këtij trualli në kundërshtim me ligjin”

8- Zona kadastrale 1347, nr. pasurie 5/15 emërtimi Zyrat e Klubit Valbona 20 m<sup>2</sup> e zënë nga privati, pronë e Bashkisë Tropojë “Nuk ka asnjë dokument argumentues ligjor mbi zënien e këtij trualli në kundërshtim me ligjin”

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi, sipas strukturës për ndjekjen dhe inventarizimin dhe manaxhimin e pronave në vitin 2023, Dejtore i Drejtorisë së Planifikimit dhe zhvillimit të territorit z. H. I, përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë, z. M. K, specialist i pronave dhe hartografisë znj. M. Gj dhe specialist znj. S. S, përgjegjës Sektorit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit z. E. M.

-Nuk ka bashkëpunim për ndjekjen e procedurave me ASHK –Kukës për paisjen me “Certifikata pronësie” për asetet që disponon Bashkia Tropojë në shifrën 4683 prona të pacertifikuara dhe mos bashkëpunim sipas referencave ligjore të ndryshuara vitin e fundit favorizon paisjen me certifikatë pronësie.

Pra me veprime e mos veprime si dhe mos marja e masave në kohë me ndryshimet e fundit ligjore që favorizojnë dhe lehtësojnë tarifën sipas sipas ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” sipas nenit 43 ku shprehimisht thuhet “Tarifat e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”

a- Për regjistrimin fillestar të pronave të institucioneve shtetërore dhe të njësisve të vetëqeverisjes vendore aplikohen tarifa shërbimi “**të reduktuara**”, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për kadastrën.

Në Bashkinë Tropojë “Nuk ka regjistër të pronave sipas komunave të specifikuara me sipërfaqet me kufizime, me vlerat përkatëse secili objekt dhe të jenë kontabilizuar në bilancin përkatës të bashkisë, si dhe nuk pasqyrohen vijueshmëria me të dhënat dhe modalitetet përkatëse deri në plotësimin e dosjeve të secilit objekt deri në paisjen me Certifikatë Pronësie pranë ASHK- Kukës”, si dhe regjistër për pyjet kullotat ranishtet kaluar Drejtorisë së Pyjeve dhe Mjedisit, për ndjekjen e procedurave sipas VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”;

Pra kostatojmë se nuk janë mbajtur regjistra për ndjekjen e procedurave ligjore sipas rasteve, kohës së aplikimit, bashkëpunim me instucionet e tjera kryesisht ASHK-Kukës me të dhënat me modalitetet përkatëse për sipërfaqet, kufizimet, matjet e kryera nga topografi, shkresat e nisura pranë ASHK, zaptimet e ndryshimet që mundet të kenë këto prona, pra sa më sipër mbajnë përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë z. R. B, Dejtore i Drejtorisë së Planifikimit dhe zhvillimit të territorit z. H. I, Përgjegjës Sektorit të Pronave dhe Hartografisë z. M. K, specialist e pronave dhe hartografisë znj. M. Gj dhe specialist znj. S. S.

### Mbi administrimin e Aseteve, Pyjeve Kullotave në Bashkinë Tropojë rezulton:

Sipas VKM nr. 433, datë 8.6.2016. “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkive”; pika 66 dhe UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30,35/a; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, ku thekson se sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas listave të inventarit, infrastruktura mbështetëse e tyre, asetet, arkivi dhe protokolli, aktualisht, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mjedisit, si edhe sipërfaqet e fondit pyjor e kullosor publik dhe infrastruktura mbështetëse e tyre, që i janë transferuar ish- komunave e bashkive, transferohen në pronësi të bashkive.

Nga të dhënat e Drejtorisë së Sherbimit Pyjor, Kullotave dhe Buqësisë rezulton si më poshtë

*Tabela e pronave të transferuara me VKM sipas listës përfundimtare të inventarit dhe sa prej tyre janë regjistruar në ASHK.*

Nr.		VKM		Në përdorim /në numër	Nga këto Regjistruar ne ASHK-KUKËS
		Numër	Datë		
1	Bashkia Tropoje	134	03.03.2021		0
2	Bashkia Tropoje	EK BERISHE-BYTYC		1-24	0
3	Bashkia Tropoje	EK CURRAJ EPERM		1-20	0
4	Bashkia Tropoje	EK LUGINA T'PLANIT		1-21	0
5	Bashkia Tropoje	EK LUGINA TROPOJES		1-31	0
6	Bashkia Tropoje	EK LUMI GASHIT		30	0
7	Bashkia Tropoje	EK MAJA PEJES		1	0
8	Bashkia Tropoje	EK NIKAJ-MERTUR		1-2,4	0
9	Bashkia Tropoje	EK QENDER		1,3,6-17	0
10	Bashkia Tropoje	EK ZOGAJ		1-16	0
11	Bashkia Tropoje	EP BERISHE-BYTYC		1-321	0
12	Bashkia Tropoje	EP CURRAJ I EPERM		1-169	0
13	Bashkia Tropoje	EP HELSHAN		38a	0
14	Bashkia Tropoje	EP KRUME		13b	0
15	Bashkia Tropoje	EP LUGINA T'PLANIT		1-214	0
16	Bashkia Tropoje	EP LUGINA TROPOJES		1-279	0
17	Bashkia Tropoje	EP LUGINA KOLGECAJE		1-93	0
18	Bashkia Tropoje	EP LUMI GASHIT		118-119	0
19	Bashkia Tropoje	EP NIKAJ-MERTUR1		1-153	0
20	Bashkia Tropoje	EP NIKAJ-MERTUR 2		1-48	0
21	Bashkia Tropoje	EP STOBERDE		1-109	0

*Pra sipas listës rezulton se nuk kanë mbaruar plotësisht procedurat për paisjen me Certifikata Pronësie të pyjeve dhe kullotave sipas ligjit 20/2020 “Për Kadastrën”*

Sipas VKM nr. 134 datë 03.03.2021 “Për disa ndryshime në VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive, i kanë kaluar në pronësi sipërfaqe pyjore Drejtorisë së Sherbimit Pyjor, Kullotave dhe Buqësisë si më poshtë:

*Gjithsej 49,770.91 ha, nga këto:*

- Pyje 33502.69 ha,
- Kullotë 12541.8 ha

- Toka joproductive 3726.42 ha

*Pra kostatojmë se 49,770.9 ha nuk kanë certificata pronësie, nuk ka plane e studime për ndjekjen e procedurave për regjistrimin e tyre sipas ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” sipas nenit 43 ku shprehimisht thuhet “Tarifat e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”. Në ruajtjen manaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave dhe caktimin e punonjësve në ruajtjen, mbrojtjen nga dëmtimet dhe zjarret janë marrë në dorzim nga inspektorët përkatës dhe nga një specialist, të firmosura nga Përgjegjse e Sektorit znj. S. M dhe punonjësit përkatës. Sipas dokumentave të vëna në dispozicion rezulton se nuk janë të bashkëgjatura hartat, nuk janë të përshkruara saktë zonat kadastrale, nuk ka miratim nga titullari, nuk janë të protokolluara dhe nuk janë paisur me procesverbale secili grup inspektimi.*

Në dosjet e paraqitura nuk janë të sistemuara, nuk kanë nxjerrë urdhëra nga titullari në subjektin e kontrolluar, akt verifikimet dhe procesverbalet e mbajtura në vitin 2022 nuk kanë as numër serial dhe as nuk protokollohen.

Në vitin 2023 nuk është mbajtur as një akt verifikimi dhe procesverbal mbi dëmtimet nga zjarret apo fenomene të ndryshme të ndodhura në kullota, cka tregon se manaxhimi nuk ka qënë në shkallën e duhur, këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë **27.12.2011** “**Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik**”, kap. III, pika 30,35/a; ligjin nr. 57/2020 “Per pyjet”, ku shprehimisht thuhet për detyrat e specialistit:

Profesionistët e pyjeve:

- Në kuptim të këtij ligji, profesionistët të pyjeve janë: a) punonjësit e institucioneve përgjegjëse për pyjet, në nivel qendror dhe vendor; b) specialistët e institucioneve të arsimit profesional dhe të arsimit të lartë në fushën e pyjeve; c) stafi teknik dhe profesional i institucioneve përgjegjëse për pyjet; ç) ekspertët në fushën e pyjeve.

Neni 34 shprehimisht thuhet: ç) ndëshkimin me gjobë në përputhje me kufijtë dhe parashikimet e këtij ligji, si dhe ekzekutimin e saj; d) vendimin për pagimin dhe rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor, si dhe ekzekutimin e tyre; dh) kallëzimin penal sipas rastit dhe Ligji nr. 48/2016 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, Të ndryshuar si dhe neni 38 (Procedimi në fondin pyjor).

*Në planin e menaxhimit të ekonomisë pyjore verehen se administrimi dhe manaxhimi i tyre nuk ka funksionuar si duhet, mungojnë procesverbale mbi dëmtimet nga zjarret për vitin 2023, punonjësit nuk justifikojnë punën e tyre në rastet kur nuk kanë kostatuar dëmtime nga zjarret ose prerje e lendëve drusore etj.*

*Për sa më sipër me veprimet e mos veprime ngarkon me përgjegjësi, Drejtor i drejtorisë shërbim pyjor z. K. B, Përgjegjës Sektori për menaxhimin e shfrytëzimin Pyjor në Drejtori znj. A. H, Specialist z. S. M, Specialiste për kadastrën dhe GIS znj. E. H dhe Përgjegjësen e Sektorit Pyjor dhe Kullotave znj. S. M.*

#### **-Auditim mbi procedurat e dhënjës me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.**

Bashkia Tropojë ka dhënë me qira 18 prona kryesisht” për biznese, për matje e intesitetit të erës për qëllime studimi, mbjellje peme frutore dhe strehim social në vitin 2023 me afat qiraje 1 (një vjecar) deri 9-vjecare, pasqyryar në Kapitullin Aneks tabela nr.7:

Sipas kontratave të lidhura dhe të miratuara në Këshillin Bashkiak dhe të miratuara nga titullari i institucionit sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” rezulton se sipas kontratave të lidhura deri më 31.12.2022 janë debitorë 11 subjekte në vlerën **8,448,759 lekë**, debitorë të krijuar për vitin 2023 janë 12 subjekte në vlerën 2,573,011 lekë dhe progresive deri 31.12.2023 janë 14 subjekte në vlerën **11,021,770 lekë**, të cilat janë të pa kontabilizuara dhe përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Në dhënien e kontratave në dosjet përkatëse rezulton se nuk janë të plotësuara me të gjithë dokumentacionin përkatës, në secilën prej kontratave konstatohet se mungojnë Certifikatat e pronësisë si dhe hartat topografike të secilës pronë me nr. pasurie dhe specifikës me kufijtë ndarëse të secilit aset konkretisht:

1-Qiramarrsi z. A. D, Fierz ka marrë me qira 0.154 ha ose 1540 m<sup>2</sup> i cili ka lidhur kontratë me Bashkinë Tropojë për mbjellje pemë frutore, datë 21.03.2023, me nr. prot., 1201/1 me afat 1 vjecar dhe rezulton se ka mungesë dokumentacioni si më poshtë:

-nuk ka bashkangjitur hartën si dhe certifikatën e pronësisë,

-nuk ka plan biznesin e hollësishëm për përmirësimin e pronës; në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (pika B)” me ndryshime.

2-Qiramarrsi z. A. H (Person Fizik) ka marrë me qira ambjentin (Bar-Kafe) 11 m<sup>2</sup> i cili ka lidhur kontratë me Bashkinë Tropojë, datë 19.03.2023, me nr. prot., 1291/1 me afat 1 vjecar dhe rezulton se ka mungesë dokumentacioni si më poshtë:

-nuk ka bashkangjitur hartën si dhe certifikatën e pronësisë,

-nuk ka vërtetim që ka shlyer detyrimet tatimore, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (pika ë)” me ndryshime”.

3-Qiramarrsi z. A. D (Person Fizik) ka marrë me qira ambjentin (Bar-Kafe ) 101 m<sup>2</sup> i cili ka lidhur kontratë me Bashkinë Tropojë “Pallati i Kulturës Dardania”, datë 14.02.2023, me nr. prot., 992 me afat 1 vjecar dhe rezulton se ka mungesë dokumentacioni si më poshtë:

-nuk ka bashkangjitur hartën si dhe certifikatën e pronësisë.

-nuk ka vërtetim që ka shlyer detyrimet tatimore, në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (pika ë) me ndryshime.

4-Qiramarrsi z. F. G ka marrë me qira ambjentin (Për Strehim) 46 m<sup>2</sup> i cili ka lidhur kontratë me Bashkinë Tropojë “Pallati i Kulturës Dardania”, datë 06.01.2023, me nr. prot., 111 me afat 1 vjecar dhe rezulton se ka mungesë dokumentacioni si më poshtë:

-nuk ka bashkangjitur hartën si dhe certifikatën e pronësisë.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi për mos administrimin e pronave dhe asetëve si dhe në drejtim të menaxhimit, organizimit dhe funksionimit të strukturave mbi regjistrimin dhe administrimin e pronës Publike (Asetet dhe Pyjet Kullotave) të trasferuara sipas VKM nr. 649. data 21.05.2008 dhe nr. 379 data 08.04.2009, VKM nr. 521 data 23.04.2008, VKM nr. 1209 data 11.12.2009, VKM nr. 322 data 19.03.2006, VKM nr. 327.data 19.03.2006, VKM nr. 610 data 14.05.2008, VKM nr. 7 data 09.01.2009 dhe VKM nr. 473 data 16.04.2009, VKM nr. 555 data 05.05.2008, VKM nr. 928 data 15.05.2008, VKM nr. 397 data 01.06.2011 dhe VKM nr. 430 data 15.05.2013, për mos ndjekjen e procedurave dhe regjistrimit të tyre në Agjensinë Shtetërore të Kadastrës sipas nenit 43 të ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, pra këto veprime janë në kundërshtim me nenin (34 dhe 38) të ligjit nr. 57/2020 “Per pyjet”, në kundërshtim me VKM nr. 1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391 datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” pika 2 lidhja 11, pra sa më sipër mbajnë përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë z. R. B, Dejtore i Drejtorisë së Planifikimit dhe zhvillimit të territorit z. H. I, Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë z. M. K, specialist i pronave dhe hartografisë znj. M. Gj dhe specialist znj. S. S, si dhe *Drejtoria dhe Sektori i Pyjeve dhe kullotave për mos veprime ngarkon me përgjegjësi*, Drejtor i Drejtorisë shërbim pyjor z. K. B, Përgjegjës i Sektorit për menaxhimin e shfrytëzimin Pyjor në Drejtori znj. A. H, Specialist z. S. M, Specialist për kadastrën dhe GIS znj. E. H dhe Përgjegjësen e Sektorit Pyjor dhe Kullotave znj. S. M.

*Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga z. M. K, znj. M. Gj, znj. S. S është paraqitur observacioni me nr.3621/21 prot., datë 31.12.2024, i administruar në KLSH me nr. 1087/6 prot., datë*



09.01.2025, në pretendimet e tyre mbi ndjekjen e procedurave të inventarizimit dhe certifikimit të pronave dhe aseteve të Bashkisë Tropojë, ku theksoni se nuk kemi fonde dhe buxhet të mjaftueshëm për certifikimin e tyre, si dhe mbi përgjegjësinë për manaxhimin e aseteve sipas sektorëve.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:** Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë, pasi pavarësisht mungesës së fondeve dhe buxhetit nga ana e Bashkisë Tropojë, ju keni detyrën tuaj funksionale për të vazhduar me procedurat dhe prëgatitjen të pronave dhe aseteve, vlerësimin, matjet, hartat, planimetritë, genplanet për secilën pronë të miratuara me VKM dhe të kaluara në përdorim, të cilat nuk kërkojnë shpenzim, por duhet vetëm kohë dhe dorëzimin e tyre në ASHK, veprim i cili nuk është kryer, sipas ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” sipas nenit 43.

Për sa i përket shkallës së përgjegjësisë të përgjegjësive dhe specialistëve nga grupi i auditimit merret pjesërisht në konsideratë.

### **III.2.5.1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

-Me shkresën e KLSH nr. 518/10, datë 17.11.2023 është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Tropojë, sipas Programit të Auditimit me nr. 518/1 Prot., datë 08.06.2023, i ndryshuar

-Nga Bashkia Tropojë në lidhje me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e dërguar nga KLSH. Bazuar në Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 236/1, datë 04.12.2023 “Mbi ngritjen e komisionit për hartimin e Planit të Veprimit në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” është miratuar Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, **pra janë pranuar të gjitha rekomandimet.**

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se Bashkia Tropojë nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor, mosveprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 154 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja “j”.

Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 - mujor.

-Bashkia Tropojë me shkresën nr. 2751/100, datë 22.07.2024. ka dërguar raportin mbi realizimin e zbatimit të rekomandimeve jashtë afatit 6 - mujor për zbatimin e rekomandimeve. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, e cila citon: “*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*”.

Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 22 masa organizative

Nga auditimi rezulton se:

-Nga 22 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht, 1 masë është zbatuar, janë në proces zbatimi 11 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 7 masa.

***Në mënyrë të detajuar po i paraqesim më poshtë:***

Për zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, nga titullari i Bashkisë Tropojë është ngritur grupi i punës me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 236/1, datë 04.12.2023 “Mbi ngritjen e komisionit për hartimin e Planit të Veprimit në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” është miratuar Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e

rekomandimeve dhe afatet përkatëse, me përbërje znj. Z I, z. K. R, z. A. K, z. H. I, znj. F. H, znj. K. A, z. K. B, z. K. S, znj. A. H, z. B. S.

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 518/10 prot., datë 17.11.2023, statusi i zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1.Rekomandimi:** Nga ana e Bashkisë Tropojë, të merren masat për zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, duke hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, në përputhje me strukturën organizative; organizimin e Sistemin e Kontrollit të Brendshëm; hartimin e strategjisë së riskut, regjistrin e riskut, si dhe gjurmën e auditimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Bashkia Tropojë pretendon se rekomandimi i mësipërm është zbatuar

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Tropojë ka miratuar regjistrin e riskut, por ende nuk ka miratuar strategjinë e riskut dhe gjurmën e auditimit. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë të marrë masa për organizimin e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, dhe të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njesisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë publike.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Bashkia Tropojë pretendon se ka përfshirë në organikë strukturën e Njesisë së Auditit të Brendshëm.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Tropojë nuk ka një njësi auditi funksional. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**3.1.Rekomandimi:** Këshilli Bashkiak Tropojë të marrë masa që në çdo rast votimi i vendimeve të bëhet me shumice votash, në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim që vendimi kolegjal të ketë zbatueshmëri, në interes të komunitetit, brenda juridiksionit që mbulon.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Bashkia Tropojë pretendon se Këshilli Bashkiak i merr vendimet në shumicë votash, ashtu siç e parashikon ligji. Gjithashtu Këshilli Bashkiak ka ngritur Komision Verifikimi për proccerverbalet e mbajtur gjatë zhvillimi të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, konkretisht procesverbaleve të mbajtuara përgjatë mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, u konstatua se vendimet me shumicën e kërkuar në zbatim të kërkesave ligjore. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i zbatuar.

**4.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Tropojë të merren masa:

- Për të vendosur një raport të drejtë midis numrit të punësuarve me ngarkesën e punës, sipas drejtorive, sektorëve përkatës, me qëllim arritjen e objektivave dhe kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve.

- Krijimin e kushteve për nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale me qëllim zbutjen e papunësinë.

- Të rishikojë emërtesën dhe pagesën për 9 specialistë të gjendjes civile, të cilët nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”, sipas përcaktimeve ligjore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Subjekti pretendon se ky rekomandim është zbatuar

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se nuk është marrë asnjë masë me qëllim vendosjen e një raporti të drejtë lidhur me ngarkesën e punës, sipas drejtorive përkatës, me qëllim arritjen e objektivave dhe kryerjen e sërëbimeve ndaj qytetareve.

- Për sa i përket krijimit të kushteve për nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale me qëllim zbutjen e papunësisë, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë plan masash ose plan veprimi për zbutjen e papunësisë në territorin e Bashkisë Tropojë dhe njësive administrative në varësi të këtij institucioni vendor

- Për sa i përket emërimit të 9 (nëntë) specialistëve të gjendjes civile, nga verifikimi i bërë në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Sektori i Burimeve Njerëzore, u konstatua se 9 punonjësit e gjendjeve civile vijnë të mbajnë emërimin specialist.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**5.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë të marrë masa për kontrollin e gjendjes teknike të disa mjeteve të rënda nëse janë rentabël ose jo, pasi paraqesin jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe kanë mbushur kuotën e plotë të amortizimit referuar normave ligjore të përcaktuara, për të bërë mundur uljen e shpenzimeve të karburantit dhe pjeseve të këmbimit, për mjetet:

1. Autobot benz 47- vjeçar viti i prodhimit 1976.
2. Kamioni benz 40- vjeçar, viti i prodhimit 1983.
3. Kamion benz 37- vjeçar, viti i prodhimit 1986.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Nga pyetësorët dërguar Bashkisë Tropojë, subjekti është shprehur se e ka të pamundur të zëvendësojnë automjetet e vjetra me të reja.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa për likuidimin e detyrimeve të pa likuiduara të prapambetura prej 86 milion lekë, duke normalizuar situatën në drejtim të rishikimit të buxhetit, rritjes së taksimit, uljes së shpenzimeve, rishikimit të organikës, përdorimit të fondit të veçantë, etj. Gjithashtu të likudojnë vendimet gjyqësore për vlerën 3,7 milion lekë dhe vendimet gjyqësore të fituara nga ish-punonjësit për largime nga puna për vlerën 935,000 lekë, si dhe të arkëtojnë vlerën 31,787,531 lekë, nga debitorë progresivë, të taksave dhe tarifave vendore të krijuara deri më 31.12.2022, si dhe të analizojë shkaqet që kanë krijuar këtë situatë, duke nxjerrë përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës.

#### **Menjëherë**

**Përgjigja e subjektit:** Është bërë likuidimi i një pjese të detyrimit duke filluar nga detyrimi më i hershëm, si për operatorët ekonomikë ashtu edhe për vendimet gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna. Po punohet në vazhdimësi për arkëtimin e debitorëve progresivë.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se ky rekomandim rezulton të jenë në proces zbatimi.

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Tropojë të marrë masa, për mbajtjen e partitarëve analitik, centralizatorit dhe librit veprimeve të ndryshme, sipas kërkesave ligjore, si dhe të marrë masa për uljen e vlerës së llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila rezulton e rritur gjatë vitit 2022.

#### **Menjëherë**

**Përgjigja e subjektit:** Është bërë mbajtja e partitarëve analitikë dhe e centralizatorit dhe ditari i veprimeve të ndryshme. Po punohet në më vazhdimësi për ulje në debitorëve të ndryshëm në llogarinë 468.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se janë mbajtur ditare për veprime të ndryshme si dhe po punohet për uljen e debitorëve në llogarinë 468. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

**8.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë të marrë masa që në vijimësi, për çdo rast për ndihma të menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, përpara se të procedojë me

dhënien e tyre, të verifikojë plotësimin e dokumentacionit përkatës, duke siguruar gjendjen e dokumentacionit justifikues, në përputhje me kërkesat ligjore.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Janë marrë masa për verifikimin e tyre dhe është bërë kontrolli i gjithë dokumentacionit para likuidimit të tyre. Pavarësisht se Këshilli del me vendim për dhënien e tyre, sektori i financës nuk ka kompetencë për t'i refuzuar.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**8.2.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të marrë masa, që për çdo procedurë me blerje dhe shërbime me vlera të vogla, si dhe në rastet si më sipër, të plotësohen me dokumente justifikuese, fletëhyrjet, normativat ligjore, për të bërë të mundur eliminimin e shpenzimeve pa efektivitet dhe aplikimin me standard të njëjtë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Në çdo rast për çdo blerje të vogël plotësohet praktika me dokumentet e nevojshme.

**Komenti i grupit të auditimit:** Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**9.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë të marrë masa për plotësimin dhe sigurimin e dokumentacionit të munguar në inventarizimin e pasurisë dhe nxjerrjeve jashtë përdorimit të mallrave e materialeve, sipas rasteve për shkeljet e konstatuara në inventarizimet dhe nxjerrjet jashtë përdorimit të vitit 2022. Gjithashtu të kryejë inventarizimin në të gjithë sektorët për të bërë të mundur përfundimin e këtij procesi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Është kryer inventarizimi dhe do vazhdohet me procedurën e vlerësimit dhe të asgjësimit sipas legjislacionit për materialet që janë jashtë përdorimit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**10.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriteret të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e objektit që prokurohet.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Do punojmë në vazhdimësi për këtë problem

**Komenti i grupit të auditimit:** Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**11.1.Rekomandimi:** Titullari i AK Bashkia Tropojë, të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për shpenzimet e njësive publike..

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Zbatuar

**Komenti i grupit të auditimit:** Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**12.1.Rekomandimi:** AK Bashkia Tropojë dhe strukturat përgjegjëse të krijuara për administrimin dhe menaxhimin e procesit të prokurimit të fondeve publike, të marrin masa për të shmangur çdo ndryshim artificial të kufirit monetar, pa arsye objektive, duke krijuar kushte për kryerjen e prokurimeve në përputhje me procedurat standarte të prokurimit publik. Gjithashtu AK, gjatë përllogaritjes së vlerësimit të kontratës, duhet të ketë si qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes të sa më shumë operatorëve ekonomikë.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit të auditimit:** Është marrë në konsideratë rekomandimi dhe po zbatohet në vazhdim.

**Komenti i grupit të auditimit:** Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**13.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, të respektojë afatet dhe kushtet e vendosura në kontratën bazë, duke nënshkruar amendamente kontratash vetëm nëse ato i referohen kushteve/kritereve mbi të cilat, OE është shpallur fitues i një procedure.

**Përgjigja e subjektit:** Janë marrë masat për të evidentuar tejkalimin e afateve në bashkëpunim me sektorin e urbanistikës

**Komenti i grupit të auditimit:** Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**13.2.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, në rastet e nënshkrimit të amendamenteve të kontratave bazë, ato të nënshkruhen përpara përfundimit të kontratës bazë ose të amendamentit të mëparshëm.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti i subjektit:** Janë marrë masat duke u njoftuar sektori i Urbanistikës që të njoftojë për kërkesat që do të paraqiten për amendim

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**14.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, në të gjitha procedurat e prokurimit me objekt "Kryerje punimesh", të përfshihen në preventivat e tyre, të gjitha zërat e domosdoshëm për garantimin e sigurisë dhe standarteve teknike me qëllim, shmangien e dëmtimit të investimit në të ardhmen.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Subjekti pretendon se kjo masë është zbatuar

**Komenti i grupit të auditimit:** Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**15.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë, të marrë masa që në të ardhmen, në rastet e delegimit të kompetencave tek vartësit e tij, të përcaktojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e të deleguarit konform ligjeve dhe rregullave në fuqi, duke kryer dhe njoftimet e duhura në transparencë për publikun por dhe duke monitoruar njëkohësisht vendimet e marra nga i deleguari.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Është bërë në konform me ligjet dhe rregullat në fuqi. Gjithashtu jemi konsultuar dhe kemi shkresë nga KLSH.

**Komenti i grupit të auditimit:** Grupit të auditimit nuk iu vë në dispozicion dokumentacioni justifikues lidhur me këtë rekomandim. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet të jetë i pazbatuar.

**15.2.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, Drejtori i Kabinetit, Sektori Juridik, të marrin masa që në të ardhmen, përpara konceptimit të shkresave për delegimin e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë tek cilido nga vartësit e tij, të argumentohet dhe dokumentohet arsyeja e delegimit të kompetencave duke respektuar njëkohësisht ligjin për formën dhe përmbajtjen e dokumentit të delegimit të kompetencave por dhe për afatin e delegimit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Subjekti është përgjigjur se janë marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij rekomandimi

**Komenti i grupit të auditimit:** Grupit të auditimit nuk iu vë në dispozicion dokumentacioni justifikues lidhur me këtë rekomandim. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet të jetë i pazbatuar.

**16.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, të miratohen gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të Bashkisë, me qëllim dokumentimin e të gjitha veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Komenti i subjektit:** Subjekti është përgjigjur se janë marrë masat e duhura për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacioni të vënë në dispozicion, u konstatua se në Bashkinë Tropojë nuk janë miratuar gjurmët standarde të auditimit. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**17.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë dhe Drejtoria e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratimit të lejeve të ndërtimit të mbahen aktet e kontrollit sipas përcaktimeve ligjore

**Menjëherë dhe ne vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Subjekti pretendon se ky rekomandim është zbatuar.

**Komenti i grupit të auditimit:** Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë. Për sa më sipër rezulton të jetë në proces zbatimi.

**18.1.Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti, dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, duke zbatuar vendimin e prishjes së objektit. Në rast kundërshtimi ndaj personave përgjegjës, të ndiqen procedurat ligjore, duke kërkuar bërjen e kallëzimit penal ndaj shkelësve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Subjekti pretendon se ky rekomandim është zbatuar.

**Komenti i grupit të auditimit:** Ky rekomandim mbetet për t'u verifikuar nga grupet e auditimit në auditimin e radhës që do të kryhet nga KLSH mbi përputhshmërinë. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**19.1.Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

**Përgjigja e subjektit:** Po punohet për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

**Masa Organizative të lëna në auditimin e mëparshëm, rikërkojmë të merren masa për zbatimin e rekomandimeve si më poshtë:**

#### **A.1. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartojë strategjinë e riskut, regjistrin e riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

**Përgjigja e subjektit:** Subjekti ka vënë në dizpocion hartën e procesit të punës si dhe regjistrin e riskut.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nu është përditësuar ende Rregullorja. Është hartuar Regjistri i Riskut dhe harta e proceseve të punës por nuk janë hartuar ende Gjurma e Auditimit dhe Strategjia e Riskut. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

**1.2.Rekomandimi:** Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme, rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët janë trajtuar si punonjës me “Kodin e Punës”, ku në fakt pozicioni i punës trajtohet sipas ligjit të “Nëpunësit Civil”.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Sektori i Burimeve Njerëzore ka ngritur komisionin për rishikimin dhe hartimin e Rregullores dhe jemi në proces përditësimi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se Rregullorja nuk është përditësuar. Është miratuar regjistri i riskut, por nuk është miratuar Strategjia e Riskut dhe Gjurma e Auditimit. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Tropojë. Në përzgjedhjen e punonjësve të kihet në konsideratë fakti se audituesi i brendshëm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e “Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Kryetar i Bashkisë ka marrë masa duke hapur strukturën e Bashkisë Njësinë e Auditit të Brendshëm

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se në Bashkinë Tropojë nuk funksionon Njësia e Auditit të Brendshëm. Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet të jetë i pazbatuar.

**4.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Janë marrë masat për procedurat që kanë sjellë dokumentacionin në kohë dhe nuk është tejkualuar afati 30 ditor. Ndërsa për procedurat që është prerë fatura dhe nuk ka dokumentacion në kohë ka ardhur vonesa e likuidimit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet të jetë zbatuar.

**5.1.Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Sektorin e Tatim Taksave dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 42,876,907 lekë, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2021, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Tropojë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigja e subjektit:** Po punohet në vazhdimësi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ky rekomandim konsiderohet të jetë në proces zbatimi.

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrejë grup pune me specialistë të fushës për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) të cilat janë pasuri e bashkisë, duke evidentuar statusin dhe gjendjen e tyre faktike në teren.

**Përgjigja e subjektit:** Po punohet në vazhdimësi

**Komenti i grupit të auditimit:** Nuk u administrua asnjë dokumentacion provues (urdhër) për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**6.2.Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë të plotësojë regjistrin e të gjitha aktiveve sipas llogarive përkatëse, i cili të jetë elektronikë dhe shkresor dhe të marrë masa për regjistrimin e pronave në ASHK dhe kontabilitet. Për çdo vit, të kryhet inventarizimi i këtyre aktiveve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Janë marrë masat dhe po punohet për ta përfunduar.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**7.1.Rekomandimi:** Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “U. K. T Sh.A me vlerë 764,579,800 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Ujësjetllësi Kanalizime Tropojë është shkëputur nga Bashkia dhe nuk ka lidhje me ne.

**Komenti i grupit të auditimit:** Ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të marrë masa për plotësimin e listës së kreditorëve me të gjithë elementët e duhur, si objektin e prokurimit, numrin e faturës, datën e faturës, etj. elementë të cilët identifikojnë plotësisht llojin, kohën e lindjes së detyrimit, arsyen e detyrimit që Bashkia Tropojë ka ndaj të tretëve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Janë marrë masat

**Komenti i grupit të auditimit:** Nuk u vu në dispozicion dokumentacioni provues për zbatimin e këtij rekomandimi. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**10.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përsheptuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon;

Për 14 masa organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi si dhe për 13 masa organizative të pa zbatuara.

Për 3 masa shpërblim dëmi me vlerë 9,587,836 lekë

Për 9 persona masa administrative me gjobë në vlerën 1,020,000 lekë sipas vendimit të APP.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Po punohet për zbatimin e tyre

**Komenti i grupit të auditimit:** Ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

## **B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TËARDHURA TË MUNGUARA)**

**1.1.Rekomandimi:** Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në mënyrë progresive në vlerën 43,951,182 lekë. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim për vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të merren masa për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:



a- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit (ASHK) dhe Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPPP), kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet neni 93 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë 1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimin, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Nga vlera 43,951,182 lekë gjatë vitit 2022 është arkëtuar vlera 7,511,844 lekë. Për pjesën e mbetur janë marrë masa shtrenguese si më poshtë: U është dërguar njoftim dhe kërkesë për pagim detyrimi, u është bërë urdhër bllokimi në të gjitha bankat e nivelit të dytë. Për subjektet që kanë konfirmuar gjendje në llogari të tyre për shumën e detyrimit të dërguar me urdhër bllokimi, u është bërë urdhër për ekzekutim. Jemi në fazën e dërgimit të kërkesave për vendosjen e barrës sigurose RSM (për mjetet) dhe ASHK (pronat e paluajtshme).

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit dhe të dhënave të vëna në dispozicion rezulton se ky rekomandim është në proces zbatimi.

**2.1.Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Tropojë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 4,600,000 lekë nga 5 subjektet debitor për taksën e lëshimit të licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, sipas listës në aneksin nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Për këtë kategori debitorësh janë kryer procedurat shkresore dhe realizuar dhe nga vlera 4,600,000 lekë, detyrimi i mbetur është 2,600,000 lekë. Në vijim do të merren masa për arkëtimin e këtyre debitorëve.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se janë janë arkëtuar 1,600,000 milionë lekë nga shuma prej 4,600,000 lekësh, ndërkohë që kanë mbetur ende 2,600,000 lekë detyrime të paarkëtuara. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

**3.1.Rekomandimi:** Zyra Juridike në hartimin e kontratave dhe shtesave të tyre me operatorë të ndryshëm në bashkëpunim dhe me Sektorin Pyjor i cili përpilon raportin teknik dhe me Drejtorin e Financës, të arkëtojnë detyrimin e kontraktuar në vlerën 2,201,048 lekë, aneksit nr. 10 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti pretendon se ky rekomandim është në proces zbatimi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se me shkresën me nr. 2564 prot., datë 06.06.2024, Sektori Juridik dhe i Prokurimeve Publike i ka dërguar Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave si dhe Sektorit të Tatim Taksave kërkesë për informacion dhe dokumentacion, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH.

-Me shkresën nr. 2564/1 prot., datë 12.06.2024, Sektori i Pyjeve dhe Kullotave i ka kthyer përgjigje Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, duke vënë në dijeni se Sektori i ka nisur shkresë AKBN për informacion të hollësishëm si: emri i subjektit, numri i lejes, afati i lejes,

sipërfaqja e lejes, emërtimin e vendburimit, administratorin, adresën si dhe cdo informacion të vlefshëm për subjektet minerare që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Bashkisë Tropojë.

-Në vijim të kësaj shkrese, Sektori pretendon me marrjen e këtij informacioni nga AKBN, do të ngrihet më pas grupi i punës për evidentimin dhe njoftimin e subjekteve minerare për paraqitjen pranë Bashkisë për lidhjen e kontratave sipas legjislacionit në fuqi për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore e kullosore jashtë lejes minerare.

-Sektori vë në dijeni se nga 22 subjekte minerare, 11 prej tyre kanë kontratë me Bashkinë.

-Në vijim të korrespondencave zyrtare mes sektorëve të Bashkisë Tropojë, Sektori i Tatim Taksave me shkresën nr. 2564/2 prot., 01.02.2024 (kjo datë nuk përkon me historikun dhe kronologjinë e këtyre kërkesave ndërmjet sektorëve), i ka kërkuar znj. A H, me detyrë përgjegjës i këtij sektori, të vihen në dispozicion dosjet e kontratave të qirave, duke qenë se Sektori Juridik ndjek hapat ligjor për vjeljen e detyrimeve.

-Për sa më sipër vlera prej 2,201,048 lekë nuk është arkëtuar nga Bashkia Tropojë. Për sa më sipër ky rekomandim **rezulton të jetë i pazbatuar.**

**3.2.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë të përdorë të gjitha mekanizmat ligjorë, për lidhjen e 22 kontratave me operatorët për nxjerrje dhe shfrytëzim të mineralit të kromit, të cilët ushtrojnë aktivitet prej disa vitesh në asetet e Bashkisë Tropojë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Janë marrë masat së bashku me Sektorin e Pyjeve dhe po bashkëpunohet që të bëhet rishikimi i dokumentacionit.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Tropojë ka lidhur 11 kontrata nga 22 subjekte minerare që ushtrojnë aktivitetin në territorin e Bashkisë Tropojë. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

**4.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Tropojë të merren masa administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 4,059,163 lekë, gjë që ka sjell të ardhura të munguara në Bashkinë Tropojë për subjektet që kanë lidhur kontrata qiraje sipas aneksit nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti pretendon se po punohet së bashku me sektorin juridik

**Komenti i grupit të auditimit:** Me shkresën nr. 2565 prot., datë 06.06.2024, Sektori Juridik i Bashkisë Tropojë i ka kërkuar Sektorit të Tatim Taksave nëse janë njoftuar subjektet për arkëtimin vullnetarisht të vlerës prej 4,059,163 lekë dhe rasteve të atyre subjekteve që kanë likuiduar detyrimin.

-Në vijim të shkresës, Sektori Juridik kërkon listën e atyre subjekteve që nuk kanë shlyer detyrimin, bashkëngjitur masën e detyrimit dhe çdo dokumentacion tjetër që disponohet për çështjen në fjalë.

-Përpos administrimit të korrespondencave mes sektorëve përgjegjës në Bashkinë Tropojë, nuk u konstatua asnjë dokument që të vërtetojë shlyerjen e detyrimit të më sipërme. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**5.1.Rekomandimi:** Inspektorati Vendor i Mbrojtës Territorit (IVMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Tropojë, të kërkohe në Gjykatë, shndërrimi i 14 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe arkëtimi i vlerës 1,650,000 lekë, që kanë kryer ndërtim pa leje në territorin e Bashkisë Tropojë.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti pretendon se i është kërkuar informacion njësisë së IMTV në Bashkinë Tropojë, por nuk kanë marrë asnjë informacion lidhur me statusin e këtij rekomandimi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë dokument provues lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

## **MASA DISIPLINORE**

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 gërmat b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 gërma b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Tropojë t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Gjithashtu i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë që bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, si dhe në kontratën e punës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti pretendon se ky rekomandim është zbatuar.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se nuk janë rekomandimi për marrjen e masave disiplinore nuk është zbatuar nga ana e sektorëve të menaxhimit Bashkia Tropojë. Nga verifikimi i procesverbaleve mbi ecurinë disiplinore të punonjësve ngarkuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dërguar nga KLSH, u konstatua se për të kjo ecuri është ndërprerë për secilin nga punonjësit, duke mos u marrë asnjë masë ndaj tyre.

**20.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa, që në vijimësi investimet e planifikuara për tu kryer të jenë pjesë e programit buxhetor afatmesëm, si dhe në buxhetin vjetor, i cili është pjesë e këtij programi.

### **Menjëherë**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti pretendon se ky rekomandim është zbatuar

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se ky rekomandim është në proces zbatimi.

## **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Tropojë të merren masa, të ndiqen të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej 186,810 lekë pa t.v.sh nga BOE “N” & “R C” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 866/2 Prot., datë 03.03.2022, me objekt “Rikualifikim urban “Lagja Partizani” Blloku 1&2, Bajram Curri”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Gjithashtu të kryhet verifikimi në objekt me grup pune, në prezencë të mbikëqyrësit dhe subjektit kontraktues, lidhur me numërin e pushtave të shiut të vendosura në objekt dhe në varësi të diferencave me ato të situacionuara, të procedohet me likuidimin financiar të tyre.

### **Menjëherë**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti pretendon se është bërë njoftimi dhe do të bëhet ndalesa për pjesën e palikuiduar të kontratës në rast se nuk e kryen arkëtimin në mënyrë vullnetare. Sektori Juridik do të vijojë pasi të bëhen verifikimet nga grupi i punës dhe nëse nuk arkëtohet vlera sipas rekomandimit të auditit do vijojmë me hapat ligjor.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nuk është ndërmarrë asnjë hap administrativ dhe ligjor për të arkëtuar vlerën e sipërpërmendur. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë për shkeljet me veprimet e bankës të vitit 2022, të marrë masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës totale 2,131,555 lekë, konkretisht:

\*Të arkëtohet vlera 519,722 lekë nga 5 ish-punonjësit e larguar në 2015, për pagesa të paligjshme të pushimeve vjetore të pakryera dhe vjetërsi në punë, të paguar pas 7 viteve pa baze ligjore, sipas urdhër shpenzimit nr. 352 datë 01.04.2022, konkretisht: z. M. S. 105,400 lekë, z. K. R. 117,300 lekë, z. J. T. 61,478 lekë, z. A. H. 56,657 lekë, z. A. G. 178,888 lekë.

\*Të arkëtohet vlera 65,233 lekë kamat vonesa për energjinë elektrike nga financa e bashkisë, për periudhën janar- mars 2022, sipas urdhër shpenzimeve nr. 104, 104, 105 datë 15.04.2022.

\*Të arkëtohet vlera 960,000 lekë shpenzime të paligjshme, për pritje-përcjellje dreka, nga pjesëmarrësit, sipas urdhër shpenzimit nr. 234 datë 16.08.2022 dhe nr. 315 date 10.11.2022,

\*Te arkëtohet ose ti zbritet vlera 26,000 lekë A sh.a, për periudhën Janar- Qershor 2022, pasi janë likuiduar tepër qira banese.

\*Të arkëtohet vlera 560,600 lekë, për likuidim 2 herë t.v.sh, në 4 raste, konkretisht:

- vlera 77,200 lekë, nga OE “Sh –Al” sh.p.k, sipas urdhër shpenzimeve nr. 408 datë 30.12.2022 dhe nr. 281 datë 13.10.2022.

- vlera 131,400 lekë, nga BOE “K. B + V”, sipas urdhër shpenzimit nr. 203 dhe datë 21.07.2022 dhe nr. 258 datë 21.09.2022.

- vlera 120,000 lekë, nga OE “4-M” sh.p.k, sipas urdhër shpenzimit nr. 205 datë 01.08.2022,

- vlera 130,000 lekë, nga OE “N”, sipas urdhër shpenzimit nr. 228 datë 12.08.2022.

**Menjëherë**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti pretendon se është pothuajse e pamundur arkëtimi i vlerave të mësipërme. Për sa i përket arkëtimin të vlerës 560,000 lekë, subjekti pretendon se do të punohet në vazhdimësi për arkëtimin e kësaj vlere.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të marrë masat për të kryer verifikimet e duhura lidhur me vonesat e konstatuara nga grupi i auditimit gjatë zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt “Rikonstruksion i 5 (pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cernikë, Tropojë”, si rezultat i amendimeve të cilësuar nga grupi i auditimit, me mangësi ligjore, dhe nëse rezultojnë të pa bazuara në ligjet dhe rregullat në fuqi, atëherë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 4,904,021 lekë, nga BOE “F” sh.p.k & “4A-M” sh.p.k & “V” sh.p.k, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratë.

**Menjëherë**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti pretendon se mbi këtë rekomandim po punohet.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se ky rekomandim rezulton të jetë në proces zbatimi.

**4.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 60,000 lekë, nga BOE “F” sh.p.k & “4-M” sh.p.k, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer.

**Menjëherë**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion për të vërtetuar ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

**5.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës

384,000 lekë, nga BOE “F” sh.p.k & “4-M” sh.p.k & “V” sh.p.k, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer.

**Menjëherë**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacion për të vërtetuar ecurinë e zbatimit të këtij rekomandimi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

#### **D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë për qiratë e pa likujduara që lidhen me përdorimin e aseteve të saj, të marrë masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë dhe administrativë, për arkëtimin e vlerës totale 3,835,358 lekë, nga 15 subjektet, si më sipër, për detyrime kontraktore të pa likujduara, nga përdorimi i aseteve të Bashkisë Tropojë. Gjithashtu të kryhet inventarizimi i të gjitha dosjeve të kontratave të qirave, si dhe të plotësohen me dokumentacionin e konstatuar në mungesë.

**Menjëherë**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti pretendon se është kryer inventarizimi i dosjeve të kontratave të qerave, si dhe gjithë dokumentacioni që pretendohet që mungon është hartuar dhe dërguar për veprime Sektorit të Tatim Taksave.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacioni të vënë në dispozicion u konstatua se nuk është kryer inventarizimi i dosjeve të kontratave të qirave dhe se dokumentacioni i këtyre dosjeve ka mungesa. Për sa i përket arkëtimit të vlerës prej 3,835,358 lekë, nga verifikimi i të dhënave nga sistemi bankar, u nga shlyerja e detyrimeve financiare ka mbetur një vlerë e pa likuiduar prej 2,376,211 lekë, Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

**2.1.Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat, të ndjekin të gjitha hapat ligjorë dhe administrativë, me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtime të pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 1,550,000 lekë.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**Përgjigjja e subjektit:** Po punohet për arkëtimin e vlerës së plotë të gjobave.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nga verifikimi i dokumentacioni të ënë në dispozicion nga IMTV Bashkia Tropojë, u konstatua se janë nga vlera 1,555,000 lekë janë shlyer 1,450,000 lekë. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë pjesërisht i zbatuar.

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të marrë masat për hedhjen e Shtresës së asfaltbetonit, sa më shpejt, me qëllim, shmangien e kthimit të investimit me vlerë 129,181,200 lekë, në një investim me pasoja negative financiare në të ardhmen, në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, eficientës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

**Menjëherë**

**Përgjigjja e subjektit:** Subjekti pretendon se do të merren masa për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Komenti i grupit të auditimit:** Nuk u vu në dispozicion asnjë dokumentacion që të provojë marrjen e masave. Për sa më sipër ky rekomandim rezulton të jetë i pazbatuar.

#### **E. MASA DISIPLINORE.**

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe

të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinore në shërbimin civil”, dhe në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i ndryshuar, si dhe në kontratën e punës, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse:

#### **E. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil,**

Marrjen e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Paralajmërim për largim nga shërbimi civil”, si më poshtë:

1. Z. K. B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor,

- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në disa procedura prokurimi: me objekt “Blerje kamioni”; me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”;

2. Z. K. S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave,

- Për problemet e konstatuara në lidhje me realizimin e ulët të të ardhurave në buxhetin e bashkisë

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2” dhe procedura me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit: me objekt “Blerje kamioni”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”;

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk është dhënë masë disiplinore.

4. Z. M. K, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë

- Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion thertorja Shudenicë + Ndërtim i tregut të bagëtime”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk është dhënë masë disiplinore

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

5. Znj. F. D, me detyrë specialiste në Sektorin e Tatim Taksave,

- Në cilësinë e antarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

6. Znj. E. D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit e Financës.

- Për problemet e konstatuara në lidhje me aktivitetin ekonomik financiar:

- Mos shlyerjen në kohën e duhur të faturave të pa likuiduara prej 86 milion lekë, si dhe detyrimeve të planifikuara të vitit 2022 për detyrimet prapambetura, detyrime të cilat i kanë krijuar Bashkisë Tropojë vështirësi financiare. Për shkelje me veprimet e bankës për vitin 2022 në vlerën totale 2,131,555 lekë, duke kryer likuidime të pa argumentuara, si dhe për 2 raste, lejimin e shkeljeve teknike në inventarizimin dhe në nxjerrjet jashtë përdorimit.

- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

7. Znj. Sh. Gj, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndhmës Ekonomike,  
 - Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.
8. Znj. S M, me detyrë specialiste në Sektorin e Pyjeve,  
 - Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në disa procedura prokurimi: me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë - Lekurtaj”;  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
9. Znj. E. H, me detyrë specialiste në Sektorin e Pyjeve,  
 - Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
10. Znj. A. M, me detyrë specialiste Sektori i Buxhetit dhe Financës,  
 - Për problemet e konstatuara në lidhje me aktivitetin ekonomik financiar:  
 - Për mungesë dokumentacioni justifikues për dhënien e ndihmave të menjëhershme nga fondi rezervë, për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, si dhe emërtim dhe për shkelje në procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit materialeve  
 - Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion thertorja Shudenicë + Ndërtim i tregut të bagëtive”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
11. Znj. M Gj, me detyrë specialiste Sektori i Pronave dhe Kadastrës  
 - Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurpën e prokurimi me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”;  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
12. Znj. J. Gj, me detyrë specialiste Sektori Buxhet Financë  
 - Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
13. Znj. A S specialiste kontabiliteti (Hartuese bilancit 2022), për shkeljet e mëposhtme:  
 - Per disa mangesi në mbajtjen e dokumentacionit te kontabilitetit, perkatesisht: mungesa e partitarëve analitik, ditari i veprimeve të ndryshme dhe libri i madh ose centralizatori.  
 - Për mos ndjekjen e të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e vlerës 44,710,681 lekë të llogarisë 468 “detyrime të ndryshme”, debitorë të taksave dhe qirave asetëve si dhe detyrimet e lëna nga KLSH dhe detyrime e tjera të prapambetura,  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
14. Znj. A. H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike dhe Apelimit Tatimor,  
 - Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

15. Znj. J. Q, me detyrë specialist jurist Sektori Juridik dhe Apelimit Tatimor,

- Per mos ndjekjen e të gjithë hapave ligjore dhe për mos ndërprerjen e kontratave, ndaj subjekteve që nuk kanë respektuar detyrimet dhe kushtet e kontratave për asetet e bashkisë të marra me qira, për pasojë krijimin e vlerës totale debitore 3,835,358 lekë nga 15 subjekte, Për mangësi dokumentare në dosjet e qirave të aseteve dhe mos inventarizimin e tyre.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

16. Znj. E. K (M), me detyrë specialiste në Zyrën e Integritimit European.

- Në cilësinë e anëtarit të Specifikemeve Teknike, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kamioni”, pasi specifikimet teknike nuk janë të plota dhe të argumentuara.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

E. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, si dhe kontratën e punës respektive, marrjen e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

I - Ulje në detyrë dhe kalimin në një pozicion pune të përshtatshëm me kualifikimin dhe nivelin arsimor, për:

1. Z. A. K, me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor (I Autorizuar),

- Për shkelje dhe parregullsi të konstatuara në 6 procedura prokurimi, pasi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës, si dhe janë shpallur fitues OE që nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

2. Znj. Z. I me detyrë Zv/Kryetar Bashkie dhe ish Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, si dhe në cilësinë e personit përgjegjës në fushën e prokurimeve,

- Për shkelje dhe parregullsi të konstatuara në procedurat e prokurimit, copëzimi i fondeve (ndarja e vlerës së kontratës) dhe për pasojë devijimi nga aplikimi i LPP-së për shkak të mosaplikimit të rregullt të llojit të procedurës, që përbën një risk eventual për prokurimin e objektit me një vlerë më të lartë.

- Për të meta e mangësi në hartimin e projekt buxhetit në drejtim të numrit të lartë prej 361 veta të organikës Bashkisë Tropojë, për efekt të mos justifikimit të ngarkesës dhe punës së tyre me dokumente e programe pune, çka ka ndikuar negativisht në buxhetin 2022.

- Për mos përmirësimin e politikave sociale-ekonomike, për të zbutur papunësinë dhe varfërinë, pasi ndihma sociale për 2022 zënë peshën kryesore prej 386 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsej ose 47 %, dhe ka tendence në rritje, në vend që të ndodhte e kundërta si rezultat i shpërnguljes banoreve brenda dhe jashtë vendit.

- Për lejimin e krijimit të vështirësisë financiare, sipas nenit 56 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, që do të rëndojë në fondet e viteve në vazhdim. Për mos shlyerjen e detyrimeve të planifikuara të vitit 2022 për detyrimet prapambetura në masën 30% ose në vlerë absolute 23 milion lekë, pasi janë likuiduar vetëm 6,2 milion lekë nga 23 milion që duhej.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

## **II – Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për këta punonjës:**

1. Z. P. R, me detyrë përgjegjës tek Bordi i Kullimit

- Në cilësinë e antarit të Specifikemeve Teknike, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kamioni”, pasi specifikimet teknike nuk janë të plota dhe të argumentuara. Gjithashtu në cilësinë e antarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara



në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës. Pjesmarrja në këto dy komisione për të njëjtën procedurë prokurimi, ka shkaktuar konflikt interesi.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

2. Z. B. B, me detyrë Teknik ndërtimi në Drejtorinë e Shërbimeve Publike

- Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj” dhe procedura me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

### **E. 3. Për punonjësit e larguar:**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e përmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre, si më poshtë:

Z. A. Z, me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Shërbimeve Publike,

- Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

Znj. Sh. Gj, me detyrë ish-specialiste Sektori i Emergjencave Civile,

- Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

Znj. E N, me detyrë ish-specialiste Sektori Juridik,

- Në cilësinë e antarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt”, “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj

Z. E. S, me detyrë ish-specialist Sektori Juridik,

- Në cilësinë e antarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj”.

### **III. 2.6.1. Të ndryshme të dala gjatë auditimit (Ankesa).**

#### **Në lidhje me ankesën e administruar në KLSH me nr. 1133 prot., datë 19.09.2024 depozituar nga z. R I.**

Nga ankuesi pretendohet se Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 290, datë 09.09.2024, “Për transferimin e Përkohshëm të z. R. R. I”, me objekt transferimin nga Drejtor në Drejtorinë e Turizimit, Shërbimeve Publike dhe Transportit” për të mbuluar detyrën e punonjësit të ndihmës ekonomike, paaftësisë dhe invaliditeti në Njësinë Administrative Lekbibaj, vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” (ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 dhe ligjin 41/2017), VKM nr. 125, datë 17.12.2016 “Për Transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësit civil” si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

-Me shkresën nr. 514, prot., datë 11.09.2024, z. I. i është drejtuar Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, me objekt Ankimimin e Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë. Me shkresën me 514/2, Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil i ka kthyer përgjigje ankesës së z. I, duke e cilësuar Urdhrin e Transferimit jo si një akt të mirëfilltë transferimi, por si një delegim në një detyrë shtesë të nëpunësit, për shkak të nevojave të institucionit. Komisioneri ka vënë në dukje se shkresa me Urdhrin e Transferimit nuk ka përcaktuar afatin kohor, se deri kur nëpunësi është ngarkuar të kryejë detyrat si “Punonjës i Ndihmës Ekonomike, Paaftësisë dhe Invaliditetit”, në njësinë administrative Lekbibaj, Bashkia Tropojë”.

1) Z. I. pretendon se Urdhri i titullarit të Bashkisë Tropojë ka dalë në po të njëjtën ditë kur Prokuroria e Posacme ka dërguar për ekzekutim Vendimin nr. 112 datë 06.09.2024 të Gjykatës

së Posacme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ku është caktuar masa e sigurimin personal me karakter shtrengues “Arrest në shtëpi” për shtetasin R. B me detyrë Kryetar i Bashkisë Tropojë. Për sa më sipër ai pretendon se ky urdhër i Kryetarit të Bashkisë Tropojë ka dalë në kushtet e pavlefshmërisë sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

2) Z. I. pretendon se Urdhri për Transferimin vjen në kundërshtim me Ligjin nr.152/2023, neni 48, pika 1, sepse pozicioni të cilën ai do të mbulojë sipas Urdhrit të Kryetarit nuk i përket së njëjtës kategori me pozicionin e Drejtorit sipas strukturës organizative të Bashkisë Tropojë.

3) Z. I pretendon se Bashkia Tropojë nuk ka likuiduar detyrimet financiare në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe vendimit të formës së prere të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, sipas të cilës Bashkia Tropojë detyrohet të rikthejë z. I. në vendin dhe në pozicionin Drejtor në Drejtorinë e Turizimit, Shërbimeve Publike dhe Transportit me pagë dhe pozicion të njëjtë ose të ngjashme në këtë pozicion, si dhe t'i paguajë pagat.

### **I. Nga ana procedurale, mbi veprimet e Kryetarit të Bashkisë Tropojë:**

**I.1** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Tropojë (kopje e procesverbalit të ekzekutimit të vendimit penal të Gjykatës), u konstatua se veprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, për ekzekutimin e Vendimin nr. 112 datë 06.09.2024 e Gjykatës së Posacme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë kryer më datë 09.09.2024, në orën 16:30, pas përfundimit të orarit zyrtar të punës në Bashkinë Tropojë. Duke qenë se ekzekutimi i masës është bërë në mbarim të orarit zyrtar të punës, Urdhri për Transferim nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tropojë, z. R. B, arsyetohet të jetë kryer në cdo moment përgjatë orarit zyrtar të punës në Bashkinë Tropojë. Për rrjedhojë nuk jemi në kushtet e Paligjshmërisë së Aktit Administrativ sipas nenin 9 të Kodit të Procedurave Administrative, sikurse pretendon ankuesi.

**I.2** Me Urdhrin nr. 290, datë 09.09.2024, Kryetari i Bashkisë Tropojë ka urdhëruar transferimin e z. I nga pozicioni i punës në si Drejtor i Drejtorisë së Turizimit, Shërbimeve Publike dhe Transportit”, në mbulimin e detyrës të Punonjësit të Ndhmës Ekonomike, Paaftësisë dhe dhe Invaliditetit, duke mos i ndryshuar pagën dhe marrëdhënien financiare. Në këtë rast kemi të bëjmë me delegimin e një detyre për interesin dhe nevojat e institucionit, në kushtet kur punonjësi mban të njëjtë kategori page.

-Për sa më sipër, Urdhri për Transferim i Kryetarit të Bashkisë Tropojë nuk bie në kundërshtim me Ligjin për Nëpunësin Civil.

-Nga shqyrtimi i akteve të përmendura më sipër u kostatua se në Urdhrin për Transferim nuk është përcaktuar afati kohor i këtij transferimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, neni 49, pika 1, shkronja a.

**I.3.** Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se Bashkia Tropojë nuk ka shlyer detyrimet financiare të ngarkuara nga Gjykata përkundrejt z. R. I, por do ta përfshijë grafikun e shlyerjes së detyrimev për vitin 2025, duke qenë se janë parashikuar fondet për shlyerjen e detyrimeve për vitin 2024 dhe Bashkia nuk ka mundësi për shlyerjen e detyrimit në vitin ushtrimor 2024.

-Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, neni 49, pika 1, shkronja a.

-Për sa më sipër mban përgjegjësi, kryetari i Bashkisë Tropojë, z. R. B.

Nga ana e subjektit nuk janë paraqitur observime. Sa më sipër në mos përgjigje në afatet ligjore, Projekt Raporti i Auditimit, konsiderohet i mirëqenë dhe u vijua me hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2023, rezulton se është realizuar në masën 94.5%, ku nga vlera e parashikuar me gjithë shtesa prej 912,151 mijë lekë është realizuar vlera 862,316 mijë lekë. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një vitit më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet.

Investimet është zëri që ka përqindjen më të ulët, ku nga vlera e parashikuar prej 183,468 mijë lekë është realizuar në masën 148,075 mijë lekë ose 80.7 %. Kjo tregon se nga Bashkia Tropojë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, pa u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk ndryshohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Faturat e palikujduara në fund të vitit 2023, konstatohet se janë në vlerën 48,703 mijë lekë, vlerë e cila në raport me totalin e shpenzimeve të vitit prej 862,315 mijë lekë, zë 5.6 %, gjë që tregon se kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare.

Këto veprime janë në kundërshtim me germën (a) të nenin 5, të ligjit nr. 68/2017, i ndryshuar, pikën 24 dhe 25 të nenit 3, nenin 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar, si dhe pikat 8 dhe pika 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

**1.2. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të ndryshojë plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

##### *Përgjatë vitit buxhetor 2025 dhe në vijim*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2023-2025, u konstatua se:

- Nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Tropojë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017, i ndryshuar, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;
- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS-ja);
- Nuk janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore”, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Tropojë,

në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (si dhe mungon një analizë e detajuar);

Tavanet përgatitore dhe tavanet përfundimtare të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve.

- Në buxhetin e të vitit 2023, nuk janë planifikuar investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”.

- Gjithashtu konstatohet se nuk janë zbatuar detyrimet ligjore për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23; pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017, i ndryshuar; pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të kryhen konsultimet me komunitetin dhe grupet e interesit.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore dhe Përfundimtare të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

-Planifikimin e fondeve për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Tropojë.

*Gjatë planifikimit të PBA buxhetit vjetor pasardhës*

**2.2. Rekomandimi:** Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen raportet 4-mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, me të cilat të njihet këshilli bashkiak dhe njëkohësisht të dërgohen edhe në Ministrinë e Financave.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se vlera e detyrimeve mbi vendimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2023 nuk është pasqyruar e saktë në Raportin e vetëvlerësimit financiar dërguar në MF. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se detyrimet mbi vendimet gjyqësore të raportuara në MF janë në vlerën **1,384,443 lekë**. Nga përlllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2023, që duhej të raportohet në MF duhet të ishte në vlerën **33,090,778 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta.

*Për çdo vit buxhetor*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është në vlerën 3,452,393 lekë, si rrjedhojë e mospërputhjes midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare dhe vlerës së inventarizimit. Konkretisht, “Mjete transporti”, në pasqyrën F7 për vitin 2023 është në vlerën 67,084,391 lekë (kosto historike), ndërkohë sipas

inventaritet fizik rezultojn vlera 63,631,998 lekë, ose 3,452,393 lekë më pak. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në kreu-n 3, pika 3.1, paragrafi 30 të Udhëzimit nr. 8, datë 9.03.2018, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 45-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë 215 “Mjete transporti”, duke sistemuar diferencat e evidentuara në vitin 2023.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 4,960,000 lekë. Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Klubi i Futbollit Valbona” me NIPT M09230601A, rezultojn se Bashkia Tropojë zotëron 100% të aksioneve me vlerë në total 3,500,000 lekë.

Veç sa më sipër, Bashkia Tropojë zotëron 16.6% të aksioneve të Shoqërisë Aksionare “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës SH.A” me NIPT M28322201I vlerë në total 1,460,000 lekë.

Gjithashtu, Bashkia Tropojë vazhdon të zotërojë aksione në SH.A “K F V”, në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 105/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”. Urdhri i Ministrisë së MFE nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”; kreu 3.1, pika 31, shkronja “b” në Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 45-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 22,449,624 lekë, për garanci të cilave i ka kaluar afati dhe duhet t’u kthehen subjekteve përkatëse. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 45-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak për vlerën 1,522,723 lekë, vlera e objektit “Rikonstruksion i sallës së muzeut”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “b”, pikën 2, Klasën 2 “Aktivet afatgjata”<sup>11</sup> (përbërja dhe trajtim kontabël) në udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në

<sup>11</sup> Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumenta shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivitet afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

*Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 45-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 212, duke kryer veprimet e nevojshme në debi/kredi të llogarisë nr. 231 dhe llogarisë 101 “Fondet bazë”.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, Troje, Terrene” 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të pasqyrave financiare, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:

-Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj;

-Vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Tropojë dhe ish Komunave, aktualisht Njësi Administrative.

-Vlera prej 34,332,096 lekë të trojeve që janë pajisur me certifikatë pronësie.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 26, 27, 30 në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Kapitullin III, pika 30 në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 45-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, si dhe në vijim Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”, llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak, për vlerën 5,021,709 lekë, për fatura të mbërritura, të palikujduara në fund të vitit 2023 dhe të pa regjistruara në pasqyrat financiare.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 - “*funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4*”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 45-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë, të marrë masat e nevojshme, që të kryej vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

*Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor në vijim*

**10. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Tropojë rezultoi se për periudhën objekt auditimi në vitet 2022 - 2023 nuk janë certifikuar prona dhe objekte, nga 4726 prona me VKM vetëm 43 asete janë certifikuar para vitit 2021, nuk disponohen të dhëna dhe regjistra me gjithë të dhënat me modalitetet e duhura mbi pronat dhe nuk janë vlersuar dhe kontabilizuar asetet dhe pronat që ka në juriduksionin e saj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme*”, kreu (VI) “*Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme*” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe kreu (II), pika (16). *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 58-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**10.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Dejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorrit dhe Sektorin e Pronave dhe Hartografisë të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin dhe inventarizimin e pronave dhe të ndjekë procedurat për të certifikuar në ASHK Kukës pronat dhe asetet e saj.

**11. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Tropojë rezultoi se sipas inventarizimit të pronave publike të kostatuara në vitin 2015 nga punonjësit e urbanistikës, rezultojnë troje të zëna në kundërshtim me ligjin dhe nuk është marrë as një masë, nuk ka as një veprim për të administruar dhe manaxhuar këto asetë të bashkisë, si dhe nuk ka dokument argumentues ligjor të paraqitura pranë institucioneve përkatëse për ndjekjen procedurave ligjore me institucionet përkatëse për asetet e pronave të zaptuara nga qytetarët.

Konkretisht: Këndi i lojrave për fëmijë zona kadastrale 1347, emërtimi-trruall, me sipërfaqe 5,883 m<sup>2</sup>; Çerdhe e fëmijve Dardania emërtimi – trruall + objekt, sipërfaqja 464 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 400 m<sup>2</sup>; dhomë zhveshje e sportit zona kadastrale 1347, sipërfaqja 116 m<sup>2</sup>; fusha futbollit zona kadastrale 1347, sipërfaqja 8,793 m<sup>2</sup>; Terrene sportive sipërfaqe 8,793 m<sup>2</sup> zona kadastrale 1347, Klubi Sportiv Valbona 41.5 m<sup>2</sup> ndërtesë 41 m<sup>2</sup> zona kadastrale 1347, Fushë futbollit, 8,753 m<sup>2</sup> zona kadastrale 1347, nr. pasurie 5/17, zënë nga private; Zyrat e klubit Valbona 20 m<sup>2</sup> zona kadastrale 1347, nr. pasurie 5/15 prona sipas VKM-së nr. 397 datë 01.06.2011, i kanë kaluar në administrim të Bashkisë Tropojë.

Mosveprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 58-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin Juridik të marrin të gjitha masat dhe të ndjekin procedurat ligjore për të administruar dhe verifikuar asetet publike të zëna në kundërshtim me ligjin nga qytetarët dhe të bashkëpunojë me të gjitha institucionet ligjzbatuese deri në regjistrimin me certifikatë pronësie, për vënien e tyre në shërbim të publikut.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të dhënes me qira të pasurive të paluajtshme të Bashkisë Tropojë, u konstatua se kontratat e lidhura kanë mungesë dokumentacioni, si certifikatat e pronësisë si dhe nuk janë të bashkangjitura hartat treguese të sipërfaqes së dhënë me qira, nuk ka vërtetim që janë shlyer detyrimet tatimore etj. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu II, gërma “ë” me ndryshime. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 58-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë të marrë të gjitha masat për të plotësuar dokumentacionin përkatës të munguar në dosjet e kontratave të dhënies me qira të pasurive të paluajtshme.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se nuk është bërë mjaftueshëm në lidhje me:

-Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë Komisioneve e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Me krijimin e Drejtorisë së Pyjeve dhe inkorporimit të saj në Strukturën e vitit 2023, nuk është përditësuar Rregullorja e institucionit, duke mos përfshirë në të objektivat, detyrat dhe kompetencat e kësaj Drejtorie në funksionimin e aparatit administrativ të Bashkisë Tropojë. Rregullorja e brendshme nuk është përditësuar, duke mos caktuar detyrat dhe përgjegjësitë e cdo sektori. Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut. Bashkia Tropojë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Në Bashkinë Tropojë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij. Titullari nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me ndryshimet në rregullore. Sektori i Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj. Nuk është hartuar dhe miratuar

në dokument të veçantë deklarata e misionit, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme. Nuk ka dokumentacion provues ku të jetë dokumentuar takimet e GMS të realizuar gjatë vitit 2023. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9; Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, 12 dhe 27, neni 21, pika 2, neni 16, pika 2; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3., Kreu II paragrafi. 2.2.6; kap 5; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 121 e 122; Udhëzimi i MFE nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike”, pika 3.2.2 (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 12-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë, të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse si dhe të marrë masa të menjëhershme për:

-Hartimin dhe miratimin e Rregullores së brendshme të përditësuar sipas struktues organizative të miratuar për të rritur performancën e punonjësve, si dhe përgjegjëshmërinë dhe përgjegjësinë e tyre në shërbim të qytetarëve.

-Të organizohen trajnime të vazhdueshme të personelit

-Të dokumentohet zhvillimi i mbledhjeve të GMS-së, për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Të hartohet e miratohet “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, si dhe të funksionojë sistemi i raportimit për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Të hartohet dhe miratohet gjurma e auditimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i përbërjes dhe veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, u konstatua se;

Bashkia Tropojë e ka përfshirë në Stukturën Organike Njësine e Auditit të Brendshëm, por nga verifikimi i dosjeve të personelit dhe struktura organizative, u konstatua se kjo strukturë është jo funksionale dhe nuk ka punonjës që ushtrojnë funksionin e audituesit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga informacioni i marrë nga pyetësorët drejtuar subjektit u konstatua se nuk është lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar neni 10 dhe Ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 49. VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, pika 1; (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1.2, faqe 17-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për organizimin dhe funksionimin e strukturës së Njësive të Auditimit të Brendshëm si pjesë e strukturës organizative të Bashkisë Tropojë, duke patur në konsideratë rekrutimin e punonjësve të certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga trajtimi i ankesës së z. R. I. me shkresën nr. 1133 prot., datë 19.09.2024 ku pretendohet se Urdhri i Kryetarit të Bashkisë, nr. 290, datë 09.09.2024, “Për transferimin e Përkohshëm të z. R. R. I”, vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” (i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 dhe ligjin 41/2017), VKM nr. 125, datë 17.12.2016 “Për Transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësit civil” si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u konstatua:

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Tropojë (kopje e procesverbalit të ekzekutimit të vendimit penal të Gjykatës), u konstatua se veprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, për ekzekutimin e Vendimit nr. 112 datë 06.09.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë kryer



më date 09.09.2024, në orën 16:30, pas përfundimit të orarit zyrtar të punës në Bashkinë Tropojë. Duke qenë se ekzekutimi i masës është bërë në mbarim të orarit zyrtar të punës, Urdhri për Transferim nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tropojë, z. R. B, arsyetohet të jetë kryer në çdo moment përgjatë orarit zyrtar të punës në Bashkinë Tropojë.

Me Urdhrin me nr. 290, datë 09.09.2024, Kryetari i Bashkisë Tropojë ka urdhëruar transferimin e z. I. nga pozicioni i punës si Drejtor i Drejtorisë së Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Transportit”, në mbulimin e detyrës së Punonjësit të Ndihmës Ekonomike, Paaftësisë dhe Invaliditetit, duke mos i ndryshuar pagën dhe marrëdhënien financiare. Në këtë rast, arrihet në konkluzionin e delegimit në një detyrë për interesin dhe nevojat e institucionit, në kushtet kur punonjësi mban të njëjtën kategori page.

-Për sa më sipër, Urdhri për Transferim i Kryetarit të Bashkisë Tropojë nuk bie në kundërshtim me Ligjin për Nëpunësin Civil.

-Nga shqyrtimi i akteve të përmendura më sipër u kostatua se në Urdhrin për Transferim nuk është përcaktuar afati kohor i këtij transferimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, neni 49, pika 1, shkronja “a”.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se Bashkia Tropojë nuk ka shlyer detyrimet financiare të ngarkuar nga Gjykata përkundrejt z. R. I, duke qenë se janë përcaktuar fondet për shlyerjen e detyrimeve për vitin 2024, por do ta përfshijë në grafikun e shlyerjes së detyrimeve për vitin 2025. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, neni 49, pika 1, shkronja “a”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.6, faqe 81-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë të ndryshoj Urdhrin për Transferim nr. 290, datë 09.09.2024, duke përcaktuar afatin kohor të transferimit, me qëllim arritjen e performancës maksimale nga nëpunësit e bashkisë në shërbim të qytetarëve si dhe të shmangë raste të tilla në të ardhmen.

*Menjëherë*

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën e KLSH nr. 518/10 prot., datë 17.11.2023, rezulton se: Bashkia Tropojë nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor për planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja “j”.

-Bashkia Tropojë, me shkresën nr. 2751/100, datë 22.07.2024 ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve jashtë afatit 6 - mujor në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

-Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, rezulton si vijon:

Nga 22 Masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht, është zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 11 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 7 masa.

Bazuar në sa më sipër, rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.5, faqe 65-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**16.1. Rekomandimi:** Për përmirësimin e gjendjes, **rikërkojmë** që kjo problematikë të shqyrtohet, analizohet nga Këshilli Bashkiak duke nxjerrë përgjegjësi konkrete për moszbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Gjithashtu rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1. Rekomandimi:** Nga ana e Bashkisë Tropojë, të merren masat për zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, duke hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, në përputhje me strukturën organizative; organizimin e Sistemin e

Kontrollit të Brendshëm; hartimin e strategjisë së riskut, regjistrin e riskut, si dhe gjurmën e auditimit.

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë të marrë masa për organizimin e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, dhe të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njesisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë publike

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Tropojë të merren masa:

- Për të vendosur një raport të drejtë midis numrit të punësuarve me ngarkesën e punës, sipas drejtorive, sektorëve përkatës, me qëllim arritjen e objektivave dhe kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve.

- Krijimin e kushteve për nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale me qëllim zbutjen e papunësinë.

- Të rishikojë emërtesën dhe pagesën për 9 specialistë të gjendjes civile, të cilët nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”, sipas përcaktimeve ligjore.

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë të marrë masa për kontrollin e gjendjes teknike të disa mjeteve të rënda nëse janë rentabël ose jo, pasi paraqesin jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe kanë mbushur kuotën e plotë të amortizimit referuar normave ligjore të përcaktuara, për të bërë mundur uljen e shpenzimeve të karburantit dhe pjesëve të këmbimit, për mjetet:

1. Autobot benz 47 - vjeçar viti i prodhimit 1976.

2. Kamioni benz 40 - vjeçar, viti i prodhimit 1983.

3. Kamion benz 37 - vjeçar, viti i prodhimit 1986.

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Tropojë të marrë masa, për mbajtjen e partitarëve analitik, centralizatorit dhe librit veprimeve të ndryshme, sipas kërkesave ligjore, si dhe të marrë masa për uljen e vlerës së llogaritë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila rezultoi në rritur gjatë vitit 2022.

**8.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë të marrë masa që në vijimësi, për çdo rast për ndihma të menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, përpara se të procedojë me dhënien e tyre, të verifikojë plotësimin e dokumentacionit përkatës, duke siguruar gjendjen e dokumentacionit justifikues, në përputhje me kërkesat ligjore.

**15.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë, të marrë masa që në të ardhmen, në rastet e delegimit të kompetencave tek vartësit e tij, të përcaktojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e të deleguarit konform ligjeve dhe rregullave në fuqi, duke kryer dhe njoftimet e duhura në transparencë për publikun por dhe duke monitoruar njëkohësisht vendimet e marra nga i deleguari.

**15.2. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, Drejtori i Kabinetit, Sektori Juridik, të marrin masa që në të ardhmen, përpara konceptimit të shkresave për delegimin e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë tek cilido nga vartësit e tij, të argumentohet dhe dokumentohet arsyeja e delegimit të kompetencave duke respektuar njëkohësisht ligjin për formën dhe përmbajtjen e dokumentit të delegimit të kompetencave por dhe për afatin e delegimit.

**16.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, të miratohen gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të Bashkisë, me qëllim dokumentimin e të gjitha veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

**19.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces si më poshtë:

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre

detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartojë strategjinë e riskut, regjistrin e riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

**1.2. Rekomandimi:** Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme, rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët janë trajtuar si punonjës me “Kodin e Punës”, ku në fakt pozicioni i punës trajtohet sipas ligjit të “Nëpunësit Civil”.

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Tropojë. Në përzgjedhjen e punonjësve të kihet në konsideratë fakti se audituesi i brendshëm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e “Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

**5.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 42,876,907 lekë, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2021, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Tropojë.

**6.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrejë grup pune me specialistë të fushës për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) të cilat janë pasuri e bashkisë, duke evidentuar statusin dhe gjendjen e tyre faktike në teren.

**6.2.Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë të plotësojë regjistrin e të gjitha aktiveve sipas llogarive përkatëse, i cili të jetë elektronikë dhe shkresor dhe të marrë masa për regjistrimin e pronave në ASHK dhe kontabilitet. Për çdo vit, të kryhet inventarizimi i këtyre aktiveve.

**7.1. Rekomandimi:** Nëpunësit zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësijellës Kanalizime Tropojë ShA me vlerë 764,579,800 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të marrë masa për plotësimin e listës së kreditorëve me të gjithë elementët e duhur, si objektin e prokurimit, numrin e faturës, datën e faturës, etj. elementë të cilët identifikojnë plotësisht llojin, kohën e lindjes së detyrimit, arsyen e detyrimit që Bashkia Tropojë ka ndaj të tretëve.

**10.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon;

Për 14 masa organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi si dhe për 13 masa organizative të pa zbatuara.

Për 3 masa shpërblim dëmi me vlerë 9,587,836 lekë

Për 9 persona masa administrative me gjobë në vlerën 1,020,000 lekë sipas vendimit të APP.

## **B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TËARDHURA TË MUNGUARA)**

**1.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në mënyrë progresive në vlerën 43,951,182 lekë. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim për vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të merren masa për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit (ASHK) dhe Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRVP), kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet neni 93 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë 1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

**2.1. Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Tropojë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 4,600,000 lekë nga 5 subjektet debitor për taksën e lëshimit të licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, sipas listës në aneksin nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**3.1. Rekomandimi:** Zyra Juridike në hartimin e kontratave dhe shtesave të tyre me operatorë të ndryshëm në bashkëpunim dhe me Sektorin Pyjor i cili përpilon raportin teknik dhe me Drejtorin e Financës, të arkëtojnë detyrimin e kontraktuar në vlerën 2,201,048 lekë, aneksit nr. 10 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

**3.2. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë të përdorë të gjitha mekanizmat ligjorë, për lidhjen e 22 kontratave me operatorët për nxjerrje dhe shfrytëzim të mineralit të kromit, të cilët ushtojnë aktivitet prej disa vitesh në asetet e Bashkisë Tropojë.

**4.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Tropojë të merren masa administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 4,059,163 lekë, gjë që ka sjell të ardhura të munguara në Bashkinë Tropojë për subjektet që kanë lidhur kontrata qiraje sipas aneksit nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit

**5.1. Rekomandimi:** Inspektorati Vendor i Mbrojtës Territorit (IVMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Tropojë, të kërkohe në Gjykatë, shndërrimi i 14 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe arkëtimi i vlerës 1,650,000 lekë, që kanë kryer ndërtim pa leje në territorin e Bashkisë Tropojë.

## **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Tropojë të merren masa, të ndiqen të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej 186,810 lekë pa t.v.sh nga BOE “N” & “R. C” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 866/2 Prot., datë 03.03.2022, me objekt “Rikualifikim urban “Lagja Partizani” Blloku 1 & 2, Bajram Curri”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Gjithashtu të kryhet verifikimi në objekt me grup pune, në prezencë të mbikëqyrësit dhe subjektit kontraktues, lidhur me numërin e pushtave të shiut të vendosura në objekt, dhe në varësi të diferencave me ato të situacionuara, të procedohet me likuidimin financiar të tyre.

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë për shkeljet me veprimet e bankës të vitit 2022, të marrë masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës totale 2,131,555 lekë, konkretisht:

\*Të arkëtohet vlera 519,722 lekë nga 5 ish-punonjësit e larguar në 2015, për pagesa të paligjshme të pushimeve vjetore të pakryera dhe vjetërsi në punë, të paguar pas 7 viteve pa bazë ligjore, sipas urdhër shpenzimit nr. 352 datë 01.04.2022, konkretisht: M. S 105,400 lekë, K. R 117,300 lekë, J. T 61,478 lekë, A. H 56,657 lekë, A. G 178,888 lekë.

\*Të arkëtohet vlera 65,233 lekë kamat vonesa për energjinë elektrike nga financa e bashkisë, për periudhën janar- mars 2022, sipas urdhër shpenzimeve nr. 104, 104, 105 datë 15.04.2022.

\*Të arkëtohet vlera 960,000 lekë shpenzime të paligjshme, për pritje-përcjellje dreka, nga pjesëmarrësit, sipas urdhër shpenzimit nr. 234 datë 16.08.2022 dhe nr. 315 datë 10.11.2022,  
\*Të arkëtohet ose ti zbritet vlera 26,000 lekë A sh.a, për periudhën Janar- Qershor 2022, pasi janë likuiduar tepër qira banesë.

\*Të arkëtohet vlera 560,600 lekë, për likuidim 2 herë t.v.sh, në 4 raste, konkretisht:

- vlera 77,200 lekë, nga OE “Sh –Al” sh.p.k, sipas urdhër shpenzimeve nr. 408 datë 30.12.2022 dhe nr. 281 datë 13.10.2022

- vlera 131,400 lekë, nga BOE “K. B + V”, sipas urdhër shpenzimit nr. 203 dhe datë 21.07.2022 dhe nr. 258 datë 21.09.2022.

- vlera 120,000 lekë, nga OE “4-M” sh.p.k, sipas urdhër shpenzimit nr. 205 datë 01.08.2022,

- vlera 130,000 lekë, nga OE “N”, sipas urdhër shpenzimit nr. 228 datë 12.08.2022.

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të marrë masat për të kryer verifikimet e duhura lidhur me vonesat e konstatuara nga grupi i auditimit gjatë zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt “Rikonstruksion i 5 (pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cernikë, Tropojë”, si rezultat i amendimeve të cilësuar nga grupi i auditimit, me mangësi ligjore, dhe nëse rezultojnë të pa bazuara në ligjet dhe rregullat në fuqi, atëherë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 4,904,021 lekë, nga BOE “F” sh.p.k & “4A-M” sh.p.k & “V” sh.p.k, si vlerë që i përket penalitetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratë.

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 60,000 lekë, nga BOE “F” sh.p.k & “4-M” sh.p.k, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer.

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 384,000 lekë, nga BOE “F” sh.p.k & “4-M” sh.p.k & “V” sh.p.k, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer.

#### **D. MASA PËR ELIMININ E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë për qiratë e pa likujduara që lidhen me përdorimin e aseteve të saj, të marrë masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë dhe administrativë, për arkëtimin e vlerës totale 3,835,358 lekë, nga 15 subjektet, si më sipër, për detyrime kontraktore të pa likujduara, nga përdorimi i aseteve të Bashkisë Tropojë. Gjithashtu të kryhet inventarizimi i të gjitha dosjeve të kontratave të qirave, si dhe të plotësohen me dokumentacionin e konstatuar në mungesë.

**2.1. Rekomandimi:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat, të ndjekin të gjitha hapat ligjore dhe administrativë, me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtime të pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 1,550,000 lekë

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Tropojë, të marrë masat për hedhjen e Shtresës së asfaltbetonit, sa më shpejt, me qëllim, shmangien e kthimit të investimit me vlerë 129,181,200 lekë, në një investim me pasoja negative financiare në të ardhmen, në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, eficientës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

#### **E. MASA DISIPLINORE.**

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në

shërbimin civil”, dhe në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i ndryshuar, si dhe në kontratën e punës, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse:

#### **E. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil,**

Marrjen e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Paralajmërim për largim nga shërbimi civil”, si më poshtë:

1. Z. K. B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor,

-Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në disa procedura prokurimi: me objekt “Blerje kamioni”; me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”;

2. Z. K. S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave,

- Për problemet e konstatuara në lidhje me realizimin e ulët të të ardhurave në buxhetin e bashkisë

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2” dhe procedura me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit: me objekt “Blerje kamioni”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”;

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk është dhënë masë disiplinore

4. Z. M. K, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë,

-Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion thertorja Shudenicë + Ndërtim i tregut të bagëtive”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk është dhënë masë disiplinore

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

5. Znj. F. D, me detyrë specialiste në Sektorin e Tatim Taksave,

-Në cilësinë e antarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

-Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

6. Znj. E. D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit e Financës,

- Për problemet e konstatuara në lidhje me aktivitetin ekonomik financiar:

- Mos shlyerjen në kohën e duhur të faturave të pa likuiduara prej 86 milion lekë, si dhe detyrimeve të planifikuara të vitit 2022 për detyrimet prapambetura, detyrime të cilat i kanë krijuar Bashkisë Tropojë vështirësi financiare. Për shkelje me veprimet e bankës për vitin 2022 në vlerën totale 2,131,555 lekë, duke kryer likuidime të pa argumentuara, si dhe për 2 raste, lejimin e shkeljeve teknike në inventarizimin dhe në nxjerrjet jashtë përdorimit

- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

7. Znj. Sh. Gj, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndhmës Ekonomike,  
 - Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.
8. Znj. S. M, me detyrë specialiste në Sektorin e Pyjeve,  
 - Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në disa procedura prokurimi: me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë - Lekurtaj”;  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
9. Znj. E. H, me detyrë specialiste në Sektorin e Pyjeve,  
 - Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
10. Znj. A. M, me detyrë specialiste e Sektorit të Buxhetit dhe Financës,  
 - Për problemet e konstatuara në lidhje me aktivitetin ekonomik financiar:  
 -Për mungesë dokumentacioni justifikues për dhënien e ndihmave të menjëhershme nga fondi rezervë, për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, si dhe emërtim dhe për shkelje në procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit materialeve.  
 -Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion thertorja Shudenicë + Ndërtim i tregut të bagëtimeve”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
11. Znj. M. Gj, me detyrë specialiste e Sektorit të Pronave dhe Kadastrës  
 -Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimi me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë - Lekurtaj”;  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
12. Znj. J. Gj, me detyrë specialist e Sektorit të Buxhetit dhe Financës  
 -Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
13. Znj. A. S specialiste kontabiliteti (Hartuese bilancit 2022), për shkeljet e mëposhtme:  
 -Për disa mangesi në mbajtjen e dokumentacionit të kontabilitetit, perkatesisht: mungesa e partitarëve analitik, ditari i veprimeve të ndryshme dhe libri i madh ose centralizatori.  
 -Për mos ndjekjen e të gjitha hapave ligjore për arkëtimin e vlerës 44,710,681 lekë të llogarisë 468 “detyrime të ndryshme”, debitorë taksave dhe qirave asetëve si dhe detyrimet e lëna nga KLSH dhe detyrime tjera prapambetura,  
 -Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
14. Znj. A. H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike dhe Apelimit Tatimor,  
 -Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

15. Znj. J. Q, me detyrë specialist jurist Sektori Juridik dhe Apelimit Tatimor,

-Për mos ndjekjen e të gjithë hapave ligjore dhe për mos ndërprerjen e kontratave, ndaj subjekteve që nuk kanë respektuar detyrimet dhe kushtet e kontratave për asetet e bashkisë të marra me qira, për pasojë krijimin e vlerës totale debitore 3,835,358 lekë nga 15 subjekte, Për mangësi dokumentare në dosjet e qirave të aseteve dhe mos inventarizimin e tyre,

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

16. Znj. E. K (M), me detyrë specialiste në Zyrën e Integritimit European,

-Në cilësinë e anëtarit të Specifikemeve Teknike, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kamioni”, pasi specifikimet teknike nuk janë të plota dhe të argumentuara.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

E. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, si dhe kontratën e punës respektive, marrjen e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

I.-Ulje në detyrë dhe kalimin në një pozicion pune të përshtatshëm me kualifikimin dhe nivelin arsimor, për:

1. Z. A. K, me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor (I Autorizuar),

-Për shkelje dhe parregullsi të konstatuara në 6 procedura prokurimi, pasi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës, si dhe janë shpallur fitues OE që nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

2. Znj. Z. I me detyrë Zv/Kryetar Bashkie dhe ish Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, si dhe në cilësinë e personit përgjegjës në fushën e prokurimeve,

-Për shkelje dhe parregullsi të konstatuara në procedurat e prokurimit, copëzimi i fondeve (ndarja e vlerës së kontratës) dhe për pasojë devijimi nga aplikimi i LPP-së për shkak të mosaplikimit të rregullt të llojit të procedurës, që përbën një risk eventual për prokurimin e objektit me një vlerë më të lartë.

-Për të meta e mangësi në hartimin e projekt buxhetit në drejtim të numrit të lartë prej 361 veta të organikës së Bashkisë Tropojë, për efekt të mos justifikimit të ngarkesës dhe punës së tyre me dokumente e programe pune, çka ka ndikuar negativisht në buxhetin 2022.

-Për mos përmirësimin e politikave sociale-ekonomike, për të zbutur papunësinë dhe varfërinë, pasi ndihma sociale për 2022 zënë peshën kryesore prej 386 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsej ose 47 %, dhe ka tendencë në rritje, në vend që të ndodhte e kundërta si rezultat i shpërnguljes banorëve brenda dhe jashtë vendit.

-Për lejimin e krijimit të vështirësisë financiare, sipas nenit 56 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, që do të rëndojë në fondet e viteve në vazhdim. Për mos shlyerjen e detyrimeve të planifikuara të vitit 2022 për detyrimet prapambetura në masën 30% ose në vlerë absolute 23 milion lekë, pasi janë likuiduar vetëm 6,2 milion lekë nga 23 milion lekë që duhej.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

## **II.–Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për këta punonjës:**

1. Z. P. R, me detyrë përgjegjës tek Bordi i Kullimit

-Në cilësinë e antarit të Specifikemeve Teknike-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kamioni”, pasi specifikimet teknike nuk janë të plota dhe të argumentuara. Gjithashtu në cilësinë e antarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës. Pjesëmarrja në këto dy komisione për të njëjtën procedurë prokurimi, ka shkaktuar konflikt interesi.



-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

2. Z. B. B, me detyrë Teknik ndërtimi në Drejtorinë e Shërbimeve Publike

-Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj” dhe procedura me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 33,090,778 lekë ose rreth 68 % e totalit të detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2023 Bashkia Tropojë ka kryer likuidime në vlerën **16,973,027 lekë**, të detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme.

Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Tropojë për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën 4,373,027 lekë, për 9 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Tropojë. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë (argumentimin dhe propozimin nga sektori i burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

*Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2025 dhe në vijimësi*

## **C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se deri në datën 31.12.2023 gjendja e debitorëve progresive për taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën **33,117,410 lekë**, e cila përbëhet nga:

- vlera prej **28,770,766 lekë** për 268 subjekte debitore të kategorisë biznes dhe 4 institucione.
- vlera prej **2,600,000 lekë** për 3 subjekte debitore që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve.
- vlera prej **773,644 lekë** për 21 subjekte debitor nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.

- vlera prej **973,000 lekë** nga tarifa e kantierit për 14 subjekte që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Tropojë, të cilat janë të kontabilizuara.

Për vitin 2023 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara nga taksat dhe tarifave vendore janë në vlerën **6,016,405 lekë ose 18 %** e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga: -detyrimi prej 5,247,405 lekë për 128 subjekte debitore të kategorisë biznes dhe 2 institucione, -detyrimi prej 769,000 lekë për 11 subjekte për tarifën e kantierit.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion rezulton se nga sektori i tatim taksave janë marrë masa shtrënguese bllokim llogarish por jo në mënyrë shteruese deri në kallzim penal. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e mësipërme dhe të nxjerrë përgjegjësitë për gjendjen e debitorëve.

-Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tropojë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **33,117,410 lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

#### **D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për kontratat e qiradhënies së aseteve, lidhur ndërmjet Bashkisë Tropojë me palë të treta konstatohet që:

Bashkia Tropojë në procesin e ligjshëm të administrimit të aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre, për vitin 2023 ka gjithësej 34 kontrata qiraje aktive, kryesisht për biznese, për matjet e intesitetit të erës për qëllime studimi, mbjellje peme frutore dhe strehim social në vitin 2023 me afat qiraje 1 (një vjekar) deri 9 vjecare. Bazuar në dokumentacionin e venë në dispozicion të kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore, konstatohet se deri më datë 31.12.2023, për 14 kontrata nuk janë shlyer detyrimet në vlerën 11,021,770 lekë. të cilat janë të pa kontabilizuara dhe janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Ndaj këtyre subjekteve nuk janë marrë masa shtrënguese për arkëtimin e detyrimit të krijuar si dhe zgjidhjen e kontratës. Referuar kushteve të kontratës nenit 4, pika 4.2, pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës për llogari të institucionit.

Gjithashtu, nëse nga subjektet refuzohet pagesa, po në zbatim të nenit 10, nga Bashkia zgjidhet kontrata për mos përmbushje të kushteve të saj. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 58-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me sektorin e Bujqësisë dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore **11,021,770 lekë**, të cilat janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë nga 14 qiramarrësit e tokës bujqësore, pasqyruar në Kapitullin Anekse, si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë në sektorin e tatim taksave për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë Tropojë dhe NJA për vitin 2023 janë taksuar 1421 familje. Me qëllim vlerësimin nëse është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga struktura e mësipërme me informacionin e gjendjes civile. Nga përlllogaritjet e kryera, rezultoi se për vitin 2023 janë taksuar 8029 familje më pak sesa duhej të taksoheshin

për kategorinë familjar.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojnë Bashkia Tropojë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përllogaritjet vetëm për tarifën e Shërbimit (pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit) për qytetin Tropojë për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim mesatarisht 1,875 lekë \* 2301 familje taksuar më pak = **4,314,375 lekë** planifikuar më pak, dhe në Njësitë Administrative për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 937,5 lekë \* 5728 familje taksuar më pak = **5,370,000 lekë** planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.2018<sup>12</sup>, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezultoi se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Tropojë dhe Njësi Administrative, taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfituar shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimit”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Bashkia Tropojë nuk ka një akt marrëveshjeje me U Sh.A. Tropojë, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të rolit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore të përfshira në faturën e ujit të pijshëm. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pika II.1 Tabela 11 në Paketën Fiskale të Bashkisë Tropojë për vitin 2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë në bashkëpunim me Administratorët e Njësi Administrative, të marrin masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrin të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2023, rezultojnë 9,684,375 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

**2.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Tatim Taksave, të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore nga abonentët familjarë, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor U.K Sh.A Tropojë me qëllim që taksat dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” të mblidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të tatim Taksave Bashkia Tropojë për taksimin dhe tarifimin e subjekteve me aktivitet “Hoteleri” rezultoi se për vitin 2023 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 1,552 mijë lekë, ose 152 % e planifikimit. Nga auditimi u konstatua se, aplikimi i tarifës bëhet sipas deklarimeve të vetë subjekteve, duke mos ushtruar asnjë kontroll nga sektori i terrenit nëse deklarimi i subjektit ose regjistrimi në librat përputhet me numrin e pushuesve dhe numrin e dhomave për hotel. Pra nuk evidentohet, sa dhoma ka hoteli disponibël për aktivitet, sa shtretër janë për dhomë dhe gjithsej, sa dhoma janë aktive dhe sa jo. Të gjitha këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë arkëtuar saktë për numrin e personave që akomodohen në strukturat akomoduese të Bashkisë Tropojë, kryesisht kjo në sezonin veror ku numri i personave që akomodohen në

<sup>12</sup> Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

hotele është më i lartë, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së fjetjes në hotele u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive deri në 31.12.2023 është 360,320 lekë për 13 subjekte. Përgjatë vitit 2024 janë kryer likuidime për taksën e fjetjes në hotele në vlerën 179,865 lekë nga detyrimi i mbetur deri në 31.12.2023.

Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e fjetjes në hotele, konstatohet se nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, nuk janë marrë masa shtrënguese për arkëtimin e taksës së fjetjes në hotele. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerë 360,320 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun I.3, tabela nr.6 në Paketën Fiskale të Bashkisë Tropojë për vitin 2023. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Tropojë, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.

**3.2. Rekomandimi:** Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 360,320 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë, si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitore.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV Bashkia Tropojë, u konstatua se deri më datë 31.12.2023 në mënyrë progresive, si rrjedhojë e mos likuidimit të gjobave të vendosura, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 1,600,000 lekë, vlerë e cila është e pa kontabilizuar. Gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nga Kryeinspektori i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit nuk është bërë kërkesë në Gjykatën Administrative të Shkallës Parë Tropojë, për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të tyre nëpërmjet përmbarimit gjyqësor. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSH”, neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, Drejtorinë Juridike dhe Kryeinspektorin e IMTV të ndjekin me përpikmëri të gjitha rrugët administrative dhe ligjore kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për arkëtimin e vlerës **1,600,000 lekë**, si rrjedhojë e gjobave të vendosura si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitore.

-IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2023 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë 2 gjoba në vlerën 20,000 lekë; Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat shtrënguese si dhe nuk janë aplikuar kamat vonesa sipas ligjit në fuqi. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin

13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, si dhe pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Tropojë në bashkëpunim me sektorin e Policisë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 20,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura, si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **E. MASA DISIPLINORE**

### **E.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE**

#### **E.1.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil**

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë, që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

#### **a. “Vërejtje” në zbatim të gurmës “a” të nenit 58, për 4 punonjës:**

**1. Z. K. S**, me detyrë Përgjegjës i Tatim Taksave në perudhën (aktualisht në sektor tjetër pranë Bashkisë Tropojë), për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mosaplikimin e penalteteve, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**2. Z. K. B**, Specialist i menaxhimit të borxhit, për mangësitë e konstatuara për zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mosaplikimin e penalteteve, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3. Z. H. I**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit përgjegjës për mangësitë e konstatuara për mos administrimin e pronave dhe aseteve si dhe në drejtim të menaxhimit, organizimit dhe funksionimit të strukturave mbi regjistrimin dhe administrimin e pronës Publike (Asetet dhe Pyjet Kullotave). (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 58-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4. Z. M. K**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë, për mangësitë e konstatuara për mos administrimin e pronave dhe aseteve si dhe në drejtim të menaxhimit, organizimit dhe funksionimit të strukturave mbi regjistrimin dhe administrimin e pronës Publike (Asetet dhe Pyjet Kullotave). (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 58-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **E.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish punonjësen e mëposhtme nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” për:

**1. Znj. E. D**, Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, planifikimit dhe zbatimin e buxhetit si dhe hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 12-17, pikën III.2.2 faqe 18-45 dhe pikën III.2.3 faqe 45-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar i Auditimit.**

## **KONTROLI I LARTË I SHITIT**